**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

# RAPORT

## I MONITORIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Janar-Dhjetor 2012**

**Prishtinë 2013**

**PËRMBAJTJA**


- Hyrje
- Qëllimi
- Përmbledhje ekzekutive
- Mbledhjet e mbajtura
- Aktet komunale
- Transparenca
- Shqyrtimi administrativ i akteve komunale
- Këshilli komunal për siguri në bashkësi
- Përmbledhje nga mbledhjet e mbajtura
- Shkeljet ligjore
- Efikasiteti dhe azhuriteti i organeve të administratës së komunave
- Gjetjet më të rëndësishme
- Konkluzionet
- Rekomandimet e përgjithshme

## Hyrje

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Vetëqeverisja lokale është sistem autonom i qeverisjes, përmes së cilës komunave u atribuohet drejtimi politik, juridik, administrativ dhe financiar i tyre. Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparencën dhe llogaridhënien si dhe garanton një sistem kontrolli të ndërsjellë në nivel komunal për të parandaluar veprimet e kundërligjshme.

Komunat janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve, normave të cilat i nxjerrin vetë, norma të cilat mund të kenë të njëjtin ndikim e efikasitet si të normave shtetërore, edhe pse të varura nga këto të fundit. Po ashtu, komunat organizojnë administratën sipas strukturës së nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, krijojnë të hyrat financiare dhe i administrojnë ato sipas nevojave të tyre.

Mirëpo, pavarësisht individualitetit të komunave në kryerjen e veprimtarive të tyre, legjislacioni ka përcaktuar një shkallë të varësisë në marrëdhënie me organet qendrore. Në këtë kuadër, parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrive të tjera të linjës ndaj komunave, është me rëndësi të veçantë, pasi që mundëson kufizim të pjesshëm të veprimtarisë së komunave. Kjo përkon me kontrollin e respektimit të ligjshmërisë, të parashikuar me ligj dhe të vendosur vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës për evitimin e veprimeve komunale të cilat bien ndesh me dispozitat juridike të legjislacionit në fuqi.

Prezantimi i aktiviteteve të Kuvendeve të Komunave është mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësisë së komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike. Me një fjalë, përmes këtyre raporteve lehtësohet kontrolli i administratës me anë të mbikëqyrjes shoqërore. Raportet informuese siç është Raporti mbi funksionimin e komunave, ka rëndësi të shumëfishtë, pasi nga këndvështrimi i jashtëm mund të perceptohen situata dhe veprime që përbrenda komunave konceptohen ndryshe. Ky raport nënvizon detaje të mjaftueshme për të ngritur një paralele në mes komunave dhe t'i rendis ato sipas kritereve të caktuara.

Raporti përmbledh dhe shtjellon çështjet më të rëndësishme të cilat janë në mandatin e organeve komunale, përkatësisht kuvendit të komunës dhe ekzekutivit. Fokusi kryesor është vënë në pasqyrimin e punës së kuvendeve të komunave, duke ditur se në mënyrë indirekte përfshinë edhe shpalosjen e punës së ekzekutivit, për faktin se ky i fundit i raporton Kuvendit në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet.

**Qëllimi i Raportit**

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve qeveritare, joqeveritare, komunave dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të komunave karshi sistemit juridik të vendit. Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një përfytyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në këtë dokument janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punimeve të kuvendeve të komunave. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Dokumenti është hartuar në pjesë të ndara, duke përfshirë njësitë për katër, pesë ose gjashtë komuna, varësisht nga grupi i komunave të monitoruara nga zyrtarët përgjegjës.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 34 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë për Komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna.

Mendojmë që informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

**KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Deçan
Dragash
Ferizaj
Fushë Kosovë
Gjakovë
Gjilan
Gllogoc
Graçanicë
Hani i Elezit
Istog
Junik
Kaçanik
Kamenicë
Klinë
Kllokoti
Leposavicit
Lipjan
Malishevë
Mamushë
Mitrovica e Veriut
Mitrovicë
Novobërdë
Obiliq
Partesh
Pejë
Podujevë
Prishtinë
Prizren
Rahovec
Ranillug
Shtërpcë
Shtime
Skenderaj
Suharekë
Viti
Vushtrri
Zubin Potokut
Zvecanit

## Përmbledhja ekzekutive

Periudha janar-dhjetor e vitit 2012 për komunat e Republikës së Kosovës ka shënuar vazhdimësinë e përpjekjeve, sukseseve, të arriturave, por edhe sfidave në ushtrimin e kompetencave të nivelit lokal. Komunat tani kanë krijuar praktikë të mirëfilltë në ushtrimin e kompetencave të parapara me legjislacionin në fuqi. Në komuna vërehet një organizim dukshëm më i mirë në planifikimin e aktiviteteve, orarin e takimeve, në miratimin e planeve vjetore të punës dhe të çështjeve të tjera me rëndësi  Në këtë zhvillim, kontribut të theksuar kanë dhënë edhe organet e nivelit qendror. Më konkretisht, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka luajtur rolin e saj mjaft konstruktiv, duke kontribuar në zhvillimin e proceseve të ndryshme dhe në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Për më tepër, nevoja për të mbikëqyrë punën e organeve të vetëqeverisjes lokale mbetet rëndësi imediate për komunat dhe proceset administrative në përgjithësi.

Divizioni për Monitorim të Komunave në periudhën janar-dhjetor të vitit 2012 me koherencë ka përcjellë punën e Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës. Funksionalizimi i pajisjeve me teleprezencë për monitorimin e komunave, ka rritur efikasitetin e procesit të monitorimit dhe komunikimit me organet komunale. Shfrytëzimi i mjeteve të tilla të avancuara teknologjike ka bërë që gjatë kësaj periudhe të monitorohen pothuajse të gjitha mbledhjet e zhvilluara të Kuvendeve të Komunave. Gjithashtu, realizimi i planit të monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës si dokument bazë përmes së cilës janë përcaktuar objektivat kryesore të monitorimit të komunave, përqendrim i ka dhënë mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të punës së organeve të Komunës. Takimet me zyrtarët e komunave kanë treguar sukses në forcimin e raporteve institucionale në mes nivelit qendror dhe atij lokal, duke reflektuar pozitivisht në gjetjen e zgjidhjeve për rastet të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit administrativ.  Në këtë drejtim, është rritur niveli i evitimit të joligjshmërisë përmes rishqyrtimit të akteve nga komunat, të kërkuara nga organi mbikëqyrës.

Pjesa ekzekutive e raportit nënvizon aspektet e përgjithshme të funksionimit të komunave, duke u fokusuar në veprimtarinë e Kuvendeve të Komunave, Komiteteve,  përkatësisht mbledhjeve të mbajtura, akteve të miratuara, raportit në mes të komunave dhe organit mbikëqyrës, shkallën e respektimit të legjislacionit në fuqi, numrin e shkeljeve ligjore, nivelin e respektimit dhe harmonizimin e veprimeve që rrjedhin nga provizionet ligjore, transparencën, funksionimin e KKSB-ve, si dhe efikasitetin e organeve të administratës së komunave në trajtimin e kërkesave të qytetarëve

Në vitin 2012, në Republikën e Kosovës kanë qenë funksionale 34 kuvende të komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, të gjitha komunat kanë përmbushur kriteret e nevojshme sa i përket numrit të takimeve të kuvendeve të komuanve. Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve, në televizionet lokale, apo në ueb-faqen e komunës përmes aplikacioneve të sistemit të teleprezencës e cila mundëson transmetime të tilla.
Ndërsa, lidhur me vijueshmërinë e takimeve të Kuvendeve të Komunave, bojkotimit të mbledhjeve apo lëshimit të mbledhjeve gjatë zhvillimit të punimeve, në këtë periudhë kemi

shënuar disa raste të tilla. Së këndejmi, kemi evidentuar një rast të mospjesëmarrjes të subjekteve politike në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, një rast kur subjekti politik nga opozita e Kuvendit të Komunës së Obiliqit ka lëshuar mbledhjen, nga një rast tjetër kur subjektet politike nga radhët e opozitës në Komunën e Kamenicës dhe Malishevë kanë lëshuar mbledhjen, si dhe në muajin shtator një rast i lëshimit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku një pjesë e pozitës dhe opozitës në këtë komunë kanë lëshuar mbledhjen e kuvendit duke shprehur qëndrime dhe pakënaqësi lidhur me propozim buxhetin komunal për vitin 2013.

Për më sakë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 408 mbledhje**.** Po që se krahasojmë të dhënat e mbledhjeve të kuvendeve nga viti 2011 me atë në 2012, numri mund të varioj nga njëra komunë në tjetrën, mirëpo numri i përgjithshëm mbetet i njëjtë, me vetëm një mbledhje më shumë në vitin 2012.




**Fig.1.** *Të dhënat krahasuese të mbledhjeve të kuvendeve të komunave nga viti 2011 në vitin 2012.*

Megjithatë, nëse shikojmë të dhënat e akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe, do të shihet se Kuvendet e Komunave kanë miratuar *1161 vendime dhe 136 rregullore*. Aktet komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë rregulluar shumë fusha, mirëpo ndër më kryesoret mund të përmendim janë: miratimi i planeve rregulluese urbane, akte nga fusha e mjedisit, miratimi i vendimeve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale, ndërrimin e destinimit të pronave, shpallje të zonave me interes të përgjithshëm, vendime për emërtimin e rrugëve, miratimi i akteve në sferën e shërbimeve publike, rregullimin e organizimit të brendshëm të administratës, akte që rregullojnë krijimin e të hyrave komunale, krijimin e mekanizmave komunal për siguri, etj.

Paralelisht me Kuvendet e Komunave janë mbledhur edhe komitetet e obligueshme, të cilat kryesisht kanë trajtuar çështjet e planifikuara për zgjidhje në Kuvendin e Komunës. Edhe pse me LVL të dy komitetet janë të obligueshme, Komunat më pak i kushtojnë rëndësi Komitetit për Komunitete. Për nga numri, Komitetet për Politikë dhe Financa kanë mbajtur gjithsej 385 mbledhje, ndërkaq Komitetet për Komunitete janë mbledhur 283 herë.

Lidhur me transparencën si parim esencial në bazë të së cilës institucionet publike, e në këtë rast komunat, veprimtarinë e tyre e ushtrojnë hapur para qytetarëve. Në kuadër të kësaj, organizimi i takimeve publike me qytetarë në komuna ka qenë kryesisht i kënaqshëm. Në komuna janë

mbajtur 74 takime publike me qytetarë, është fjala për takime të cilat janë të obligueshme sipas nenit 68.1 të LVL-së, ndërsa sipas të dhënave komunat kanë organizuar edhe tubime të tjera shtesë me qytetarë kryesisht në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit qytetarëve u krijojnë mundësinë e dhënies së vërejtjeve, propozimeve, vlerave dhe kërkesave të tyre në raport me nevojat. Ato, praktikisht paraqesin aspekte të demokracisë së drejtpërdrejtë, përkundër demokracisë së tërthortë ku kërkesat e qytetarëve realizohen përmes të zgjedhurve të tyre apo programeve të caktuara. Prandaj, aplikimi i kësaj forme të konsultës së përgjithshme, duhet të vazhdoj edhe në të ardhmen dhe të jetë pjesë integrale e politikave komunale.

Më lartë përmendëm numrin e akteve të cilat janë miratuar gjatë kësaj periudhe në kuvendet e komunave të cilat rregullojnë sfera të ndryshme nga kuadri i kompetencave komunale. Këto akte janë pjesë e obligimeve ligjore të komunave dhe kërkohet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, nisur nga ky aspekt, jo gjithherë komunat u janë përmbajtur rregullave ligjore me rastin e hartimit dhe nxjerrjes së vendimeve apo rregulloreve të caktuara komunale.

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, janë përcaktuar normat e mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës në kryerjen e autorizimeve ligjore (kompetencave vetanake dhe atyre të deleguara), përmes mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së akteve të përgjithshme. Mbi bazën e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komuanve, në praktikën e miratimit të akteve është vërejtur që komunat i kushtojnë më pak rëndësi procesit të nxjerrjes së akteve të përgjithshme, si dhe përmbajtjes së dispozitave materiale, për shkak se te këto akte, të drejtat dhe interesat e subjekteve edhe pse mund të shkelen, ato mund të vërehen vetëm në procesin e implementimit në marrëdhëniet konkrete shoqërore. Për të evituar joligjshmërinë, me Ligjin për vetëqeverisje Lokale është përcaktuar që se "aktet e përgjithshme të Kuvendit të Komunës si dhe vendimet i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë", e cila është formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese që autoriteti mbikëqyrës ushtron ndaj akteve të përgjithshme komunale. Për të mundësuar këtë proces, komunat janë të obliguara që aktet normative nënligjore t'i dërgojnë në afatin e paraparë në organin mbikëqyrës për vlerësim të pajtueshmërisë së tyre me kushtetutën dhe me ligjet.

Në këtë segment duhet të theksohet se ende nuk është krijuar një praktikë e mirëfilltë nga komunat në dërgimin e akteve të përgjithshme për vlerësim të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës. Nga aktet të cilat Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të ligjshmërisë si dhe në bazë të vlerësimeve të cilat i kanë dhënë komisionet ndërministrore të themeluara posaqërisht për këtë qëllim, janë vlerësuar gjithsej 42 akte me përmbajtje joligjore. Niveli i rishqyrtimit të akteve nga komunat është 50%, ose thënë më konkretisht 20 akte janë kthyer në rishqyrtim, ndërsa 22 mbeten të pashqyrtuara.




**Fig.2.** *Të dhënat për nivelin e respektimit të kërkesave për rishqyrtim të akteve të kundërligjshme nga komunat*

Meqenëse, momenti i hyrjes në fuqi të një akti juridik komunal nuk është përcaktuar shprehimisht me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në praktikën e hartimit të akteve të komunave, si rregull përcaktohet se hyrja në fuqi e një akti bëhet pas nënshkrimit të kryesuesit të kuvendit. Një hapësirë e tillë ligjore thekson se në të vërtetë një akt edhe pse mund të ketë përmbajtje të kundërligjshme, mund të jetë i zbatueshëm deri sa ndonjë gjykatë nuk e provon të kundërtën. Formula e tanishme ligjore për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, nuk lejon mundësinë e aplikimit të masave të përkohshme me karakter suspenziv nga autoriteti mbikëqyrës, në rastet kur dyshohet në kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e dispozitave të një akti. Kësisoj, është ndaluar mundësia e suspendimit të ekzekutimit të akteve komunale në rastet e supozimit dhe arsyetimit të shkeljes së kushtetutës dhe ligjeve. Deri në lënien jashtë fuqisë së aktit të përgjithshëm përmes anulimit dhe abrogimit nga ndonjë gjykatë, praktikisht mund të shkaktohen pasoja juridike.

## KOMUNAT: GJAKOVË, RAHOVEC, DEÇAN, JUNIK DHE ISTOG

**Mbledhjet e mbajtura**

Komunat Gjakovë, Rahovec, Deçan, Junik dhe Istog gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2012 kanë mbajtur numrin e mjaftueshëm të mbledhjeve të kuvendit, minimumi dhe maksimumi i përgjithshëm i cili është i precizuar me ligj. Marrë në tërësi, në kuvendet e këtyre komunave gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej 51 mbledhje të rregullta dhe 6 të jashtëzakonshme. Më saktësisht në vijim kemi paraqitur figurën e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave:




| | Gjakovë | Deçan | Junik | Rahovec | Istog |
|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 10 | 10 | 10 | 10 | 11 |
| Mbledhjet e jashtëzakonshme | 2 | 3 | 0 | 1 | 0 |

**Fig. 3.** *Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec*

Nga figura 1 vërejmë se numrin më të madh të mbledhjeve e ka mbajtur Kuvendi i Komunës së Deçanit me 13 mbledhje. Krahas saj, Gjakova ka mbajtur 12 mbledhje, ndërkohë Rahovecit dhe Istogu kanë mbajtur nga 11 mbledhje. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011, shikuar në tërësi, Kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur mbledhje po aq sa në vitin 2012.
Edhe komitetet për komunitete kanë qenë funksionale në këtë periudhë. Numri i takimeve të Komiteteve obligative qëndron si në vijim:




| | Gjakovë | Deçan | Junik | Rahovec | Istog |
|---|---|---|---|---|---|
| KPF | 9 | 11 | 11 | 12 | 9 |
| KK | 7 | 9 | 11 | 8 | 10 |

**Fig. 4.** *Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec*

Nga pasqyrimi i mësipërm shohim se në mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme Komuna e Junikut ka treguar interesimin më të madh. Në të gjitha komunat funksionimi i këtyre komiteteve ka qenë i rregullt, megjithëse nga të dhënat shohim se Komiteti për Politikë dhe Financa ka një diferencë të lehtë në zhvillimin e takimeve krahas Komitetit për Komunitete. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar edhe themelimin e disa komiteteve të tjera siç janë ato konsultative. Edhe pse sipas këtij ligji komunat janë të obliguara të përmbushin këtë obligim, deri tani, në asnjërën prej tyre nuk janë themeluar komitete të tilla.

Thelbësore për t'u elaboruar në këtë pjesë të raportit është numri i akteve nënligjore të miratuara në kuvendet e komunave. Edhe pse nga këndvështrimi kuantitativ nuk mund të bëjmë një vlerësim të performancës së kuvendeve të komunave, megjithatë ky segment ka rëndësinë e vetë dhe paraqet një pjesë substanciale të veprimtarisë së kuvendeve të komunave. Një shprehje e tillë gjithashtu tregon nivelin e konsensusit që ekziston në kuvendet e komunave, rolin e subjekteve opozitare dhe qëndrimet e tyre, kreativitetin e kuvendeve gjatë zhvillimit të takimeve, si dhe angazhimin e përgjithshëm të kuvendarëve në rregullimin e sferave të caktuara të marrëdhënieve shoqërore. Duke marrë për bazë edhe numrin e vogël të propozimeve të cilat nuk kanë kaluar në kuvendet e komunave, në përgjithësi mund të themi se puna ka qenë produktive. Ky konstatim mund të përforcohet edhe nëse bëjmë një krahasim të akteve të miratuara me periudhën e njëjtë të vitit 2011, ku shohim se në vitin 2012 janë miratuar 38 akte më tepër se sa në vitin paraprak, gjegjësisht 2 rregullore dhe 36 vendime.

Nga aspekti kuantitativ, del që në këto komuna janë miratuar gjithsej 147 vendime dhe 22 Rregullore. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nëpër kuvende:




| | Gjakovë | Deçan | Junik | Rahovec | Istog |
|---|---|---|---|---|---|
| Vendime | 34 | 25 | 29 | 35 | 24 |
| Rregullore | 2 | 2 | 5 | 5 | 8 |

**Fig. 5.** *Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec*

Siç vërejmë, numrin më të madh të akteve të miratuara e ka realizuar Komuna e Rahovecit, ndërkohë më së paku akte të miratuara kemi në Komunën e Deçanit. Mirëpo, nëse shikojmë numrin e shkeljeve ligjore të cilat do të paraqiten në vijim të raportit, vërejmë se më së shumti shkelje ka bërë Komuna e Rahovecit. Andaj, siç u përmend edhe më lartë numri i akteve të miratuara nuk mund të jetë përcaktues i efikasitetit të Kuvendit të Komunës, ngase ky aspekt varet nga kualiteti i akteve të miratuara dhe ligjshmëria e tyre.

Sa u përket mbledhjeve të kuvendit, të gjitha takimet kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes medieve lokale. Ndërkohë, ajo që është vërejtur tregon se qytetarët nuk duken edhe aq të inkurajuar për të qenë pjesëmarrës në takimet e kuvendit. Madje, edhe takimet publike të organizuara lidhur me çështjet e interesit të përgjithshëm, siç mund të jenë miratimi i rregulloreve apo planeve të ndryshme komunale, nuk i ka nxitur qytetarët për të qenë pjesëmarrës. Megjithatë, komunat janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, ueb-faqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qenë azhurnuara me informacione dhe aktivitetet e komunave. Madje, duke marrë parasysh sistemin e teleprezencës të instaluar në komuna, është krijuar mundësia e vendosjes së aplikacioneve në ueb-faqet zyrtare, ku qytetarët të kenë mundësinë për vëzhgimin e mbledhjeve të kuvendeve. Një mundësi e tillë është praktikuar më tepër nga Komuna e Junikut. Komunat kanë organizuar edhe takime publike me qytetarë. Sipas të dhënave, në këto komuna janë mbajtur nga dy tubime të rregullta me qytetarë (neni 68.1 i LVL-së), por njëkohësisht edhe takime të tjera me grupe të ndryshme të interesit, kryesisht për propozim-buxhetet e komunave për vitin 2013.

Lidhur me informimin dhe komunikimin me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal komunat qëndrojnë relativisht mirë. Në shumicën e rasteve ftesa për mbledhjet e kuvendit ka arritur me kohë, mirëpo jo të gjitha komunat kanë dërguar edhe materialet e mbledhjeve të bashkangjitur me ftesë. Për më saktë, është Komuna e Deçanit ajo e

cila nuk i ka dërguar materialet e mbledhjeve të kompletuara, si dhe në një rast Komuna e Junikut nuk ka e dërguar ftesën për mbledhje në MAPL.

Sa i përket krijimit të kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organet mbikëqyrëse, fatkeqësisht është evident fakti që komuna e Rahovecit, Deçanit dhe Junikut nuk janë përmbajtur ligjit në këtë drejtim. Edhe gjatë kësaj periudhe, aktet e miratuara në kuvendet e këtyre komunave, nuk janë përcjellë me rregull në organin mbikëqyrës me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë. Megjithatë, pas realizimit të vizitave në teren konform planit të veprimit, ka një lëvizje pozitive nga komuna e Rahovecit dhe Junikut. Ndërsa, komunat të cilat kanë mundësuar këtë proces dhe që kanë lehtësuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve përmes dërgimit të tyre sipas afatit në organin mbikëqyrës janë: Komuna e Gjakovës dhe Istogut. Krahas tyre, Komunat tjera, si: Rahoveci, Deçani dhe Juniku, aktet i kanë dërguar ad-hoc dhe pjesërisht, ose i kanë dërguar sipas kërkesës së organit mbikëqyrës në rastet kur ka ekzistuar dyshimi për vendime të kundërligjshme. Megjithëse gjatë periudhës raportuese, Komunës së Gjakovës dhe Rahovecit u ishin përcjellë disa shkresa, me të cilat kërkohej rishqyrtimi i vendimeve të kundërligjshme, vetëm komuna e Gjakovës i mori parasysh, ndërkaq Komuna e Rahovecit ktheu në rishqyrtim vetëm dy vendime edhe pse ka mëdyshje për mënyrën e votimit në këtë rast.

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Si mekanizëm për trajtimin e kërkesave të qytetarëve në raport me sigurinë ligji ka paraparë themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Me U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB është përcaktuar numri prej gjashtë mbledhjeve brenda vitit të këtij mekanizmi. Sipas të dhënave, këto këshilla në këtë periudhë kanë mbajtur këtë numër të takimeve:




| | Gjakovë | Deçan | Junik | Rahovec | Istog |
|---|---|---|---|---|---|
| KKSB | 2 | 5 | 5 | 8 | 8 |

**Fig. 6**. *Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Rahovec.*

Nga figura e mësipërme vërejmë se vetëm Komuna e Rahovecit dhe Istogut kanë mbajtur me rregull mbledhjet e këtij këshilli për dallim nga viti 2011 ku kishte vetëm 3 takime të realizuara.

Ndërsa në komunat: Deçan, Junik, ka pasur një ritëm mesatar të zhvillimit të takimeve të KKSB-së, kurse në Komunën e Gjakovës ky këshill ka pasur stagnim në funksionim, sikurse që kishte edhe në vitin 2011.

Megjithëse nuk do të marrim për bazë numrin e takimeve të zhvilluara, pasi që udhëzimi administrativ i miratuar parasheh numër më të vogël të mbledhjeve për KKSB-në. Mirëpo nëse shikojmë përbërjen e re të KKSB-ve - pasi që me udhëzimin e ri administrativ përbërja ka ndryshuar, del që vetëm në Komunën e Istogut dhe Gjakovës është miratuar përbërja e re në Kuvendin e Komunës. Kurse, komunat: Deçan, Junik dhe Rahovec përbërjen e re nuk e kanë miratuar, përkundër faktit që kërkohet me udhëzimin administrativ.

Përgjithësisht mund të themi se në këto komuna (me përjashtim të Rahovecit), Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka pasur një rrjedhë të funksionimit siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL për KKSB deri sa ka qenë në fuqi.

**Komuna e Gjakovës**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Paralelisht me mbledhjet e Kuvendit të Komunës, kanë funksionuar edhe Komitetet e obligueshme. Rezultat i punës së kuvendit ka qenë miratimi i 34 vendimeve dhe dy Rregulloreve.

Sa i përket natyrës së akteve komunale, numri më i madh i tyre rregullojnë sferat nga planifikimi urban, mbrojtja e mjedisit, zhvillimit ekonomik, akte të karakterit organizativ dhe funksional të komunës, si dhe akte nga fusha të tjera të veprimtarisë komunale.
Në mesin e shumë akteve të përgjithshme, Kuvendi ka miratuar Rregulloren për Mbrojtje të Mjedisit dhe Rregulloren për ndarje të subvencioneve. Gjithashtu është nxjerrë Projekti Urbanistiko-Arkitektonik i Kampusit Universitar, Plani Rregullues Urban i Kompleksit Urbanistik përkatësisht potezit për gjatë rrugës regjionale Gjakovë-Prizren, ana jugore (ish-poligoni i autoshkollës) dhe është miratuar Plani Rregullues Urban për Parkun e Qytetit dhe segmentin veri-perëndimor të rrugës “Tirana”.

Sa i përket fushës së të drejtave të njeriut dhe me qëllim të integrimit të komuniteteve të tjera në komunë, Kuvendi i Komunës ka nxjerrë Planin e Veprimit të Komunës së Gjakovës për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për periudhën 2012-2015.
Ligji për vetëqeverisje lokale në nenin 28 ka paraparë mundësinë e komunave për të bashkëpunuar dhe krijuar partneritete me komunat e tjera përbrenda kompetencave komunale dhe me qëllim të kryerjes së funksioneve me interes të përbashkët. Në këtë kuptim, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka nxjerrë vendim për themelimin e Bashkëpunimi Ndërkomunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Deçanit , për sigurimin e ujit të pijes së banorëve të fshatit Hereq, nga kapacitetet e ujësjellësit të Komunës së Deçanit.

Para miratimit të akteve të përgjithshme juridike nënligjore, konkretisht Rregulloreve, Planeve si dhe dokumenteve të tjera që prekin interesat e përgjithshme të qytetarëve, komunat si rregull i ka ndëmarrë hapat për të vënë në diskutim publik për të marrë qëndrimin e qytetarëve. Në anën tjetër, për të rritur transparencën dhe mundësinë që edhe qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes,

Komuna e Gjakovës ka organizuar një numër takimesh publike me qytetarë.  Kësisoj, në diskutim publik kanë kaluar: Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit, Plani Rregullues Urban i kompleksit urbanistik  përgjatë rrugës regjionale Gjakovë-Prizren, rishikimi i segmentit rrugor dhe rregullimi i lokacionit nga Rruga “Anton Çeta” deri në rrugën “Dëshmorët e Lirisë” etj.

Përveç kësaj, çështje tjetër që lidhet me transparencën është organizimi i takimeve publike me qytetarë, duke ditur se është obligim i komunës që në baza të rregullta të organizoj në vit së paku 2 takime publike me qytetarë. Komuna e Gjakovës ka mbajtur dy takime publike me qytetarë dhe gjithashtu një takim me pjestarët e komuniteteve pakicë. Mund të themi se takime të tilla publike janë shumë të rëndësishme për sjelljen e qytetarëve më afër realizimit të nevojave të tyre.

Në përputhje me dispozitat e nenit 58 të LVL-së, kryetari i Komunës ka raportuar çdo herë kur është kërkuar nga Kuvendi i Komunës, duke siguruar prezencën e tij pothuajse në të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës. Kësisoj, pjesë e punës së Kuvendit ishte shqyrtimi i raportit të kryetarit të komunës për periudhën janar-shtator 2011, ndërkaq është aprovuar edhe Raporti financiar i Buxhetit të Komunës së Gjakovës, për periudhën janar-dhjetor 2011 (edhe pse LVL nuk obligon miratimin e këtyre raporteve).

Përveç vendimeve të lartëpërmendura, janë miratuar edhe disa ndryshime në Statutin e Komunës. Së këndejmi, është ndryshuar neni 55 dhe 56 i Statutit të Komunës, me të cilën kompetenca për mbrojtjen e pronës komunale, bartet nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Komasacion në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
Gjithashtu janë miratuar një numër i vendimeve siç janë: Vendimi për ndryshimin e komisionit për identifikimin dhe dhënien në shfrytëzim të banesave  në ndërtesën për banim social, Vendimi për formimin e  grupit punues për definimin e të dhënave për  vendosjen e shtatorëve, pllakave me emrat e dëshmorëve dhe martirëve të përfshirë në këtë edhe shtegun memorial,

**Të gjeturat**

Edhe pse Kuvendi i Komunës kishte miratuar një rregullore që bartte obligime financiare për bizneset e caktuara me qëllim të krijimit të fondit ekologjik, për shkak të mungesës së bazës ligjore dhe me qëllim të evitimit të joligjshmërisë, në një mbledhje të radhës e ktheu për rishqyrtim duke e shfuqizuar[1].
Mirëpo e njëjta praktikë nuk është ndjekur me rastin e miratimit të Vendimit mbi caktimin e tokës ndërtimore urbane në disa zona kadastrale, përfshirë edhe zonën industriale të qytetit[2], i cili vendim nuk është përfshirë me kohë në punimet e Kuvendit të Komunës për tu rishqyrtuar.

---

[1] Kuvendi i Komunës së Gjakovës, ka shfuqizuar Rregulloren për EKO-taksa të miratuar në mbledhjen e muajit janar, konform rekomandimit të dhënë nga Komisioni i përbashkët MAPL-MMPH për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të Komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake  lidhur me “mbrojtjen e mjedisit lokal”. Ky komision ka kërkuar rishqyrtimin e kësaj rregulloreje nga Komuna e Gjakovës, pasi që është vlerësuar se nuk ka bazë ligjore. Komuna e Gjakovës ka marrë për bazë rekomandimin e Komisionit dhe rregulloren në fjalë e ka shfuqizuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

[2] Vendim i kundërligjshëm sipas Komisionit të përbashkët MAPL-MBPZHR. Komisioni i përbashkët MAPL-MBPZHR pas vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01 Nr. 011-864/2012 i Kuvendit të Komunës së Gjakovës të dt.23.02.2012 mbi caktimin e tokës ndërtimore urbane. Në bazë të shqyrtimit të ligjshmërisë Komisioni për këtë vendim ka konstatuar se:

a) Komuna nuk ka respektuar legjislacionin e zbatueshëm që rregullon këtë fushë. Ky vendim bie në kundërshtim me nenin 10  parag. 10.2. Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën  Bujqësore

Sikurse në disa komuna të tjera, edhe në Komunën e Gjakovës, është bërë praktikë që Kuvendi i Komunës të miratoj kërkesa individuale në raste të caktuara. Sigurisht që mënyrat e tilla të vendimmarrjes dalin prej kompetencave të Kuvendit të Komunës si organ me të drejtë që të miratoj vetëm akte të përgjithshme juridike. Rast të ngjashëm që mund t'i referojmë praktikave të tilla mund të përmendim Vendimin për miratimin e kërkesës së z. Rexhep Jemin Kastrati nga Gjakova për dhënien në shfrytëzim të një pjese prej 0,02.22 (222 m2) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.16.37.ha të paluajtshmërisë, në ngastrën 5526/34 z.k Gjakovë - J për destinim shndërrimi në "oazë të gjelbëruar".[3] Megjithatë, Komuna e Gjakovës në mbledhjen e muajit maj, konform rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka nxjerrë Vendimin për shfuqizimin e vendimit 01nr. 011-1644/2012 i datës 29.03.2012.

Rast i ngjashëm është edhe Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në sipërfaqe prej 78 ari, me qëllim të realizimit të projektit për riciklimin e mbeturinave të financuar nga kompania CSG dhe "Green Energy" me qendër në Prishtinë.[4]

**Komuna e Rahovecit**

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2012, rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit nuk ka qenë e rregullt. Në muajin janar të vitit 2012, me kërkesën e 11 kuvendarëve të Komunës së Rahovecit është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme me propozimin për shqyrtimin e votëbesimit të kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Mbledhja e thirrur ka dështuar për shkak të

---

b) Kuvendi i Komunës së Gjakovës nuk ka kërkuar pëlqim nga MBPZHR në projekt-propozimin për Vendim 01 Nr. 011-864/2012.
c) Vendimi është në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore
d) Me Vendimin 01 Nr. 011-864/2012 është paraparë zgjerimi i zonës urbane në tokat bujqësore të cilat janë nën sistem të ujitjes dhe komasacion.
e) Vendimi 01 Nr. 011-864/2012 I Kuvendit të Komunës së Gjakovës mbi caktimin- zgjerimin e tokës Ndërtimore urbane është në kundërshtim me Ligjin mbi Tokën Ndërtimore.

Pas dhënies së rekomandimit për shqyrtimin e vendimit në fjalë, Komuna e Gjakovës në një shkresë ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke vlerësuar se Vendimi më lart i plotëson të gjitha kriteret ligjore për të prodhuar efekte juridike.

Me rastin e zbatimit të Planit të Monitorimit, zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kanë kërkuar informata shtesë nga Komuna e Gjakovës lidhur me hapat e ndërmarrë për zbatimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të lartpërmendur. Megjithëse u theksua se ekziston një pajtim në mes të Komunës së Gjakovës dhe MBPZHR-së që komuna në këtë rast ka pasur të drejtë në nxjerrjen e këtij vendimi, nuk ekziston ndonjë konfirmim formal që argumenton këtë gjë. Kësisoj, ka rrjedhur dakordim i përgjithshëm që kërkesa për rishqyrtimin e këtij vendimi, të përfshihet në rendin e ditës në mbledhjen e parë të rregullt të vitit 2013 të Kuvendit të Komunës.

[3] Pas vlerësimit të ligjshmërisë së këtij vendimi, MAPL ka kthyer përgjigjen për Komunën e Gjakovës, me ç'rast është kërkuar shqyrtimi i vendimit në fjalë, pasi që është në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Komuna e Gjakovës për këtë rast, ka nxjerrë vendim për miratimin e rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për shfuqizimin e vendimit 01nr. 011-1644/2012 i datës 29.03.2012.

[4] MAPL, lidhur me këtë vendim ka nxjerrë kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërinë e Vendimit Nr.011-5559 për dhënien në shfrytëzim të parcelës P-077050280056-I Zona Kadastrale Gjakovë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës me datë 12.12.2012. Me këtë rast, MAPL ka konstatuar se Vendimi në fjalë nuk është miratuar konform nenit 5 të Ligjit Nr.03/L-226 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës për faktin se vendimi nuk e ka përcaktuar afatin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim. Organet e Komunës, me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi nuk kanë respektuar procedurë të hapur, transparente dhe jo diskriminuese të përcaktuar në nenin 4 të U.A.Nr. 2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

mungesës së kuorumit. Kuvendarët të cilët nënshkruan kërkesën për mocionin e votëbesimit të kryesuesit të kuvendit, ishin ata të cilët nuk morën pjesë në këtë mbledhje, me arsyetimin e dhënë nga përfaqësuesi i tyre për shkeljen e dispozitave të LVL-së të cilat përcaktojnë kohën e njoftimit për mbledhje të jashtëzakonshme. Për këtë çështje, është kërkuar sqarim ligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila në përgjigjen e dhënë ka kërkuar nga kryetari i komunës dhe kryesuesi i Kuvendit të normalizojnë punën e Kuvendit të Komunës dhe të funksionoj në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Një përgjigje e tillë në shkresë, nënkupton faktin që kryesuesi i kuvendit duhej të thërriste rishtazi një mbledhje të jashtëzakonshme me qëllim të respektimit të dispozitave të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në ndërkohë, ishte planifikuar mbledhja e rregullt. Si rrjedhojë, në fillim të muajit shkurt, mbledhja e thirrur përfundoi pa nisur fare. Edhe kjo mbledhje ka dështuar për shkak mungesës së kuorumit, që lidhet direkt me pakënaqësinë ndaj kryesuesit të kuvendit të komunës nga një pjesë e kuvendarëve të Rahovecit.

Megjithatë, në muajin mars është thirrur përsëri mbledhje e jashtëzakonshme, me propozimin për shqyrtimin e votëbesimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Mirëpo, ndryshe nga ishte paraparë të votohej për shkarkimin e tij, kryesuesi i kuvendit të komunës ofroi dorëheqjen pa kaluar në votim. Në po të njëjtën mbledhje u zgjodh kryesuesi i ri i kuvendit.
Duke marrë parasysh se për një periudhë dy-mujore, për shkak të përplasjeve të subjekteve politike dhe problemeve të vazhdueshme pothuajse ishte bllokuar funksionimi i organit më të lartë në komunë (Kuvendit), menjëherë pas zgjedhjes së kryesuesit është vërejtur normalizim i funksionimit të këtij organi.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës ka miratuar një numër vendimesh, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e tyre janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Gjithsej Kuvendi ka miratuar 5 Rregullore dhe 35 Vendime, e po ashtu ka nxjerrë 3 konkluzione[5].
Ndër aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës, të cilat po ashtu nuk janë përcjellë për shqyrtim administrativ në MAPL është Rregullorja për shërbimet publike komunale dhe emergjencë. Përveç, kësaj është miratuar gjithashtu Rregullorja për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të larta në Komunën e Rahovecit. Në këtë mbledhje gjithashtu është ndryshuar përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, meqenëse ka pasur lëvizje të kuvendarëve nga një subjekt politik në tjetrin, dhe për shkak të zgjedhjes së kryesuesit të ri të Kuvendit. Akt të përgjithshëm juridik tjetër i miratuar në këtë periudhë është edhe Rregullorja për lehtësirat për investuesit e jashtëm dhe bizneset vendore fillestare. Po ashtu, është ndryshuar

[5] Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka nxjerrë akte të quajtura Konkluzione. Me një Konkluzion, në mbledhjen e muajit nëntor, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar Rekomandimin e KPF-së në lidhje me kërkesën e tre qytetarëve të Rahovecit për regjistrimin e pronës private në regjistrat kadastral në mënyrë që pas kësaj procedure, të fitojnë të drejtën e ushtrimit të kërkesës për ndërrimin e pronës. Në këto raste, Kuvendi i Komunës së Rahovecit vetëm ka ndërruar emërtimin e akteve (vendimeve), duke i titulluar konkluzione, ndërkaq në përmbajtje vërehet se rregullojnë marëdhënie të **akteve individuale administrative**. LVL nuk parasheh në kompetencë të kuvendit të Komunës të miratoj akte të titulluara konklzuione. Për më tepër, kjo paraqet jokompetencë lëndore të Kuvendit të Komunës pasi që në përmbajtje figurojnë të jenë vendime administrative. Nisur nga llojet e akteve të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës për të nxjerrë, del që aktet e tilla administrative do duhej t'i përkisnin Drejtorisë përkatëse në komunë. Gjithashtu, nga përmbatja e këtij akti (konkluzioni) vërejmë që komuna lë hapësirë për ndërrimin e këmbimit të pronës private me atë komunale, ndërkoh që Ligji për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr,04/L-144 në nenin 2.1 përcakton që "këmbimi i pronës komunale me personat fizik dhe juridik inicohet vetëm nga Komuna, e jo nga pronari privat".

Rregullorja mbi përcaktimin e kushteve higjieniko-teknike të objekteve afariste për qarkullim të mallrave dhe shërbimeve dhe Rregullores mbi kompensimet në procedurën e kryerjes inspektuese për përmbushjen e kushteve higjienike - teknike.

**Të gjeturat**

Megjithëse me zgjedhjen e kryesuesit të ri u vendos ritëm i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve, substanciale mbetet çështja e nxjerrjes së akteve të përgjithshme juridike për të cilat ekzistojnë supozime të bazuara për shkelje ligjore. Gjithashtu nuk janë zbatuar procedurat me rastin e nxjerrjes së akteve të caktuara, ka pasur jokompetencë lëndore të Kuvendit në disa raste, moskonsultim të legjislacionit përkatës, moszbatim të kërkesave për rishqyrtim të akteve, si dhe probleme me respektimin e Rregullores së Punës së Kuvendit, përkatësisht mënyrën e debatimit në Kuvend, mënyrën dhe procedurën e votimit - pasi që është shënuar një rast kur nuk është konstatuar saktësisht numri i votave të kuvendarëve prezent, nxjerrje e vendimeve me pa shumicë të votave[6], si dhe një rast i zhvillimit të punimeve të kuvendit pa kuorum.

Sa i përket mënyrës së votimit në Kuvendin e Rahovecit, me rastin miratimit të akteve të caktuara, nuk vërtetohet saktësisht orientimi i të gjithë anëtarëve të kuvendit me rastin e votimit për një çështje të caktuar. Ky problem është vërtetuar gjatë monitorimit të drejtëpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendit, ku është vërejtur se kryesuesi i kuvendit në një rast nuk ka përmendur orientimin e 4 anëtarëve të kuvendit nëse ata kishin abstenuar, gjë e cila ka shkaktuar paqartësi në vërtetimin e rezultateve të votimit. Ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të procesverbalit të mbledhjes së kuvendit të komunës.

Në bazë të monitorimit të rregullt të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, mund të konstatojmë disa nga gjetjet e mëposhtme gjatë kësaj periudhe. Në këtë Kuvend janë miratuar një numër i vendimeve të kundërligjshme. Janë një numër rastesh kur Kuvendi i Komunës ka nxjerrë akte të titulluara Aktvendime, gjë që nuk përkon me llojet e akteve që mund t'i nxjerr Kuvendi i Komunës të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Gjithashtu, duhet përmendur se Komuna e Rahovecit nuk ka marrë në rishqyrtim disa nga vendimet për të cilat Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vlerësuar se janë të kundërligjshme. Sipas nenit 82 të LVL-së, në rastet kur autoriteti mbikëqyrës e konstaton një vendim apo akt komunal në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet, autoritetet komunale janë të obliguara që brenda 30 ditësh t'i përgjigjen kërkesës për rishqyrtim nga data e pranimit të kërkesës. Mirëpo, është vërejtur se gjatë periudhës janar-dhjetor, shumica e vendimeve të kontestuara nga autoriteti mbikëqyrës nuk janë futur në rend dite për rishqyrtim në Kuvendin e Komunës së Rahovecit. Vendimet e tilla ende figurojnë në arkivën e komunës dhe heshtën si të tilla, prandaj ato mund të prodhojnë efekte juridike në të ardhmen. Në bazë të kësaj, mund të konstatojmë se në këtë komunë vazhdojnë të jenë ende ekzistente vendime të Kuvendit të Komunës me bazë të kundërligjshme, që bien ndesh me kushtetutën, dhe me ligjet e ndryshme sektoriale që prekin kompetenca të nivelit lokal.

Rastet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit:

1) Në mbledhjen e muajit mars Kuvendi i Komunës së Rahovecit me Aktvendim miratoi propozimin për kthimin e tokave të NBI-"Rahoveci" në emër të Komunës së Rahovecit. Me këtë Aktvendim komuna ka përcaktuar të "ndërpritet shfrytëzimi i mëtutjeshëm i tokës bujqësore në

pronësinë shtetërore NBI “Rahoveci” dhe rikthehet në emër të KK Rahovec”.[7] Me këtë vendim Komuna e Rahovecit pretendon që të ndërpres shfrytëzimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore NBI “Rahoveci” në Rahovec dhe këto prona të rikthej në emër të KK Rahovec. Fjala është për sipërfaqe prej 560.00 Ha tokë bujqësore, përkundër faktit se për këto asete të NSH-je nuk ka përfunduar procesi i privatizimit dhe se ato janë në procedurë të likuidimit.

2) Me datë 20.03.2012 Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar Aktvendim me të cilin ndryshohet diapozitivi nën II, al.l. i aktvendimit të plotëfuqishëm 01 Nr. 242/05 datë 22.11.2006 me të cilën përjashtohet nga posedimi, ngastra kadastrale nr.1314, sipas kulturës ndërtesë në sipërfaqe prej 0.01,20 Ha dhe oborr në sipërfaqe prej 0.03,04 nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.809 z.k. Hoçë e Madhe dhe e njëjta i rikthehet Komunës së Rahovecit në pronësi dhe posedim të lirë, megjithëse në bazë të aktvendimit të plotëfuqishëm të KK Rahoveci 01,n4.242/05 dt.2211.2006 është aprovuar kërkesa e NTSH “Podrima” Rahovec për bartjen administrative të pronës së paluajtshme nga Kuvendi Komunal Rahovec në emër të NTSH “Podrima” Rahovec. Ky vendim është kundërshtuar po ashtu nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit duke theksuar se procesi i privatizimit në këtë pronë nuk ka përfunduar.[8]

3) Kuvendi gjithashtu ka miratuar Vendimin për shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, pronat në shfrytëzim të ndërmarrjes “Ekonomia e Pyjeve”, OP “Sharri” dhe disa ngastra në pronësi shtetërore të Kosovës, i shpallë Zonë e veçantë të interesit publik komunal. Për më tepër, në nenin 3 të këtij Vendimi theksohet se ”Komuna e Rahovecit, si Njësi kompetente e autoriteti publik, fiton të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri me regjistrimin e saj në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”- paragraf i cili bie në kundërshtim me vetë qëllimin e Vendimit.[9]

4) Edhe mbledhja e dytë e rregullt, po ashtu e mbajtur në muajin mars, me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore nuk ka kaluar pa shkelje ligjore. Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës, me Aktvendim ka miratuar kërkesën e Kompanisë KNGS sh.p.k.- Prishtinë për dhënien në shfrytëzim me koncesion të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin dhe

[7] Shqyrtimi i ligjshmërisë së këtij vendimi është kërkuar edhe nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Sipas kërkesës në fjalë dhe raportit të monitorimit, MAPL ka vlerësuar këtë vendim duke konstatuar se: Vendimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit Nr.22/2012 i datës 20.03.2012 është në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067, dhe Ligjin për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.03/L-226, në të cilin është përcaktuar që Komuna ka të drejtë të shkëmbejë pronën e paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore që janë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, konform procedurave të parapara me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. MAPL po ashtu me këtë shkresë ka kërkuar që Komuna e Rahovecit të rishqyrtoj vendimin e fjalë. Shkresa në fjalë e MAPL-së ka efekt për të gjitha rastet e ngjashme ku Komuna ndërmerr veprime juridike për të transformuar pronat shoqërore në çfarëdo forme. Edhe pse në një periudhë kohore më shumë se gjysmë viti Komuna e Rahovecit nuk mori parasysh shkresat e MAPL-së, në mbledhjen e muajit tetor Kuvendi i Komunës ktheu për rishqyrtim dy vendime që bien ndesh me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067.

[8] MAPL ka dhënë përgjigje në kërkesë për këtë vendim, duke e vlerësuar vendim që bie në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe U.A. nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për DHënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Për këtë rast, MAPL ka kërkuar që Komuna e Rahovecit të rishqyrtoj dhe shfuqizoj këtë vendim.

[9] Në përmbajtjen e këtij vendimi, është trajtuar dhe vendosur për dy çështje të ndryshme: njëra për shpalljen e zonës së veçantë të interesit të përgjithshëm dhe tjetra për marrjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e tyre në emër të komunës. Për shkak të mosdërgimit të akteve nga Komuna e Rahovecit për të mundësuar shqyrtimin administrativ, ligjshmëria e këtij vendimi ende nuk është vlerësuar. Deri në vlerësimin e ligjshmërisë së këtij vendimi nga organi mbikëqyrës, ai mbetet i pazbatueshëm dhe nuk mund të krijoj efekte juridike.

operimin e objektit për tregtimin e lëndëve djegëse – gazit të naftës së lëngëzuar, në kohëzgjatje prej 10 (dhjet) viteve dhe me të drejtë vazhdimi[10].

5) Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka nxjerrë Vendim me të cilin kompanisë NPHT "Gastro-Kos" nga Prishtina i ka vazhduar kontratën për shfrytëzimin e Hotelit "Park" në Rahovec edhe për gjashtë muaj, megjithë skadimin e kontratës. Mundësia e vazhdimit të kontratës shfrytëzuesve të pronës komunale nuk është përcaktuar me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

6) Kuvendi i Komunës së Rahovecit në muajin prill ka nxjerrë Aktvendim për aprovimin e kërkesës së Beqir Sadik Hamza nga Rahovecit për dhënien në shfrytëzim pa kompensim, si rast social për ndërtimin e shtëpisë banesore, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh me të drejtë vazhdimi, ngastra ndërtimore në pronësinë shtetërore nr. 301-3, sipas kulturës arë e kl. 4 në sipërfaqe prej 0.03,50 ha, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 7 z.k. Bërnjakë, PSH e Kosovës, KK Rahovec[11].

7) Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e muajit maj ka nxjerrë Aktvendim me të cilin bartet e drejta e pronës së paluajtshme nga PSH e Kosovës, në emër të Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Është fjalë për paluajtshmërinë në shfrytëzim të Qendrës së Mjekësisë Familjare Krushë e Madhe, ngastra kadastrale nr. 913, ndërtesë në sipërfaqe prej 267 m2, oborr në sipërfaqe prej 500 m2 dhe kullosë në sipërfaqe prej 393 m2, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 1. z.k. Krushë e Madhe. [12]

8) Me datën 29.06.2012 Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka nxjerrë Aktvendim për aprovimin e kërkesës së Adem Hasanaj me të cilën i ndahet në shfrytëzim pa të drejtë tjetërsimi, toka ndërtimore në pronësi shoqërore për ndërtimin e shtëpisë banesore në kohëzgjatje prej 10 (dhjet) vjet, me të dejtë vazhdimi, ngastra kadastrale nr. 2240/43, në vend të quajtur "Krajishtë",

---

[10] Së pari, ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Neni 5.3 i këtij ligji përcakton se Kuvendi i Komunës ka të drejtë të japë në shfrytëzim pronën e paluajtshme në afat më të gjatë së dhjetë (10) vjet por jo më shumë së dyzet (40) vjet pas plotësimit të kritereve të përcaktuara më Ligjin për prokurimit dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pëlqimit paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e tregtisë dhe Industrisë. Së dyti, vendimi është thirrur në Ligjin Nr. 03/L-090 mbi partneritetet publiko privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre. Nëse i'u referohemi dispozitave të këtij ligji, atëherë kërkesa e drejtuar kuvendit të komunës së Rahovecit ka të bëjë me një propozim të pa kërkuar nga autoriteti kontraktues (komuna). Për zbatimin e kësaj kërkese komuna duhet të respektoj dispozitat e nenit 38, 39 dhe 40 të këtij ligji. Gjithashtu, në këtë ligj parashihet që për aprovimin e kërkesave (propozimeve) duhet të inicohet procedura tenderuese pas aprovimit të KDNM-PPP (organ përgjegjës për kontrollimin dhe koordinimin e Projekteve të PPP) dhe pas kësaj të iniciohet procedura konkurruese e përzgjedhjes sipas neneve 23 deri 25 të po të njëjtit ligj. Këtij vendimi ende nuk i është bërë vlerësimi i ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës. Kjo mund të realizohet pas procedimit nga komuna për shqyrtim administrativ, andaj deri në shqyrtimin e ligjshmërisë nuk mund të konsiderohet akt me fuqi të plotë juridike.

[11] Ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nr. 03/L-226. Ligji në të cilën është thirrur ky aktvendim në bazën ligjore, nuk rregullon çështjet e dhënies në shfrytëzim të paluajtshmërive pa përfillur procedurat e prokurimit publik, edhe nëse janë raste sociale.

[12] Komuna e Rahovecit nuk ka përcjellë këtë vendim për nevoja të shqyrtimit administrativ. Për të shqyrtuar ligjshmërinë e këtij vendimi, MAPL ka kërkuar nga Komuna e Rahovecit qasje në dokumentet mbi të drejtat në pronësinë e këtyre ngastrave. Komuna e Rahovecit nuk ka dërguar ndonjë dokument që do të vërtetonte të drejtat pronësore mbi ngastrat të cilat janë objekt i ndryshimit apo bartjes së të drejtës në pronën e paluajtshme.

sipas kulturës kullosë e kl. 5, tani truall në sipërfaqe prej 0.03,00 ha, nga fleta e posedimit nr. 611 z.k. Rahovec.[13]

9) Në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2012 Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar Vendimin mbi kushtëzimin e shfrytëzuesve të shërbimeve komunale. Sipas këtij vendimi obligohen të gjitha bizneset dhe institucionet në tërë Komunën e Komunën e Rahovecit dhe banorët e qytetit të Rahovecit, të cilat shfrytëzojnë shërbimet komunale në grumbullimin dhe transportin e mbeturinave organike, të ofruara nga kompanitë e kontraktuara nga Komuna dhe kushtëzohen të dëshmojnë me kontratë apo vërtetim për shlyerjen e borxheve ndaj kompanive të kontraktuara me rastin e nxjerrjes së dokumentacioneve, si vijon: Vërtetimin mbi taksat komunale për regjistrimin e automjeteve, dokumentacionin kadastral, lejet ndërtimore, vazhdimi i pëlqimit të lejeve të punës për biznes.[14]

10) Në mbledhjen e datës 28 shtator, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka nxjerrë vendim për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për lejimin e deponimit të mbeturinave të ngurta në Rahovec. Në pjesën përshkruese të vendimit theksohet se SHIL – UÇK në Rahovec, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm prona komunale në parcelën nr. 2356, në vendin e quajtur "te rrasat", me kulturë kullosë, e klasës së V, z.k. Rahovec, pronë e KK Rahovec, për lejimin e deponimit të mbeturinave të ngurta[15].

11) Sipas vlerësimit të Komisionit të përbashkët MF/MAPL, Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba e miratuar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, duhet të harmonizohet me legjislacionin në fuqi[16]. Komuna ende nuk ka inkorporuar ndryshimet e kërkuara.

12) Në mbledhjen e datës 30 tetor, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar Rregulloren për tatimin në pronë për vitin 2013. Edhe pse me Ligjin nr.04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.03/L-204, përkatësisht në nenin

---

[13] Siç vërejmë në dispozitiv të këtij Vendimi, kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të pronësisë shoqërore, cka nënkupton faktin se komuna nuk është e autorizuar të menaxhoj me këto prona dhe të jetë pjesë e çfarëdo veprimeve me të cilën jepen autorizime të caktuara për palët. Ndërsa, në anën tjetër, dhënia në shfrytëzim e pronës nuk mund të realizohet pa përfillur dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nr. 03/L-226 dhe dispozitat e Ligjit mbi prokurimin Publik. Ky vendim ende nuk i është nënshtruar procesit të rishikimit administrativ.

[14] Pas dërgimit të kërkesës për rishqyrtimin e këtyre vendimeve nga MAPL, Komuna e Rahovecit në mbledhjen e mbajtur në muajin tetor ka nxjerrë Vendim për ndryshimin e Vendimit mbi kushtëzimin e shërbimeve komunale në grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave 01 Nr.2907 të datës 29.06.2012. Mirëpo, Kuvendi në këtë rast ka lënë në fuqi pikën 1 të Vendimit të mëhershëm, duke kushtëzuar nxjerren e Vërtetimit mbi takstat komunale për regjistrimin e automjeteve, me shlyerjen e obligimeve për mbeturina.

Megjithëse, ky vendim nuk është shqyrtuar nga aspekti i ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, konsiderojmë se është vendim i cili nuk ka bazë ligjore. Komuna nuk ka të drejtë të vendos hushtëzime të tilla për qytetarët në kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike, përveç detyrimit të pagesës së tatimit në pronë i cili mund të bazohet në Udhëzimin Administrativ Nr.3/2004.

[15] Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit me të cilin jepet në shfrytëzim të prona komunale, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ky vendim nuk ka as edhe një dispozitë konkrete të këtij ligji që do t'i mundësonte komunës të drejtën për të dhënë në shfrytëzim pronën komunale në këtë mënyrë, çoftë edhe për kategoritë e veçanta shoqërore. Gjithashtu, një formë e tillë e dhënies në shfrytëzim për këto organizata nuk është parapa as me Ligjin Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

[16] Neni 13 tabela (b) e Rregullores është në kundërshtim me U.A. 2006/1 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, meqë kjo është kompetencë e deleguar e Komunave dhe rregullimi i kësaj materie duhet të bëhet vetëm konform dispozitave të cilat i përmban udhëzimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Neni 17 i Rregullores i cili rregullon taksat në fushën e shëndetësisë të harmonizohet me Shtojcën 1 (a) për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor, konform U.A. 04/2007 për Mbledhjen dhe Shfrytëzimin e Mjeteve nga Bashkëpagesat e Shfrytëzuesve për Shërbimet Shëndetësore.

7 (Shkalla e Tatimit) përcaktohet që "Kuvendi komunal i çdo komune i cakton tarifën tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën tatimore prej zero pikë pesëmbëdhjetë për qind (0.15%) deri në një për qind (1%) të vlerës së pronës në treg", në këtë mbledhje shkalla e koeficientit është zvogëluar në 0.10% e që bie në kundërshtim me dispozitën e cituar më lartë.

Vlerësuar nga aspekti i ligjshmërisë, nxjerrja e vendimeve të tilla ka sjellë deri nxjerra e akteve duke gabuar në procedurë dhe formë, si dhe ka pruar deri tek jokompetenca e Kuvendit të Komunës për të nxjerrë vendime që më tepër i përkasin karakterit administrativ. Këto veprime kanë sjellë deri tek shkelja materiale e ligjit që do të thotë se nuk janë zbatuar dispozitat materiale të cilat është dashur të aplikohen dhe gabimisht janë interpretuar si dhe zbatuar dispozitat juridike të cilat është dashur të zbatohen në formën që parasheh ligji.

**Komuna e Deçanit**

Gjatë periudhës janar-dhjetor, Komuna e Deçanit ka qenë mjaft aktive në zhvillimin e takimeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve. Në këtë periudhë Kuvendi ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Sa u përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, Kuvendi ka thirrur gjithsej 3 mbledhje. Gjendja e rëndë e pyjeve ka qenë temë e vazhdueshme e diskutimeve në kuvend, kështu që një mbledhje e jashtëzakonshme është thirrur pikërisht për këtë temë. Në këtë mbledhje, Kuvendi, me qëllim të mbrojtjes së pyjeve miratoi Moratorium të përkohshëm, me të cilin do të ndërpriteshin të gjitha kontratat me operatorët ekonomik të cilët posedonin leje për prerje të pyjeve, deri në vlerësimin e gjendjes së krijuar. Ndërsa, mbledhja e dytë e jashtëzakonshme është mbajtur për shkak të situatës së krijuar nga reshjet e mëdha të borës për të cilën komuna kishte shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për ndarjen e 80.000 € për tejkalimin e kësaj situate. Krahas kësaj, në muajin mars Kuvendi thirri mbledhjen tjetër të jashtëzakonshme, në të cilën unanimisht përkrahu themelimin e grupit të grave këshilltare të këtij kuvendi, me qëllim të sigurimit të respektimit të Ligjit për barazi gjinore.

Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar një numër vendimesh. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar gjithsej 25 vendime dhe 2 rregullore. Në mesin e disa vendimeve është edhe Rregullorja për taksa dhe ngarkesa për shërbimet komunale, miratimi i së cilës kërkohet edhe me Ligjin për financat e pushtetit lokal. Ndërsa, në mbledhjen e parë të rregullt sipas planit të miratuar për vitin 2012 e mbajtur po ashtu në muajin janar, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar dhe miratuar vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Fabrikës së Mjaltit[17], ndërkohë është miratuar edhe Plani i punës së Kuvendit për vitin 2012. Po ashtu, Kuvendi ka aprovuar raportin teknik financiar të projekteve kapitale për vitin 2011. Në këtë mbledhje është miratuar gjithashtu vendimi për preorientimin e të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar.

Rrjedhojë e punës së kuvendit ka qenë edhe shtyrja e shqyrtimit të raportit të shpenzimeve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për shkak të mosprezencës së drejtorit të kësaj drejtorie. Kurse, ndër çështjet kryesore të kësaj mbledhje ishte shqyrtimi i raportit mbi shpenzimet e mjeteve të ndara muaj më parë nga Kuvendi për tejkalimin e gjendjes së krijuar nga reshjet e borës, ku edhe pati një varg kritikash nga opozita për mënyrën e menaxhimit të këtyre mjeteve.

[17] Projekt i financuar nga Komisioni Evropian

Duke ditur defektet në Statutin e Komunës së Deçanit dhe problemet e vazhdueshme që ka shkaktuar në praktikë, dhe duke marrë parasysh se numri i drejtorive të komunës nuk përputhet me numrin e kërkuar me Statut, e po ashtu edhe një nen i cili parasheh miratimin e propozim-buxhetit me 2/3 e votave (i cili është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale), komuna e ka parë të nevojshme themelimin e një komisioni me qëllim të ndryshimit të këtij Statuti. Si rrjedhojë, në këtë mbledhje Kuvendi ka aprovuar vendimin për themelimin e Komisionit të përbashkët me detyrë të inicimit të procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës. Përkundër kësaj, ende ky Statut ka mbetur pa u ndryshuar dhe plotësuar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe konform organizimit të brendshëm të administratës së komunës.

Sa i përket punës së Komiteteve obligative, ato kanë qenë funksionale edhe në këtë periudhë. Edhe Komuna e Deçanit ka numër të vogël të komuniteteve pakicë, megjithatë përfaqësimi në Komitetin për Komunitete përfshinë pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, një pjesëtar të komunitetit serb, përfaqësues të fshatrave dhe pjesëtar nga komuniteti shqiptar. Ky komitet ka gjithsej 7 anëtarë.

Në lidhje me komitetet e tjera, e posaçërisht atyre konsultative, edhe në Komunën e Deçanit nuk është themeluar asnjë i tillë. Duhet përmendur që, themelimi i këtyre komiteteve përveç aspektit të sjelljes së qytetarëve më afër hartimit të politikave, dhënies së propozimeve dhe hulumtimeve të ndryshme, ka edhe aspektin pozitiv profesional që mund të ofrojnë këto komitete, ngase përbërja e tyre përfaqëson persona (ekspertë) të fushave përkatëse. Andaj, komuna duhet t'i kushtoj vëmendje më të theksuar themelimit të këtyre komiteteve.

**Të gjeturat**

1) Në mbledhjen e mbajtur në Korrik, Kuvendi i Komunës së Deçanit mbi bazën e kërkesës së Kompanisë "Hidrodrini", ka nxjerrë vendim për kushtëzim të regjistrimit të makinave, me pagesën e obligimeve të ujit. Edhe pse ky vendim është miratuar me shumicë të votave në Kuvend, nuk është nënshkruar nga kryesuesi i kuvendit, pasi që nuk ka bazë ligjore.

2) Pas miratimit të Udhëzimit Administrativ nr. 2012/01 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative "Teleprezencave" është vërejtur se Komuna e Deçanit nuk po i përmbush obligimet ligjore lidhur me krijimin e qasjes aktive për përdorim të sistemit të teleprezencës, si parakusht për monitorim në distancë të veprimtarisë së Kuvendit të Komunës nga ana e zyrtarëve të Ministrisë. Për të sqaruar më saktë, mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Deçanit në periudhën tetor-dhjetor, nuk janë monitoruar për shkak të mosfunksionalizimit të pajisjeve të teleprezencës dhe krijimit të qasjes së transmetimit nga Komuna e Deçanit. Në përpjekje për të vënë në kontakt zyrtarin përgjegjës të Komunës së Deçanit për të rregulluar transmetimin e mbledhjeve pas pengesave të paraqitura, zyrtari i përgjegjës i Komunës së Deçanit nuk i është përgjigjur kërkesës së MAPL-së për të vënë në funksion pajisjet e teleprezencës.

Në bazë të nenit 4 pika 1 të Udhëzimit Administrativ të lartcekur, Organet e Komunës janë të obliguara të sigurojnë qasje aktive në përdorimin e sistemit të teleprezencës, me qëllim të krijimit të kushteve për monitorim dhe vlerësim të proceseve nga organi mbikëqyrës përmes stafit të teknologjisë informative.

Kurse sipas nenit 7.1 të këtij Udhëzimi Administrativ, Komuna është e obliguar në vazhdimësi të siguroj të gjitha aspektet për funksionimin e teleprezencës gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Krijimi i qasjes së rregullt të pajisjeve të teleprezencës është obligim ligjor dhe komuna është e obliguar të respektoj.

**Komuna e Junikut**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta. Me qëllim të ofrimit të transparencës për qytetarë, në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut janë transmetuar direkt mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Paraprakisht komuna në adresën zyrtare është kujdesur në informimin e qytetarëve lidhur me kohën e mbajtjes së mbledhjeve dhe njoftimin për transmetimin direkt të punimeve të kuvendit. Kësisoj, përveç lidhjes direkte me MAPL për të monitoruar mbledhjet, komuna ka krijuar edhe aplikacionin për qytetarë ku ata mund të klikojnë për të vëzhguar punimet e kuvendit. Kjo është një praktikë e mirë e Komunës së Junikut, e cila ka treguar efikasitet në menaxhimin e pajisjeve për teleprezencë për qëllime informuese. Përveç kësaj, ueb-faqja zyrtare është azhurnuar në vazhdimësi për aktivitetet e komunave. Mirëpo, ende mbetet për t'u përmirësuar sistemi i publikimit të akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës.

Sa u përket Komiteteve të obligueshme, Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës janar-dhjetor 2012 ka mbajtur gjithsej 11 takime. Si rregull, komiteti është thirrur para mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit, në të cilin janë trajtuar çështjet kryesore të planifikuara për shqyrtim në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.
Ndërsa, edhe pse Komuna e Junikut nuk ka komunitete pakicë, përfaqësimi në Komitetin për Komunitete rrjedh nga radhët e komunitetit shumicë. Andaj, përbërja e këtij komiteti reflekton përfaqësuesit e lagjeve të ndryshme të Komunës së Junikut. Formimi dhe funksionalizimi i këtij komiteti është përmbushje e një pjese të kuadrit ligjor për vetëqeverisje lokale nga Komuna e Junikut. Në këtë kontest, Komiteti ka qenë funksional dhe është mbledhur 11 herë. Ndër temat kryesore të diskutuara në mbledhjet e komitetit kanë qenë projektet kapitale për vitin 2012, çështje të sigurisë së qytetarëve, shërbimet publike etj.

Në lidhje me aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës, gjatë kësaj periudhe, janë miratuar gjithsej 29 vendime dhe 5 rregullore. Në mesin e akteve, është është miratuar Rregullorja për kriteret e përdorimit të pijeve alkoolike në lokalet publike në Komunën e Junikut, Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare dhe Rregullorja për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës. Poashtu është miratuar Plani Rregullues Urban "Njësia Gacafer-Pepsh". Pjesë e punës shqyrtuese të Kuvendit kanë qenë edhe disa raporte, siç ishte Raporti për projektin e rregullimit të shtratit të lumit "Erenik", gjegjësisht faza e dytë e projektit, si dhe vendimi mbi plotësimin e numrit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit të Komunës. Janë bërë disa ndryshime në Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe një anëtar i Kuvendit të Komunës është zëvendësuar me anëtar të ri. Në muajin maj Kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2012, si dhe ka nxjerrë një vendim për themelimin e çmimit Kuvendi i Junikut. Po ashtu kuvendi ka ndryshuar logon e Komunës së Junikut me arsyetimin e mungesës së elementeve esenciale që do duhej t'i përmbante. Gjithashtu është miratuar edhe Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës së Komunës.

**Të gjeturat**
1) Gjatë kësaj kanë qenë prezente disa problemeve në transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit 2012 përmes teleprezencës, mirëpo që në muajt e fundit të vitit 2012 ato u evituan.

2) Një çështje tjetër që lidhet me obligimet ligjore të komunës është përgjegjësia për dërgimin e akteve komunale për shqyrtim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës. Komuna e Junikut në këtë pikë nuk ka qenë edhe aq e saktë, pasi që mungon një rrjedhë konstante e këtij procesi – jo të gjitha aktet janë dërguar për këtë qëllim.

**Komuna e Istogut**
Rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës së Istogut gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2012 ka qenë normale. Procedurat paraprake të mbledhjeve të Kuvendit janë respektuar, që do të thotë se dërgimi i ftesës dhe materialit përmbledhës të kuvendit është bërë sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në këtë periudhë të raportimit, Kuvendi i kësaj komune ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta. Komitetet obligative kanë funksionuar me rregull - KPF ka mbajtur 9 takime, kurse KK ka mbajtur 10 takime. Gjatë kësaj periudhë raportuese, nuk është evidentuar ndonjë rast i bojkotimit të mbledhjes nga ana e opozitës. Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për publikun. Koha e mbajtjes së mbledhjeve është publikuar rregullisht në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen e komunës. Monitorimi i mbledhjeve është bërë përmes sistemit të teleprezencës, sistem ky i cili ka funksionuar mjaft mirë në këtë Komunë.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar Rregulloren për Transparencë Komunale, me ç'rast pas dërgimit për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL, Ministria në fjalë ka kërkuar që Rregullorja për transparencën në Komunën e Istogut, konkretisht neni 6 pika 7 e kësaj rregulloreje të harmonizohet me nenin 5 pika 2 të Udhëzimit Administrativ për Transparencën në Komuna Nr.2008/03[18].
Ajo që vlen të theksohet është se në muajin janar Kryetari i Komunës së Istogut për shkak të dëmeve të shkaktuara nga stuhia e erës ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës ka raportuar për dëmet e shkaktuara nga kjo stuhi, edhe pse një veprim i tillë nuk është i lejuar me legjislacionin në fuqi.
Konform me obligimet ligjore Kryetari i Komunës së Istogut gjatë vitit 2012 ka raportuar 2 herë para anëtarëve të Kuvendit.

Ndër aktet e miratuara gjatë kësaj periudhe janë: Miratimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis; Vendimi për hedhjen në diskutim publik të Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Istogut; Rregullorja për transparencën komunale; Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare; Rregullorja për Disiplinën dhe Kodin e Mirësjelljes në shkollat e Komunës së Istogut; Rregullorja për Punën e Institucioneve Arsimore të Komunës së Istogut; Rregullore për procedurat e dhënies së objekteve dhe tokës komunale në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik; Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

[18] Komuna e Istogut e ka kthyer për shqyrtim këtë Rregullore dhe ka bërë plotësimet e nevojshme konform udhëzimeve të dhëna nga MAPL brenda afateve të parapara ligjore.

në përbërje prej 24 anëtarëve; Vendimi për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e komunës së Istogut, etj.

## KOMUNAT: PRISHTINË, GJILAN, PRIZREN, PEJË, KAMENICË DHE NOVOBËRDË

### Mbledhjet e mbajtura

Raporti i funksionimit të komunave për periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 është ndërtuar si rezultat i punës së vazhdueshme të procesit të monitorimit, mbledhjes së të dhënave dhe vlerësimit të gjendjes reale të paraqitur në Komunat: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë. Duhet theksuar se avancimi i teknologjisë informative, në këtë rast instalimi i sistemit të teleprezencës në organin mbikëqyrës dhe në komunat e lartpërmendura, ka rritur efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të monitorimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ku kjo mënyrë e monitorimit dhe e komunikimit ka mundësuar një lidhje direkte me Kuvendin.

Gjithashtu, realizimi i planit të monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës si dokument bazë përmes së cilës janë përcaktuar objektivat kryesore të monitorimit të komunave, përqendrim i ka dhënë mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të punës së organeve të Komunës. Takimet me zyrtarët e lartë të Komunës së Prishtinës, Gjilanit, Prizrenit, Pejës, Kamenicës dhe Novobërdës kanë mundësuar krijimin e një përshtypje të qartë për nivelin e arritjeve të komunave.

Funksionimi i punës së Kuvendeve të këtyre komunave, ka rrjedhur normalisht duke respektuar planet e punës. Në përgjithësi, kuvendet e komunave në një masë të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Për këtë periudhë raportuese, në Komuna vërehet një organizim dukshëm më i mirë në planifikimin e aktiviteteve, orarin e takimeve, në miratimin e planeve vjetore të punës dhe të çështjeve të tjera me rëndësi. Kryesisht, debatet që janë zhvilluar gjatë punimeve të kuvendit kanë qenë konstruktive, ku në to nuk ka munguar liria e shprehjes, e mendimit të lirë, mirëkuptimit, shfrytëzimit të kohës në mënyrë racionale, si dhe duke mos tejkaluar limitet kohore ashtu siç parashihet me rregulloret e punës së kuvendeve. Sa i përket aspektit kuantitativ të vlerësimit të punës së kuvendeve, kuvendet e komunave kanë përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Ndërsa, sa i përket aspektit kualitativ, Komunat kanë ngritur shkallën e dëshiruar në çështjet procedurale dhe në procesin e punës duke respektuar Rregulloren e punës së Kuvendit.

Lidhur me çështjen se sa kanë respektuar kuvendet e këtyre komunave rendin e ditës, pothuajse në shumicën e rasteve, mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të këtij rendi. Gjithashtu, me qëllim të rritjes së transparencës komunale, të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun, ku në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve, nga televizionet lokale. Përveç kësaj, Komunat përdorin edhe mundësi të tjera të informimit si: ueb-faqja zyrtare komunale, buletini, tabela me shpallje në hyrjen kryesore të komunës, nxjerrja e përmbledhjeve të akteve komunale. Lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqeve zyrtare të Komunave, duhet theksuar se është arritur progres në këtë drejtim, por ende mbetet për tu dëshiruar në funksionimin e plotë dhe të vazhdueshëm të tyre me theks të veçantë në faqen e gjuhëve të tjera. Po ashtu, vlen të përmendet

se ka qenë evidente pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare dhe vendore në mbledhjet e kuvendit si: OSBE, USAID, DEM-i, LOGOS, ICO, KFOR, OJQ-të e ndryshme, mediet dhe qytetarë të interesuar. Ndërkaq, është për tu vlerësuar interesimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në mbledhjet e kuvendit. Kur jemi tek numri i mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2012, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithsej 71 mbledhje, prej tyre 66 të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme.




| | Prishtinë | Gjilan | Prizren | Pejë | Kamenicë | Novobërd |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 12 | 11 | 9 | 10 | 12 | 12 |
| Mb.e jashtëzakonshme | | | 1 | 0 | 2 | 2 |

**Fig.7** *Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë*

Nga tabela e sipërme vërejmë se në periudhën janar-dhjetor të vitit 2012, të gjitha kuvendet e komunave kanë respektuar LVL-në, kështu duke përmbushur obligimet e tyre ligjore. Kuvendi i komunës së Kamenicës dhe Novobërdës kanë mbajtur nga 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, kuvendi i komunës së Prishtinës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, kuvendi i komunës së Gjilanit ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 3 solemne, kuvendi i komunës së Pejës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 solemne, ndërsa kuvendi i komunës së Prizrenit ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme.
Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor të vitit 2012.




| | Prishtinë | Gjilan | Prizren | Pejë | Kamenicë | Novobërd |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KPF | 12 | 11 | 13 | 10 | 12 | 12 |
| KK | 12 | 12 | 5 | 11 | 12 | 8 |

**Fig. 8.** *Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë, dhe Novobërdë.*

Nëse shikojmë dhe analizojmë të dhënat nga figura e mësipërme shohim se në Komunën e Prishtinës dhe të Kamenicës, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 12 mbledhje, në Komunën e Gjilanit, KPF ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa KK 12 mbledhje, në Komunën e Prizrenit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 13 mbledhje, kurse KPF 5 mbledhje, në Komunën e Pejës KPF ka mbajtur 10 mbledhje, kurse KK ka mbajtur 11 mbledhje, si dhe në Komunën e Novobërdës KPF ka mbajtur 12 mbledhje, ndërkaq KK 8 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, edhe gjatë kësaj periudhe Komunat: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë kanë qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale. Në figurën e mëposhtme kemi paraqitur të dhënat për aktet e miratuara në komuna veçmas:




| | Prishtinë | Gjilan | Prizren | Pejë | Kamenicë | Novobërd |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vendime | 56 | 70 | 57 | 43 | 59 | 68 |
| Rregullore | 2 | 4 | 4 | 1 | 4 | 7 |

**Fig.9** *Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë*

Në bazë të të dhënave vërejmë se, në miratimin e akteve komunale, më aktive janë treguar Kuvendi i Komunës së Gjilanit me 70 vendime, 4 rregullore dhe 2 rekomandime të miratuara, pastaj Kuvendi i Komunës së Novobërdës me 68 vendime dhe 7 rregullore të miratuara, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar 59 vendime, 4 rregullore dhe 3 pëlqime, Kuvendi i Komunës së Prizrenit me 57 vendime dhe 4 rregullore të miratuara, Kuvendi i Komunës së Prishtinës me 56 vendime dhe 2 rregullore të miratuara, si dhe në fund Kuvendi i Komunës së Pejës me 43 vendime dhe 1 rregullore të miratuara.

Me qëllim të forcimit të transparencës dhe krijimit të hapësirës që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes, Komunat për këtë periudhë raportuese kanë mbajtur takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, në periudhën janar – dhjetor 2012, Komuna e Prizrenit ka mbajtur më së shumti takime publike me qytetarë me gjithsejtë 8 takime, ndërsa Komuna e Gjilanit, Pejës, dhe Novobërdës kanë mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë, ndërkaq Komuna e Prishtinës dhe Kamenicës kanë mbajtur nga 1 takim publik me qytetarë.

LVL-ja, përkatësisht neni 58 pika j, parasheh që kryetari i komunës të raportoj para kuvendit të komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Në këtë periudhë raportuese, kryetari i komunës së Pejës ka raportuar 2 herë para kuvendit të komunës, kryetari i Komunës së Prishtinës, Kamenicës dhe Novobërdës kanë raportuar nga 1 herë para kuvendit të komunës, ndërsa kryetarët e komunave Prizren dhe Gjilan pritet të raportojnë në muajin janar të vitit 2013.

Po ashtu, këto komuna gjatë periudhës së vitit 2012, kanë mbajtur dëgjime publike me qytetarë lidhur me propozim buxhetin komunal për vitin 2013. Qytetarët e Komunave përkatëse kanë pasur mundësinë e dhënies së vërejtjeve, sugjerimeve, ndryshimeve dhe plotësimeve në çështjen e buxhetit komunal për vitin 2013. Më pas, buxheti komunal për vitin 2013 dhe korniza afatmesme buxhetore për vitin 2013-2015 ka kaluar në fazën e diskutimit final në mbledhjet e Kuvendit, ku dhe është miratuar nga ana e anëtarëve të kuvendit.

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

KKSB-ja si trup konsultues për çështjet e sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të një komune dhe përfaqësues të shoqërisë civile ka qenë pjesërisht funksionale për periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 në këto Komuna. MAPL dhe MPB, pas ndryshimeve të bëra në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012 MPB - 03/2012 MAPL, kanë kërkuar nga Komunat që të nxjerrin vendim për themelimin e KKSB-ve konform U.A-së së re. Në këtë drejtim, kuvendet e komunave: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë kanë respektuar obligimet ligjore, kështu duke nxjerr vendim për themelimin e KKSB-së.

Nëse i referohemi mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së për periudhën janar – dhjetor 2012, atëherë del të jetë se: Komuna e Prishtinës ka mbajtur 7 mbledhje, ku mbledhjet i ka kryesuar kryetari i komunës. Çështjet të cilat janë diskutuar, kryesisht kanë qenë të sektorit të sigurisë në territorin e Komunës së Prishtinës, për situatën emergjente gjatë reshjeve të borës etj. Vlen të përmendet se në muajin shkurt, është hartuar plani operativ i sigurisë nga zjarri për korrje-shirjet. Po ashtu, KKSB në Komunën e Prishtinës me qëllim të zgjerimit të ekipeve vepruese për siguri në bashkësi, kanë themeluar edhe një këshill lokal për komunitete.

Në Komunën e Gjilanit, KKSB ka mbajtur 6 mbledhje. Në këto mbledhje janë shqyrtuar temat e sigurisë së përgjithshme të komunës në të cilat kanë raportuar përfaqësuesit e PK-së dhe të KFOR-it. Këto mbledhje i ka kryesuar nënkryetari i Komunës. Në Komunën e Prizrenit, KKSB ka mbajtur 5 mbledhje. Mbledhjet janë kryesuar nga kryetari i Komunës. Në Komunën e Pejës dhe të Novobërdës, KKSB-të kanë mbajtur nga 4 mbledhje. Në Komunën e Pejës, mbledhjet i ka kryesuar nënkryetari i Komunës, kurse në atë të Novobërdës, mbledhjet i ka kryesuar kryetari i Komunës. Në Komunën e Kamenicës, KKSB nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Në përgjithësi, në këto komuna, temat të cilat janë diskutuar kanë qenë kryesisht të fushës së sigurisë, të përdorimit të narkotikëve, çështja e rënies së borës, rreziku i mundshëm nga zjarret në periudhën e verës etj.




**Fig. 10**. *Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Novobërdë.*

## Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

### Komuna e Prishtinës

Kuvendi i Komunës së Prishtinës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Komuna e Prishtinës ka funksionalizuar sistemin e teleprezencës të cilën e ka vendosur MAPL-ja, ku nga janari i vitit 2012, të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë monitoruar përmes këtij sistemi. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta.
Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun, në to kanë marrë pjesë kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, monitoruesit nga OSBE, si dhe mediet e shumta të cilat përcjellin mbledhjet e Kuvendit.

Përbërja e Kuvendit të Komunës ka pësuar disa ndryshime. Z. Shefki Ukaj anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik të LDK-së ka dhënë dorëheqje nga mandati i tij. Kurse në pajtim me dispozitat e nenit 10.3 pika (a) të Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës ky anëtar është zëvendësuar me kandidatin e radhës nga i njëjti subjekt

politik z. Ismail Kasumi. Po ashtu, është bërë një kalim i anëtares së kuvendit të komunës znj. Afërdita Veli nga radhët e PDK-së në subjektin politik të Vetëvendosjes.
Rendi i ditës për diskutim në mbledhje është përcaktuar në bazë të nenit 5 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe komiteteve. Po ashtu, çështjet e rendit të ditës janë diskutuar në të dy komitetet e obligueshme.

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2012 Komitetet Obligative kanë qenë funksionale. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 12 mbledhje.
Gjithashtu, përbërja në Komitetin për Politikë dhe Financa ka pësuar ndryshime, ku në vend të z. Arsim Janovës është caktuar z. Tefik Mehmeti.
Një nga detyrat dhe përgjegjësit e Kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para Kuvendit. Kryetari i Komunës ka paraqitur raportin për situatën ekonomike - financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kuvendi i komunës së Prishtinës është përcjell edhe me raportimin e Komisionit të Aksionarëve Komunal në Ndërmarrjet Publike, obligim i dal nga Ligji për Ndërmarrjet Publike. Sipas nenit 8.2, Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në baza vjetore mbi performancën e këtyre kompanive, kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë së përcaktuar.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës e ka të miratuar rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.
Lidhur me evidentimin e shkeljeve ligjore, në këtë drejtim Komuna e Prishtinës ka respektuar ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës. Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të miratuara dhe dërgimit të tyre në MAPL, Komuna e Prishtinës është treguar e përgjegjshme në këtë periudhë, pasi që të gjitha aktet e miratuara i ka dërguar brenda afatit ligjor në organin mbikëqyrës.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 56 vendime dhe 2 rregullore, ndërsa sa i përket rregulloreve, është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja për Kushtet dhe Kriteret për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Taksi të Udhëtarëve. Gjithashtu, rregullore tjetër me rëndësi është edhe miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.
Një ndër vendimet më të rëndësishme të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës është:
1. Plotësimi i Vendimit për Emërtimin dhe Zyrtarizimin e Lagjeve, Shesheve dhe Rrugëve të Komunës së Prishtinës.
2.Vendim për ndryshimin e Rregullores për Transparencë. Ky ndryshim është bërë në nenin 5 të kësaj rregullore, ku thuhet se vendimin për mbylljen e Komitetit për Politikë dhe Financa e merr Kryesuesi i Kuvendit.[19]

---

[19] Me qëllim të rritjes së transparencës në mbledhjet e këtij komiteti, MAPL-ja, duke u mbështetur në nenin 82, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L–040, ka rekomanduar Kuvendin e Komunës së Prishtinës që në njërën nga mbledhjet e saj, të miratojë ndryshimin e nenit 5, duke e harmonizuar atë me nenin 45 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 3 të U. A. për transparencë në komuna nr. 2008/9.
Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka marr për bazë rekomandimet e dala nga MAPL, dhe ka ndryshuar dhe plotësuar këtë rregullore me qëllim të rritjes së transparencës në këtë Komitet.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka plotësuar dhe ndryshuar Statutet e Qendrave të Mjekësisë Familjare, pas rekomandimeve të dala nga Komisioni Qeveritar për Mbikëqyrje të ligjshmërisë.

**Komuna e Gjilanit**

Mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës për vitin 2012 është mbajtur në muajin shkurt. Komuna e Gjilanit gjatë periudhës janar - dhjetor 2012 ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje, prej tyre 11 mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës dhe 3 solemne.
Ndërsa, sa i përket Komiteteve Obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së mbledhjeve dhe se me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve.

Gjithashtu, në Kuvendin e Komunës së Gjilanit janë shënuar kalime nga njëri grupacion politik në grupacionin tjetër, ku me këtë rast grupi parlamentar i LDD-së në përbërje prej 4 anëtarëve i janë bashkuar grupit parlamentar të LDK-së.
Sa i përket përcaktimit të rendit të ditës për diskutim në mbledhje, çështjet e shqyrtuara në KPF nga grupet parlamentare janë rekomanduar në Kuvend për diskutim.
Çështjet për rend dite janë shqyrtuar obligativisht në KPF, ndërsa në KK nuk ka qenë e nevojshme.
Po ashtu, përbërja në Komitetin për Politikë dhe Financa ka pësuar ndryshime, ku në vend të z. Arianit Sllamniku është caktuar z. Selim Selimi.

Sa i përket dërgimit të akteve komunale në organin mbikëqyrës, aktet të cilat janë miratuar në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Ndërsa, lidhur me respektimin e transparencës komunale, në këtë drejtim mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Gjilanit kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare dhe lokale, medieve, qytetarëve të interesuar ka qenë e kënaqshme.
Në të gjitha mbledhjet e kuvendit ka pasur kuorum për mbajtjen e tyre. Periudha janar – dhjetor 2012 është karakterizuar me një koherencë në volumin e punës duke rezultuar me miratimin e akteve të ndryshme, qoftë për nga prioritetet po ashtu edhe për nga rëndësia e tyre.

Vlen të theksohet se në marrjen e vendimeve ka pasur kuorum. Në mbledhjet e Kuvendit është zhvilluar një klimë konstruktive në mes të grupeve parlamentare gjatë zhvillimit të diskutimeve. Në këtë periudhe është bërë zëvendësimi i 2 anëtarëve të Kuvendit me 2 anëtar të rinj, për shkak se anëtari i parë i kuvendit ka shkuar jashtë vendit për studime master, ndërsa i dyti është bërë drejtor për zhvillim ekonomik.
Duhet përmendur se kuvendi i komunës së Gjilanit ka miratuar planin vjetor të punës së Kuvendit dhe orarin e takimeve, planin e veprimit për mobilitet, planin e veprimit për ndriçim publik.

Komuna e Gjilanit në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 nuk ka kaluar pa shkelje ligjore. Në këtë periudhë janë evidentuar gjithsejtë 5 shkelje ligjore, ku prej tyre mund të përmendim:

Vendim për plotësimin e rregullores për taksa dhe gjoba komunale.[20]

Po ashtu, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjilanit është evidentuar një shkelje ligjore lidhur me Vendimin për miratimin e Marrëveshjes së PPP për themelimin e Ndërmarrjes së Përbashkët Aksionare "ECO-HIGJIENA" SH.P.K. Gjilan.[21] Një tjetër shkelje ligjore është evidentuar me rastin e marrjes së Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës Shefket Musliji nga Konquli Komuna e Gjilanit, për ndërtim të objektit individual për banim ngastra kadastrale P-704030 13-00635-7, me sipërfaqe prej 370m², i miratuar me datën 06.04.2012 nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.[22] Gjithashtu, është konstatuar edhe një Vendim i kundërligjshëm i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, Vendim për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme komunale në vendin e quajtur "Arat e Muslive"- Zona Kadastrale Gjilan, me qëllim të ndërtimit të rrugës publike sipas zgjedhjes urbanistike të paraparë me Planin Detal Urbanistik "Qarku" Gjilan e miratuar nga Kuvendi i Komunës me datën 06.04.2012.[23]

Kuvendi i Komunës së Gjilanit me datë 28.05.2012 ka nxjerrë vendimin me të cilin kundërshton shitjen e objektit të ish – marketit të Ndërmarrjes "Mlladost", nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit.[24]

---

[20] Ky Vendim *është vlerësuar se është në kundërshtim me nenin 12 të LVL si dhe nenit 7 pika 1 të U.A 2008/09.* Për këtë çështje, MAPL-ja ka dërguar shkresë në drejtim të Komunës me të cilin ka kërkuar shqyrtimin e vendimit në fjalë. Komuna ende nuk ka ndërmarr veprime.

[21] MAPL, ka konstatuar se vendimi për miratimin e Marrëveshjes së PPP për themelimin e Ndërmarrjes së Përbashkët Aksionare "ECO-HIGJIENA" SH.P.K. Gjilan, është në kundërshtim me nenin 11 pika 1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-87 i cili i ka përcaktuar se çdo Ndërmarrje e re Publike mund të themelohet vetëm nëse autorizohet me një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Komuna ende nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

[22] MAPL, ka konstatuar se vendimi është i kundërligjshëm, pasi që dhënia në shfrytëzim e pronës dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës sipas këtij vendimi është në kundërshtim me nenin 5 pika 1, pika 2 dhe pika 3 e Ligjit Nr.03/L-226. Kuvendi i Komunës ka të drejtën t'i jep personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale për shfrytëzim deri në (dhjetë) 10 vite dhe jo më shumë se (dyzet) 40 vite, pas plotësimit të kritereve të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në të gjitha të cekurat më lartë dhe me qëllim të zbatimit të plotë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale neni 7 pika 1 e sqaron se Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e posaçëm në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës të cilët vlerësojnë ofertat dhe i propozon Kuvendit listën e ngushtë prej së paku tre pretendentëve kryesor për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike komunale. Komuna ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura.

[23] MAPL, ka konstatuar se ndërrimi i pronës së paluajtshme publike komunale me pronë të paluajtshme private nuk ka bazë ligjore dhe nuk është paraparë me dispozitat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale Nr.03/L-226 andaj konsiderohet që ky vendim është i kundërligjshëm dhe duhet të rishqyrtohet nga autoritetet lokale. Komuna ende nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.

[24] MAPL, pas shqyrtimit të hollësishëm të vendimit dhe dokumentacionit të cilin e posedon, ***konstaton se***: Komunat kanë të drejtën të posedojnë dhe menaxhojnë me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040; Bazuar në nenin 15 pika 3 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, Agjencioni Kosovar i Privatizimit merr vendim për privatizimin ose likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, vetëm pas konsultimit paraprak me zyrtarët e komunave në të cilat ndodhet ndërmarrja përkatëse; Në këtë rast, Kuvendi i Komunës ka të drejtë të parashtroj padi gjyqësore tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, konform procedurave të përcaktuara në nenin 30 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067; MAPL, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe duke u bazuar në të cekurat më lartë, ka vlerësuar se Kuvendi i Komunës së Gjilanit duhet të veproj konform nenit 30 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit.

Një nga përgjegjësit e kryetarit të Komunës është edhe raportimi i tij para kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Në këtë drejtim, kryetari pritet të raportoj në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës që do të mbahet në muajin janar të vitit 2013.

Në muajin janar të vitit 2012, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte dërguar një kërkesë në Gjykatën për Kundërvajtje në Gjilan, për fillimin e procedurës kundërvajtëse, ndaj Kryetarit të Komunës së Gjilanit, z. Qemajl Mustafa për shkak të, siç thuhet "konfliktit të interesit", ngase kryetari është njëri nga pronarët e kompanisë biznesore private "Frutta Viva". Mirëpo, Kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Qemajl Mustafa ka ndërmarrë hapin për shuarjen e aktivitetit të tij biznesor edhe juridikisht, si aksionar (ligjor) në kompaninë biznesore private "Frutta Viva" sh.p.k. për t'i hequr përfundimisht të gjitha dilemat dhe spekulimet që ishin ngritur rreth tij, për "konflikt të interesit" me funksionin e tij publik si kryetar i Komunës në njërën anë dhe në anën tjetër duke qenë të njëjtën kohë edhe njëri prej pronarëve të këtij biznesi, e që në të vërtetë ishte fiktiv dhe kishte zero qarkullim.

Sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 70 vendime, 4 rregullore dhe 2 rekomandime. Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:
1.Vendim për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të kuvendit dhe komiteteve të KK-së Gjilan për vitin kalendarik 2012. Me këtë Vendim është bërë aprovimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-së Gjilan për vitin kalendarik 2012.
2.Vendim për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të mobilitetit dhe transportit publik në qytetin e Gjilanit. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit e ka miratuar këtë Plan të Veprimit me të cilin parasheh të bëjë përmirësimin e shërbimit të mobilitetit dhe transportit publik në qytetin e Gjilanit.
3. Vendim për miratimin e planit të veprimit për ndriçim publik në Komunën e Gjilanit. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin e Veprimit për ndriçim publik në Komunën e Gjilanit.
4. Janë miratuar 4 vendime për planet rregulluese urbane, si: "Dheu i Bardhë-1", "Qeshmja e Petigovcit", "Gllama", "Dheu i bardhë -2". Të gjitha këto plane rregulluese parashohin ndërtimin e shkollave, çerdheve, administratës, shëndetësisë dhe përmbajtje tjera publike, varësisht prej nevojave dhe kritereve urbanistike dhe zhvillimore.
5.Rregullore për ndarjen e subvencioneve. Me këtë Rregullore, janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës- fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, personave fizik dhe juridik.

**Të gjeturat**

1) Në kuvendin e komunës së Gjilanit për periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 janë evidentuar 5 shkelje ligjore;

2) Në kuvendin e komunës së Gjilanit janë shënuar kalime nga njëri grupacion politik në grupacionin tjetër, ku me këtë rast grupi parlamentar i LDD-së në përbërje prej 4 anëtarëve i janë bashkuar grupit parlamentar të LDK-së;

3) Kryetari i komunës së Gjilanit ende nuk ka raportuar para kuvendit të komunës ashtu siç parashihet me LVL-në, përkatësisht neni 58 pika j;

**Komuna e Prizrenit**

Edhe kuvendi i komunës së Prizrenit ashtu sikurse Komuna paraprake, mbledhjen e parë të saj e ka filluar në muajin shkurt të vitit 2012. Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012, kuvendi i komunës së Prizrenit ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 solemne.

Sa i përket Komiteteve Obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 13 mbledhje, ndërsa Komitetit për Komunitete vetëm 5 mbledhje. Lidhur me procedurat, afatet e njoftimeve dhe dërgimin e materialit, Kuvendi i Komunës e ka përmbushur këtë obligim ligjor ndaj MAPL-së. Mirëpo, ka pasur raste kur materiali për mbledhje nuk ka qenë i kompletuar. Rendi i ditës është përcaktuar nga kryesuesi i Kuvendit në bashkëveprim me kryetarin e Komunës.

Çështjet për rend të ditës janë diskutuar në KPF, ndërsa në KK vetëm atëherë kur është prekur interesi i komuniteteve.

Është bërë zëvendësimi i një anëtarit të kuvendit me një anëtar të ri nga subjekti politik i AAK-së në bazë të vendimit të KQZ-së.

Përbërja e Komiteteve Obligative për këtë periudhë raportuese nuk ka ndryshuar.

Aktet komunale dërgohen me kohë në MAPL, me përjashtim të disa rasteve, kur këto akte komunale janë dërguar të pa nënshkruara nga Kryesuesi i Kuvendit, të pa protokolluara dhe të pa vulosura. Ky fakt ka ndodhur deri në muajin mars, ndërsa nga muaji prill, kuvendi i komunës ka respektuar procedurat administrative. Kurse, sa i përket rendit të ditës, ka pasur rast kur brenda një pikës së rendit të ditës janë miratuar dy vendime, pa qenë ajo pikë pjesë e rendit të ditës dhe pa u futur në rend të ditës për miratim. Po ashtu, është praktikë e mirë në kuvendin e komunës së Prizrenit, ku kryesuesi i Kuvendit para çdo vendimi të marrë ka verifikuar se a ka kuorum.

Grupet parlamentare kanë treguar konstruktivitet, mirëkuptim dhe respektim të fjalës dhe debatit gjatë punimeve në Kuvend, mirëpo shpesh është vërejtur që një pjesë e anëtarëve të kuvendit kanë lëvizur nga salla e mbledhjes duke hyrë dhe dal e që me këtë kanë lënë të kuptohet për mos seriozitet të punës së Kuvendit. Në muajin shtator të vitit 2012, është shënuar një rast i lëshimit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku një pjesë e pozitës dhe opozitës kanë lëshuar mbledhjen e kuvendit duke shprehur qëndrime dhe pakënaqësi lidhur me propozim buxhetin komunal për vitin 2013.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun, në to kanë marrë pjesë OSCE, USAID-DEMI, OJQ, KFOR, ICO, mediet, si dhe qytetarë të interesuar.

Në miratimin e akteve komunale, kuvendi i Komunës së Prizrenit për këtë periudhë raportuese nuk ka kaluar pa shkelje ligjore. Në rastin e parë, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prizrenit me datë 29.02.2012 është miratuar Rregullorja për Transparencën Komunale.[25]

---

[25] MAPL, ka konstatuar se neni 5 pika 3 e Rregullores duhet të harmonizohet me nenin 3 pika 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/09 për Transparencën në Komuna i cili ka përcaktuar se Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit ose Komitetit përkatës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun 7 (shtatë) ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 (tri) ditë para mbledhjes së jashtëzakonshme.

Ndërsa, në rastin tjetër kuvendi i komunës së Prizrenit me datë 29.02.2012 ka miratuar Vendim për dhënien në shfrytëzim të objektit me oborr sipas kërkesës së ECPD, evidentohet si ngastër kadastrale nr.1615/1, si objekt në sipërfaqe prej 380/m², oborr në sipërfaqen prej 157/m², që gjendet në rrugën Adem Jashari, evidentohet sipas fl. Posedimit nr. 2621, ZK Prizreni pronë e Komunës, i miratuar me datën 29.02.2012 nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit.[26]

Kuvendi i Komunës së Prizrenit me datë 27.04.2012 ka nxjerr Vendim mbi shpalljen me interes publik të objektit "ish- Bankosit" për nevojat e Administratës të Komunës së Prizrenit.[27]

Në miratimin e akteve komunale, kuvendi i komunës së Prizrenit është treguar aktiv me gjithsej 61 akte komunale të miratuara, prej tyre 57 vendime dhe 4 rregullore.
Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:
1) Rregullorja për transparencën komunale.
2) Vendimi mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm. Me këtë vendim është aprovuar propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtoria e Administratës-Sektori i Pronës dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shpalljen e interesit të përgjithshëm shoqëroro-publik për realizimin e projektit të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza të qytetit të Prizrenit në fshatin Vlashnje.
3)Vendimi për miratimin e planit rregullues urban përgjatë rrugës Prizren – Landovicë, përkatësisht ana e majtë dhe një pjesë e anës së djathtë të rrugës të qytetit të Prizrenit;
4) Vendimi për miratimin e planit rregullues urban industrisë dhe zonës së lirë të qytetit të Prizrenit;

---

Neni 6 pika 9 e Rregullores duhet të plotësohet, pas miratimit të vendimit nga ana e Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës apo zyrtari i autorizuar, jo më vonë se 30 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ashtu siç e ka përcaktuar neni 6 pika 9 e Udhëzimit Administrativ Nr.2008;/09 për Transparencën në Komuna.
Mirëpo, Kuvendi i Komunës së Prizrenit i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së MAPL-së dhe në mbledhjen e mbajtur me datë 14.06.2012 ka marrë vendim për harmonizimin e Rregullores për transparencë nr.010112570 të datës 29.02.2012 sipas sugjerimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

[26] MAPL, ka konstatuar se vendimi është i kundërligjshëm, pasi që dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale sipas këtij vendimi është në kundërshtim me nenin 5 pika 1, pika 2 dhe pika 3 e Ligjit nr.03/L-226. Kuvendi i Komunës, ka të drejtën t'i jep personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë. Kuvendi i Komunës ka të drejtë të jap në shfrytëzim deri në (dhjetë) 10 vite dhe jo më shumë se (dyzet) 40 vite, pas plotësimit të kritereve të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik dhe pëlqimin paraprak nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ i cili qartë sqaron procedurat për dhënien e pronës publike komunale në shfrytëzim. Komuna e Prizrenit ende nuk ka marrë veprimet e duhura.

[27] MAPL, duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligjit nr. 03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ka konstatuar se: Organet e komunës kanë të drejtën e shpalljes së ndonjë zone, vend në territorin e komunës me interes publik, por jo për pronat dhe objektet të cilat nuk janë të menaxhuar dhe evidentuar në librat kadastral, si prona ose objekte të komunës përkatëse. Objekti i ish-Bankosit është evidentuar si pronë shoqërore, ndërsa administrimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore është e drejtë ekskluzive e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP-së), duke u bazuar në nenin 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Komuna për nevoja publike, në veçanti për objekte të cilat komuna ka nevojë për ushtrimin e kompetencave komunale, ka të drejtën që t'i drejtohet me një kërkesë AKP-së, që pronën ose objektin që ndodhet në territorin e komunës dhe me të cilën menaxhon AKP-ja, të marrë në shfrytëzim ose ta këmbejë me pronën komunale. MAPL, duke u bazuar në të cekurat më lartë ka arritur në përfundim se, vendimi i kuvendit të komunës është i kundërligjshëm dhe kërkon nga i njëjti organ që ta rishqyrtoj aktin në fjalë, si dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet konkrete në mënyrë që vendimi të jetë në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura.

5) Vendimi për miratimin e planit rregullues urban lakuriqi verior të qytetit të Prizrenit;
6)Vendimi për miratimin e planit rregullues urban kuadrantet E.5.6, E.5.9 dhe një pjesë e kuadratit F.5.2 të qytetit të Prizrenit;
7) Rregullore për përdorimin e gjuhëve. Kjo Rregullore ka për qëllim të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në punën e administratës komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore që themelohen apo qeverisen nga Komuna dhe në ndërmarrjet publike lokale të themeluara nga Komuna.

**Të gjeturat**

1) Në kuvendin e komunës së Prizrenit janë evidentuar 3 raste të shkeljeve ligjore;

2) Në Komunën e Prizrenit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim nuk njihet me Statutin e Komunës;

3) Në kuvendin e komunës së Prizrenit është evidentuar një rast kur brenda një pikës së rendit të ditës janë miratuar dy vendime, pa qenë ajo pikë pjesë e rendit të ditës dhe pa u futur në rend të ditës për miratim;
4) Kryetari i komunës së Prizrenit ende nuk ka raportuar para kuvendit të komunës ashtu siç parashihet me LVL-në, përkatësisht neni 58 pika j;

**Komuna e Pejës**
Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012, kuvendi i komunës së Pejës ka funksionuar normalisht. Komuna ftesën për mbledhje e ka dërguar konform dispozitave të LVL-së, mirëpo nuk duhet përjashtuar edhe vonesat e paraqitura në dërgimin e materialit të mbledhjes së Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe, kuvendi i komunës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 solemne në të cilat mbledhje janë miratuar gjithsej 43 vendime, 1 rregullore dhe 2 amendamente. Po ashtu, Komitetet Obligative kanë qenë funksionale në këtë gjashtëmujor, ku Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 11 mbledhje.

Sa i përket monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit, ky monitorim është bërë përmes sistemit të teleprezencës. Në tremujorin e fundit të vitit 2012 janë shfaqur probleme në sistemin e teleprezencës, ku pamjet vizuale kanë qenë të kënaqshme, ndërsa transmetimi i zërit ka qenë me ndërprerje dhe jo i mirë.
Mbledhjet e kuvendit kanë qenë transparente për publikun. Koha e mbajtjes së mbledhjeve është publikuar në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen e komunës dhe në mediet lokale. Roli i opozitës ka qenë shumë konstruktiv.
Rendi i ditës është përcaktuar konform LVL-së, ndërkaq çështjet për rend të ditës janë shqyrtuar në të dy Komitetet e Obligueshme. Po ashtu, përbërja e Komiteteve Obligative nuk ka ndryshuar.
Se a ka pasur zëvendësime të anëtarëve të kuvendit ose kalime nga njëri grupacion politik në grupacionin tjetër, në kuvendin e komunës së Pejës është bërë një zëvendësim i anëtarit të kuvendit nga radhët e po të njëjtit subjekt politik atë të AAK-së. Gjithashtu, ka pasur edhe kalime të anëtarëve të kuvendit nga njëri grupim politik në grupin tjetër, ku 2 anëtarë të kuvendit

nga radhët e LDD-së dhe 1 anëtarë i kuvendit nga radhët e PSD-së kanë kaluar në AAK, ndërsa 2 anëtarë të kuvendit nga radhët e ish – partisë ORA kanë kaluar në LDK.

Sa i përket rasteve të shkeljeve ligjore, në kuvendin e komunës së Pejës janë evidentuar 2 raste të shkeljeve ligjore.
Në muajin prill, kuvendi i komunës së Pejës ka marrë Vendim për ndarjen e truallit z. Ramë Dervish Ukaj, nga Peja, invalid i luftës së UÇK-së, për ndërtimin e shtëpisë si rast i rëndë social.[28]
Shkelja e dytë ligjore e miratuar nga kuvendi i komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2012 ka të bëjë me Vendimin për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktvendimit të aprovuar nga ish organet e kuvendit të komunës së Pejës e miratuar me datë.[29]

Në këtë periudhën janar – dhjetor të vitit 2012, në komunën e Pejës është miratuar Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2011, për këtë raport ka raportuar Kryetari i komunës z. Ali Berisha.
Kryetari i komunës së Pejës, në këtë periudhë ka emëruar për nënkryetar të komunës për komunitete z. Safet Zoraniq nga radhët e komunitetit boshnjak, kjo pas vdekjes kohë më parë të nënkryetarit të komunës z. Ibish Bajrami.

Kur jemi te çështja e nënkryetarëve, vlen të potencohet se kryetari i komunës së Pejës, ka emëruar për nënkryetarë të parë z. Ali Lajçi në vend të nënkryetarit të deri tanishëm z. Shefqet Uka, i cili kishte hequr dorë nga pozita e nënkryetarit të parë të Komunës.
Në këtë periudhë të raportimit është shkarkuar nga posti i drejtoreshës së zhvillimit ekonomik, znj. Suzana Radoniqi dhe në vend të saj kryetari i komunës ka emëruar z. Sokol Ukajn.
Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë kësaj periudhe ka miratuar tri Plane Rregulluese Urbane: 1) Plani Rregullues Urban për: B.T.”Kapeshnica-Puhovci”, 2)Plani Rregullues Urban për: B.T.”Puhovci-Jarina”, 3) Plani Rregullues Urban për:B.T.Jarina-Xhemajl Kada”.

---

[28] MAPL, ka konstatuar se ky vendim është në kundërshtim me nenin 5, pika 3 e Ligjit Nr.03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 3 pika 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili ka potencuar se kuvendi i komunës ka të drejtë të japë në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale në afat prej dhjetë(10) vite por jo më shumë se dyzet(40) vite, në përputhje me kriteret e përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik.
Prandaj, MAPL, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, ka kërkuar nga organet e Komunës, përkatësisht nga kryetari dhe kuvendi i komunës së Pejës, që të rishqyrtojnë vendimin në fjalë, për faktin se dhënia e pronës komunalë në shfrytëzim duhet të bëhet konform Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit në fjalë.
Në lidhje me këtë çështje, Komuna ende nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura.

[29] MAPL, duke u bazuar në afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative konstaton se: kuvendi i komunës nuk është organ kompetent për shpallje të pavlefshme të aktvendimeve ose akteve tjera individuale, me të cilën një subjekt qoftë person fizik ose juridik, i njihet një e drejtë nga ish legjislacioni i cili ka qenë i aplikuar dhe jo diskriminues. Si person juridik komuna ka kompetencë që të padisë dhe të paditet në gjykatën kompetente, për veprimet ose mos veprimet e ndërmarra në territorin e komunës përkatëse. Në rast kontesti lidhur me një akt administrativ ose shpalljen të pavlefshëm dhe pa efekt juridik, lënda duhet adresuar në gjykatën kompetente. MAPL-ja duke u bazuar në të cekurat më lartë vije në përfundim se, kuvendi i komunës së Pejës nuk është kompetent për të trajtuar një çështje të tillë, për faktin se zgjidhjen e kontesteve administrative e bënë gjykata kompetente duke u bazuar në legjislacionin e aplikuar në fuqi.

Prej gjithsej 43 vendimeve të miratuara nga ky Kuvend vlen të përmenden këto vendime:
1) Vendim për ndarjen e truallit në sipërfaqe prej 01.00,00 ha, nga nast.kad.nr.105/1 dhe 105/2 pronë e Komunës së Pejës, Z.K Zagërme, për varreza të fshatit Raushiq KK.Pejë.
2) Vendim për ndërrim të pozicionit të rrugës sipas fletëposedimit nr.171-0 pronë komunale me ngast.kad.nr.104/1 dhe 104/2 pronë privatë në sipërfaqe relativisht të njëjtë.
3) Vendim për shpalljen në shqyrtim publik të projekt-Planit Rregullues Urban të B.T "Xhemajl Kada-7 Shtatori".
4) Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm shpronësimi i hapësirës në gjerësi prej 1,5 m. të ngastrave kadastrale të skicuara dhe paraqitura në tabelë për realizimin e projektit të Rregullimit të shtegut unazor rekreativ për ecje dhe çiklizëm të financuar 90%nga Komisioni Evropian.
5) Vendim për hedhjen në diskutimi publik të Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Pejës.
6) Amendamenti për ndryshime në Statutin Komunal Pejë, të emërimit të zyrës për Komunitete dhe harmonizimit të emërimit me Rregulloren Nr.02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim të Qeverisë së republikës së Kosovës, pas procedurës së diskutimit publik.
7) Amendamenti për ndryshime dhe plotësim në Statutin e Komunës-Amandamente në ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Pejës I.Numër:020-1163 datë: 15 shkurt 2010 për ndryshim të emërtimit të "Drejtorisë për Sigurimin e Investimeve të Jashtme" në titullimin e kësaj Drejtorie:"Drejtoria për Integrime dhe Diasporë".

**Të gjeturat**

1) Në kuvendin e komunës së Pejës janë evidentuar 2 raste të shkeljeve ligjore;

**Komuna e Kamenicës**

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2012, kuvendi i komunës së Kamenicës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Kurse, sa i përket Komiteteve Obligative, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 12 mbledhje.
Në çështjet procedurale, afatet e njoftimeve, dërgimin e ftesës dhe materialit të mbledhjes së Kuvendit, kuvendi i komunës së Kamenicës ka përmbushur këtë obligim ligjor në raport me MAPL-në.

Po ashtu, kuvendi i komunës së Kamenicës ka dërguar me kohë aktet komunale në adresë të MAPL-së. Përcaktimi i rendit të ditës është bërë nga kryetari i komunës dhe kryesuesi i kuvendit duke u mbështetur në planin e punës për vitin 2012. Çështjet për rend dite janë shqyrtuar në të dy Komitetet Obligative. Ndërsa, sa i përket asaj se a ka ndryshuar përbërja e Komiteteve Obligative, në KPF, grupi parlamentar i LDK-së ka zëvendësuar anëtarin e vet duke propozuar z. Rexhep Morinën për anëtarë të ri të KPF-së. Po ashtu, vlen të theksohet se në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012, në kuvendin e komunës së Kamenicës janë bërë 5 kalime të anëtarëve të kuvendit nga radhët e njërës grupacion politik në grupacionin tjetër.

Sa i përket rendit të ditës, mbledhjet e Kuvendit kanë filluar me kohë dhe i janë përmbajtur këtij rendi, mirëpo duhet përmendur se në mbledhjen e tretë të Kuvendit, anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së kërkuan që informata e ofruar mbi ndarjen e bursave për studentë, të jetë më e kompletuar edhe me të dhëna të tjera. Ata kërkuan që informata të sillet brenda mbledhjes së kuvendit, mirëpo drejtoresha e arsimit është përgjigjur se një gjë e tillë nuk mund të kompletohet brenda ditës. Për shkak të mos përmbushjes së kërkesës nga ana e drejtoreshës, në shenjë pakënaqësie dhe revolte, anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së e kanë braktisur mbledhjen e Kuvendit.
Lidhur me transparencën komunale, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun dhe në to kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, USAID-DEMI, OJQ, mediet dhe qytetarë të interesuar.

Sa i përket evidentimit të shkeljeve ligjore, në adresë të Komunës së Kamenicës, MAPL ka dërguar një shkresë ligjore lidhur me miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale.[30]
Rast tjetër i evidentuar në fushën e shkeljeve ligjore është paraqitur në mbledhjen e datës 27.06.2012, ku kuvendi i komunës së Kamenicës ka marrë Vendim për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të Komunës me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë.[31]
Nga aspekti kuantitativ i miratimit të akteve komunale, kuvendi i komunës së Kamenicës ka miratuar gjithsej 66 akte komunale, prej tyre 59 vendime, 4 rregullore dhe 3 pëlqime.
Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:
1) Rregullore për organizimin e brendshëm të administratës komunale në Komunën e Kamenicës. Kjo Rregullore përcakton organizimin e brendshëm të administratës komunale të Komunës së Kamenicës.
2) Vendim për miratimin e raportit të buxhetit për vitin 2011. Me këtë vendim është miratuar raporti i buxhetit për vitin 2011.
3) Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban. Kuvendi i komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 31.12.2012 ka miratuar këto plane. Këto plane janë mjaft të rëndësishme ngase mundësojnë një organizim më të mirë të planifikimit hapësinor në Komunën e Kamenicës.

[30] MAPL ka kërkuar që aneksi 2, neni 7.2 pika 5 duhet të harmonizohet me Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, për faktin se Rregullorja në fjalë ka përcaktuar organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim. Komuna ka ndërmarrë veprimet e duhura konform shkresës ligjore të dërguar nga MAPL.
[31] MAPL, ka konstatuar se kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga ana e komunave për kryerjen e obligimeve të tyre ndaj Ndërmarrjeve Publike Komunale nuk ka bazë ligjore dhe si të tilla nuk mund të aplikohen. Bazuar në nenin 128 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj dhe se askush nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionare në këtë shoqëri. Kufizimi i shërbimeve nga komuna, për qytetarët, bizneset dhe operatorët ekonomik që funksionojnë brenda territorit të saj, me pagesën e faturave të mbeturinave për Ndërmarrjen Publike Komunale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.11.2012 ka shfuqizuar vendimin në fjalë, kështu duke respektuar ligjet në fuqi.

**Të gjeturat**

1) Është evidentuar një rast i braktisjes së mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Kamenicës nga grupi parlamentar i PDKsë. Mbledhja është braktisur për shkak të mos përmbushjes së kërkesës së tyre lidhur me plotësimin informatës së ofruar nga drejtoresha e arsimit në çështjen e ndarjes së bursave për student;

2) Kuvendi i komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.11.2012 ka shfuqizuar Vendim për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të Komunës me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë, kështu duke respektuar ligjet në fuqi.

3) Në kuvendin e komunës së Kamenicës janë bërë 5 kalime të anëtarëve të kuvendit nga radhët e njërës grupacion politik në grupacionin tjetër;

4) Në komunën e Kamenicës, KKSB për periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 nuk ka mbajtur asnjë mbledhje;

**Komuna e Novobërdës**

Kuvendi i komunës së Novobërdës gjatë periudhës raportuese ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Ndërsa, lidhur me funksionimin dhe numrin e mbajtjes së mbledhjeve të Komiteteve Obligative, KPF ka mbajtur 12 mbledhje, kurse KK ka mbajtur 8 mbledhje.

Duhet përmendur se kuvendi i komunës së Novobërdës është treguar i vëmendshëm në respektimin e procedurave, afatin e njoftimeve, dërgimin me kohë të ftesës dhe materialit të mbledhjes së Kuvendit, si dhe në dërgimin e akteve komunale në drejtim të MAPL-së.
Rendi i ditës është përcaktuar në bazë të Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, mirëpo ka pasur edhe pika shtesë që janë plotësuar me propozime të Drejtorive Komunale.
Çështjet për rend të ditë janë shqyrtuar në të dy Komitetet Obligative. Përbërja e Komiteteve Obligative për këtë periudhë raportuese nuk ka ndryshuar.
Mbledhjet e kuvendit fillojnë me kohë dhe kryesisht i përmbahen rendit të ditës. Gjatë monitorimit të mbledhjeve është vërejtur se në fillim të mbledhjes nuk bëhet konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit, edhe pse në të gjitha mbledhjet e kuvendit ka kuorum për marrjen e vendimeve. Mirëpo, pas rekomandimeve të dhëna nga MAPL-ja, kuvendi i komunës nga muaji prill ka filluar të bëjë konstatimin e prezencës së anëtarëve të kuvendit.
Lidhur me zëvendësimet apo kalimet e anëtarëve të kuvendit të komunës nga njëri grupacion politik në grupacionin tjetër, deri në këtë fazë raportuese nuk është shfaqur ndonjë rast.

Vlen të theksohet se kuvendi i komunës së Novobërdës ka miratuar planin vjetor të punës së Kuvendit. Po ashtu, ka marrë vendim që të kaloi në diskutim publik planet zhvillimore komunale, si dhe në mbledhjen e muajit qershor ka ndryshuar dhe plotësuar Statutin e Komunës. Në mbledhjet e kuvendit në periudhën e tre mujorit të dytë vërehet se praktika e zgjatjes së fjalimeve dhe e mos respektimit të minutazhit kohor është përmirësuar. Në përgjithësi, grupet parlamentare zhvillojnë debat të hapur në të gjitha çështjet që diskutohen në Kuvend.

Sa i përket transparencës komunale, mbledhjet e kuvendit janë të hapura për publikun dhe në të marrin pjesë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, por edhe të atyre vendore, mediet, si dhe qytetarë të interesuar.

Një nga përgjegjësit e kryetarit të komunës është edhe raportimi i tij para kuvendit të komunës së paku një herë në gjashtë muaj ose kurdo herë që kërkohet. Në këtë drejtim, kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit në komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2012, ndërsa për gjashtë mujorin e dytë do të raporton në mbledhjen e muajit janar të vitit 2013.
Kuvendi i komunës së Novobërdës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2012, ka shfuqizuar Vendimin nr.01/02/683 të datës 02.09.2011 për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina pas rekomandimeve të marra nga MAPL.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012, kuvendi i komunës së Novobërdës ka miratuar akte të ndryshme komunale. Më tej, në bazë të dhënave që posedojmë del se janë miratuar gjithsej 75 akte komunale, prej tyre 68 vendime dhe 7 rregullore.
Aktet më të rëndësishme komunale të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:
1)Vendim mbi miratimin e raportit financiar vjetor për vitin 2011-të. Me këtë vendim është miratuar raporti financiar vjetor për vitin 2011-të;
2) Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat,vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Novobërdës.
Kjo Rregullore, ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
3) Vendim për lirimin nga tarifat, ngarkesat komunale për bizneset individuale.
Me këtë vendim, bizneset prodhuese lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga 1 janari i vitit 2012, bizneset prodhuese dhe joprodhuese të cilat regjistrohen nga 1 janari i vitit 2012 lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 3 vjeçare, ndërsa bizneset joformale të cilat regjistrohen deri në fund të muajit qershor të vitit 2012 lirohen nga taksat dhe ngarkesat komunale për një periudhë 2 vjeçare.
4) Vendim për miratimin e Planeve Zhvillimore Komunale;
Me këtë vendim, kuvendi i komunës së Novobërdës ka miratuar planet zhvillimore komunale.
5)Kuvendi i Komunës së Novobërdës, gjatë kësaj periudhe ka marrë vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Po ashtu, vendim tjetër me rëndësi është miratimi i Strategjisë së zhvillimit kulturor të Komunës së Novobërdës 2012-2016, vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit (nenet 69,70,71,72,73,74,75,76,77,78) etj.

**Të gjeturat**

1) Kuvendi i komunës së Novobërdës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2012, ka shfuqizuar Vendimin nr.01/02/683 të datës 02.09.2011 për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina pas rekomandimeve të marra nga MAPL.

2) Kuvendi i komunës së Novobërdës ka miratuar Planet Zhvillimore Komunale, si dhe ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës (nenet 69,70,71,72,73,74,75,76,77,78);

3) Kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit të komunës ashtu siç parashihet me LVL-në, përkatësisht nenin 58 pika j;

**KOMUNAT: FERIZAJ, KAÇANIK, SHTIME, FUSHË KOSOVË, MALISHEVË, DHE MAMUSHË**

Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2012, Kuvendet Komunave Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Malishevë, Fushë Kosovë dhe Mamushë, kanë përmbushur obligimin ligjor sa i përket numrit të mbledhjeve të kuvendeve dhe me kohë kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimit.
Kuvendet e këtyre komunave gjithsej kanë mbajtur 70 mbledhje nga to 69 të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, konkretisht Kuvendi i Komunës së Shtimes, Malishevës, dhe Fushe Kosovës kanë mbajtur nga 12 mbledhje, ndërsa Kuvendi i Komunës Ferizajt, Kaçanikut dhe Mamushës nga 11 mbledhje të rregullta.




| | Ferizaj | Shtime | Kaçanik | Malishevë | Fushë-Kosovë | Mamushë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 11 | 12 | 11 | 12 | 12 | 11 |
| Mb.e jashtëzakonshme | | 1 | | | | |

**Fig.11.** *Numri i mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të mbajtura në vitin 2012, në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malisheve, dhe Mamushë*

Nga figura e mësipërme del të jetë se në Kuvendet e këtyre komunave gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej 70 mbledhje.

Komitetet obligative në këto komuna gjatë vitit 2012 kanë funksionuar normalisht, me përjashtim të komunës të Komitetit për Komunitete të Komunës së Kaçanikut. Komitetet për Politikë dhe Financa në këto komuna në tërësi kanë mbajtur 66 mbledhje.
Në vijim, kemi paraqitur figurën me mbledhjet e komiteteve të obligueshme:




**Fig.12.** *Numri i mbledhjeve të KPF dhe KK të mbajtura në vitin 2012, në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malisheve, dhe Mamushë*

Në këtë periudhë, komunat i kanë dërguar me kohë ftesat dhe materialet për mbledhje. Po ashtu, nuk është shfaqur ndonjë problem në komunikim dhe në pranimin e materialeve.
Mirëpo, në Komunën e Mamushës është shfaqur problemi i përkthimit në gjuhët zyrtare. Deri në muajin maj, çështja e përkthimit të mbledhjeve në gjuhën shqipe ka qenë pengesë e vazhdueshme, pasi që mbledhjet janë zhvilluar vetëm në gjuhën turke, ndërsa nga muaji maj edhe pse komuna ka punësuar një përkthyese, ende ka probleme gjatë përkthimit të seancave të kuvendit.
Gjatë vitit 2012, këto komuna kanë miratuar akte të ndryshme nga fushat e kompetencave komunale.




**Fig.13.** *Numri i Vendimeve dhe Rregulloreve gjatë vitit 2012, në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malisheve, dhe Mamushë*

Në përgjithësi, Kuvendet e Komunave Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malishevë dhe Mamushë kanë miratuar 253 vendime dhe 17 rregullore. Më konkretisht, Kuvendi i Komunës së

Ferizajt ka miratuar 40 vendime dhe 5 rregullore, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar 89 vendime dhe 3 rregullore, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut 35 vendime dhe 4 rregullore, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës 46 vendime dhe 2 rregullore, Kuvendi i Komunës së Malishevës 28 vendime dhe 5 rregullore, ndërsa Kuvendi i Komunës së Mamushës ka miratuar 15 vendime dhe 3 rregullore.

Sa i përket publikimit të akteve komunale në ueb faqe të Komunës, Komuna e Ferizajt, Shtimes dhe Kaçanikut i kanë publikuar të gjitha vendimet dhe rregulloret, e gjithashtu janë publikuar ftesat për mbajtjen e mbledhjeve. Ndërsa, Komuna e Mamushës, Fushë Kosovës dhe Malishevës nuk e kanë bërë këtë.

Lidhur me nivelin e respektimit të dispozitave të LVL-së për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, këto komuna aktet e miratuara në kuvend i kanë dërguar për shqyrtim në MAPL, me përjashtim të Komunës së Mamushës dhe Malishevës, të cilat kanë pasur ngecje në këtë proces.
Me qëllim të krijimit të kushteve dhe të sjelljes së qytetarëve sa më afër procesit të vendimmarrjes, komunat gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur takime publike me qytetarë. Takimet publike me qytetarë janë realizuar si vijon: Komuna e Ferizajt, Shtimes, Kaçanikut, Malishevës kanë mbajtur nga 2 tubime publike me qytetarë. Kurse sa i përket Komunës së Fushë Kosovës dhe Mamushës, nuk kanë mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë.

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Është i njohur fakti se në komuna janë funksionale trupat këshillëdhënëse për siguri, të njohur si Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Me qëllim që KKSB-të të jenë sa më funksionale në komuna, Ministria e Punëve të brendshme në bashkëpunim me MAPL-në kanë ndryshuar dhe plotësuar Udhëzimin administrativ për KKSB pra kanë nxjerrë udhëzimin e ri për KKSB numër 27/2012, me te cilin përcaktohet mënyra e themelimit të KKSB-ve ne komuna pra përgjegjësia për themelimin e këtij këshilli i është lënë kuvendit të komunës e konform këtij udhëzimi kuvendet e komunave Ferizaj, Fushë Kosove, Shtime, Kaçanik kanë themeluar KKSB-në sipas UA/27/2012.
Në vijim, kemi paraqitur figurën me numrin e mbledhjeve të KKSB-ve në komuna:




**Fig.14.** *Numri i mbledhjeve të KKSB-ve të mbajtura në vitin 2012, në komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Fushë Kosovë, Malisheve, dhe Mamushë*

Nga të dhënat e mësipërme shihet se, KKSB, me përjashtim të Komunës së Mamushës dhe Fushë Kosovës që kanë mbajtur vetëm nga një mbledhje, në komunat tjera KKSB-të kanë qenë më aktive në mbajtjen e takimeve. Për më tepër, KKSB në Komunën e Ferizajt ka mbajtur 4 mbledhje, në Malishevë 7 mbledhje dhe Kaçanik 10 mbledhje.

## Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

### Ferizaj

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Ferizajt mbajtur 11 mbledhje. Edhe pse gjatë vitit 2012 në Komunën e Ferizajt janë zhvilluar zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar komune, Kuvendi ka qenë efektiv në mbajtjen e mbledhjeve si dhe trupave të tij. Krahasuar me vitin 2011, Komuna e Ferizajt ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të Kuvendit, gjithsejtë me 11 mbledhje të mbajtura. Gjithashtu, KPF ka mbajtur 9 mbledhje, derisa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka miratuar 40 vendime dhe 5 rregullore, që do të thotë se krahasuar me vitin paraprak të 2011 kuvendi ka qenë më aktiv në këtë drejtim.
Komuna e Ferizajt rëndësi të veçantë i ka kushtuar planeve rregulluese, ku ka miratuar 3 vendime për hartimin e planeve rregulluese. Pastaj është miratuar edhe vendimi për krijimin e zonave ekonomike në territorin e Komunës se Ferizajt, ku në këtë zonë parashihet zhvillimi i biznesit si dhe punësimi i njerëzve si një e mirë për zhvillimin e gjithëmbarshëm të komunës. Gjithashtu, Kuvendi ka marrë vendim për fillimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Ferizajt.

Kuvendi i komunës, ka miratuar edhe Rregulloren për bashkëpunimin me fshatra dhe lagjet urbane, e cila ka kaluar diskutimin publik me qytetarë, ndërsa Rregullorja për ndarjen e banesave të solidaritetit është arritur të hiqet nga rendi i ditës pas konsultimit paraprak me MAPL-në[32].

Gjatë vitit 2012 kryetari i Komunës së Ferizajt ka paraqitur dorëheqjen nga pozita e kryetarit, për shkak të vërtetimit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nga Gjykata Supreme, me të cilin është shpallur fajtor për veprën penale shkaktim i rrezikut në komunikacion dhe është dënuar me dy vjet e gjysmë heqje lirie. Mandati i Kryetarit të Komunës së Ferizajt ka përfunduar sipas dispozitave të nenit 56.3 pika c të LVL, nr. 03/L-040.
Duke u bazuar në dispozitat e nenit 60, paragrafi 60.3 të LVL-së dhe në dispozitat e nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2010 të MAPL-së për procedurën e përfundimit të mandatit të Kryetarit të Komunës, pozitën e Kryetarit të Komunës deri në zgjedhjen e Kryetarit të Komunës e ka ushtruar nënkryetari i Komunës z. Besim Zymberi[33].

**Komuna e Shtimes**
Gjatë vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme, si dhe ka miratuar 98 vendime dhe 3 rregullore. Krahasuar me vitin 2011, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve edhe gjatë vitit 2012., ndërsa, sa i përket miratimit te akteve në vitin 2012 ka qenë më aktiv.

Kryetari i Komunës në shumicën e mbledhjeve ka qenë prezent në mbledhje, gjë e cila në të shumtën e rasteve nuk ka ndodhur me drejtorët komunal.
Kuvendi ka shqyrtuar një varg kërkesash të qytetarëve të cilat në të shumtën e rasteve janë refuzuar për shkak të mundësive të limituara buxhetore. Kuvendi ka miratuar raportin financiar të qeverisë komunale për vitin 2011, Vendimin për riemërimin e çerdhes së fëmijëve, rregulloren për ndarjen e bursave për studentë, planin e punës së kuvendit për vitin 2012, si dhe rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

Kuvendi i Komunës gjithashtu në këtë periudhë ka miratuar kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2013-2015 e cila ka kaluar në debat publik me qytetarë, duke i marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve të cilat më pas janë inkorporuar në këtë kornizë si dhe ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.
Ndër çështjet e tjera të shqyrtuara në këtë periudhë, vlenë për tu përmendur shqyrtimi i kërkersës së Kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastërtia" - njësia në Shtime, si dhe kërkesës së kompanisë rajonale të ujërave "Prishtina"- njësia në Shtime, të cilat kanë pasur të bëjnë me

[32] Komisioni i përbërë nga MAPL dhe MMPH ka shqyrtuar këtë draft rregullore dhe ka konstatuar se kjo duhet të harmonizohet me ligjet e Republikës së Kosovës që janë në fuqi. Pas rekomandimeve nga komisioni përkatës për harmonizimin e kësaj rregullore me ligjet ne fuqi, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2012, ka harmonizuar rregulloren dhe ka miratuar në përputhje me udhëzimet e komisionit.
[33] Vlen të theksohet se zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Ferizajt janë shpallur nga Presidentja e Kosovës me datën 29 prill 2012. Gjatë kësaj periudhe në Komunën e Ferizajt janë zhvilluar zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës ku janë zhvilluar dy raunde të zgjedhjeve dhe në raundin e dytë është zgjedhur Kryetar i Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu, i cili ka dhënë betimin para anëtarëve të Kuvendit. Pasi që z. Aliu ishte Kryesues i Kuvendit deri në kandidimin e tij për Kryetar të Komunës pozita e Kryesuesit të Kuvendit të komunës ishte zbrazët dhe kuvendi në mbledhjen e mbajtur me 3 gusht 2012, ka zgjedhur Kryesues z. Xhavit Zariqi.

propozimin për aplikimin e masave të kushtëzimit të qytetarëve me pagesën e shërbimeve të cilat ofrojnë këto kompani. Këto kërkesa janë refuzuar me arsyetimin e bazuar në shkresën ligjore të MAPL-së, e me të cilën është konstatuar se kushtëzimi i qytetarëve në kryerjen e obligimeve ndaj kompanive për kryerjen e shërbimeve komunale nuk ka bazë ligjore.
Kuvendi ka miratuar edhe riorganizimin e drejtorive komunale me ç'rast ka paraparë gjashtë drejtori. Gjatë kësaj periudhe kuvendi ka miratuar planin buxhetor 2013-2015 duke respektuar qarkoret buxhetore të nxjerrë nga Ministria e Financave, si dhe ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013.

**Të gjeturat**

Kuvendi i komunës se Shtimes gjate kësaj periudhe ka miratuar edhe vendimet e mëposhtme:

1. Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën 01 Nr.07/1646-2 për z.Muhamed Himary-Firma Dragon Qelik – Prishtinë;
2. Vendim për dhënien ne shfrytëzim 26.47 ari sipërfaqe z, Muhamed Himary-Firma Dragon Qelik –Prishtinë, për vendosjen e pajisjeve për gurëthyes,;
3. Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën 01.Nr.07/1572 të Hajri Xhelilit, Firma NPSH "Shpejtimi" –Shtime;
4. Vendim për ndarjen e një trualli për familjen e dëshmorit Ali Tafa nga fshati Carralevë;
5. Vendim për ndarjen e 10 trojeve për invalidët e luftës së UQK-së, dega Shtime;
6. Vendim për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes prej 50 ari truall për Policin e Kosovës, njësisë në Shtime për ndërtimin e stacionit të Policisë,

Pas shqyrtimit te ligjshmërie së këtyre vendimeve nga MAPL, janë konsideruar se nuk janë harmoni me ligjet e Republikës së Kosovës dhe për këtë është dërguar shkresë me të cilën është kërkuar që këto vendime të rishqyrtohen në kuvendin e komunës dhe të harmonizohen me legjislacionin në fuqi. Duke u bazuar në këtë shkresë, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2012 ka shqyrtuar shkresën e MAPL-së, mirëpo ka shfuqizuar vetëm një vendim, për më saktë Vendimin nr. 01.Nr.06/1695-196 për dhënien në shfrytëzim të 26.47 ari sipërfaqe z.Muhamed Himay nga Prishtina.

Ndërsa vendimet e tjera edhe pas rishqyrtimit në kuvend nuk i ka ndryshuar me arsyetimet e mëposhtme:

a) Pëlqimet e lëshuara nga Kuvendi Komunal, sipas kërkesave 01Nr.07/1646-2, për z.Muhamed Himay nga Prishtina, si dhe pëlqimi në kërkesën 01Nr.07/1572, të Hajri Xhelilit nga Shtimja, mbesin në fuqi, me arsyetimin se Kuvendi Komunal-Shtime ka dhënë vetëm Pëlqim për palët me qëllim të kompletimit të dokumentacionit për Licencë, ndërkaq Lejen e punës për palët e lëshon Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, (KPMM-ja).

b) Vendimet e Kuvendit Komunal 01Nr.06/1695-191 për ndarjen e një Trualli për familjen e Dëshmorit Ali Tafa, si dhe vendimi tjetër 01Nr.06/1695-190, për ndarjen e dhjetë trojeve për Invalidët e Luftës së UÇK-së Dega në Shtime, mbeten në Fuqi, me arsyetimin se këto vendime janë të bazuara në Vendimin e mëparshëm të Kuvendit Komunal – Shtime 01Nr.06/3867-4 të datës: 25.11.2005 i cili e ka caktuar hapësirën e përgjithshme për ndarjen e trojeve për Dëshmorët, Invalidët të Luftës, si dhe për Martirët e Masakrës së Reçakut në ngastrat kadastrale me numër: 2116 dhe 2117, F.P-941, pastaj ngastra kadastrale: 2147, F.P-942, si dhe ngastra kadastrale 2148/1, F.P-940, të gjitha në Zonën Kadastrale – Shtime. (Prandaj këto troje të ndara janë brenda sipërfaqes së përcaktuar me këto dy vendime)

c) Vendimi i Kuvendit Komunal, 01Nr.06/1695-189 për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes prej 50 ari truall Policisë së Kosovës njësia në Shtime, mbetet në fuqi, me arsyetimin se ky vendim është marrë për Institucionin Shtetëror dhe është njëburimor.

**Komuna e Kaçanikut**

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje inauguruese. Kuvendi ka miratuar 35 vendime dhe 4 rregullore. Krahasuar me vitin 2011, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut edhe gjatë vitit 2012 ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve sikurse ne vitin 2011. KPF është treguar më pak aktive gjatë kësaj periudhe ku ka mbajtur 9 mbledhje, që krahasuar me vitin 2011 është një mbledhje me pak. Ndërsa Komiteti për Komunitete edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka funksionuar dhe kjo çështje mbetet sfidë e komunës për të funksionalizuar këtë komitet.

Kuvendi i komunës ka miratuar një varg vendimesh si dhe rregullore që janë te rëndësishme për qytetarët dhe komunën e Kaçanikut siç janë: Vendimi për hartimin e planeve rregulluese në zonat turistike në Komunën e Kaçanikut, Vendimi për lirimin e bizneseve nga taksat komunale-ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, Vendimi për miratimin e planit rregullues (Zona turistike Malet e Sharrit), Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Kaçanikut.

Poashtu, Kuvendi ka miratuar edhe Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut, Rregullorja për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, si dhe Rregulloren për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2013. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka miratuar edhe Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, si dhe raportin e punës së qeverisë komunale për vitin 2011.

Në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2012, Kuvendi i Kaçanikut me qëllim që vendimet e kuvendit të jenë harmoni me ligjet që janë në fuqi në Republikën e Kosovës duke përdorur konsultimin paraprak, ka kërkuar nga MAPL që të jep vlerësimin në lidhje me marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm – me qira Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, pronë e paluajtshme e komunës duke shtyrë marrjen e këtij vendimi, derisa MAPL të jep vlerësimin rreth kësaj çështje.

Pasi që Gjykata Supreme e Kosovës ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë kundër kryetarit të Komunës së Kaçanikut Xhabir Zharku, me këtë rast kryetari ka ofruar dorëheqjen me datën 11 maj 2012, dhe mandati i tij ka përfunduar sipas nenit 56, pika c të në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
Duke u bazuar në dispozitat e nenit 60 paragrafi 60.3 të LVL-së dhe në dispozitat e nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2010, MAPL për procedurën e përfundimit të mandatit të Kryetarit të Komunës, pozitën e Kryetarit të Komunës deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri të Komunës e ka ushtruar nënkryetari i komunës.
Zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Kaçanikut janë shpallur nga Presidentja e Kosovës me datën 17 qershor 2012. Në raundin e parë të zgjedhjeve, kryetar i Komunës së Kaçanikut

zgjedhet z. Besim Ilazi. Mbledhja solemne për dhënien e betimit të kryetarit është mbajtur me datën 2 korrik 2012.

**Të gjeturat**
Gjatë vitit 2012, kuvendi i komunës ka rishqyrtuar disa vendime të cilat MAPL, i ka konsideruar që nuk janë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
Vendimet të cilat MAPL ka kërkuar të rishqyrtohen në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut janë: Vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë.[34]

Sa i përket rishqyrtimit të akteve komunale, Komuna e Kaçanikut përkatësisht Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datën 30.07.2012, ka rishqyrtuar kërkesën e MAPL-së, për të rishqyrtuar vendimet e marra më datën 04.04.2012 në lidhje me kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për ujë dhe mbeturina, të cilat vendime i ka shfuqizuar.
Kuvendi i Komunës së Kaçanikut me datën 30.04.2012 ka miratuar vendimin për riemërimin e pronës së paluajtshme komunale në të gjitha institucionet Arsimore, Shëndetësore dhe të Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit.[35]

**Komuna e Fushë-Kosovës**
Kuvendi i Komunës së Fushë- Kosovës gjatë vitit 2012, ka funksionuar normalisht dhe ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta.
Këto mbledhje kanë qenë transparente për publikun dhe çdo herë është vërejtur prezenca e ekzekutivit të komunës, duke përfshirë edhe Kryetarin e Komunës.
Sa i përket funksionalizimit të teleprezencës të vendosur nga MAPL-ja, Komuna e Fushë Kosovës në fillim ka pasur vështirësi, mirëpo është tejkaluar dhe sistemi i teleprezencës funksionon normalisht.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësë për raportim para anëtarëve të kuvendit, Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovë ka raportuar, duke paraqitur të arriturat dhe sfidat e kësaj komune.
Krahas kësaj, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës ka miratuar akte të ndryshme komunale. Në këtë drejtim, kuvendi ka miratuar 46 vendime dhe dy rregullore.
Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë miratuar gjatë kësaj periudhe janë: Vendimi për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2012-2015. ,
Vendim për miratimin e Panit të Veprimit Lokal për Mirëmbajtjen e Sipërfaqeve të Gjelbëruara 2012-2013. Poashtu, Kuvendi i Komunës ka miratuar plotësim ndryshimin e statutit të komunës,

[34] Në lidhje më këtë shkresë MAPL, me datën 20 qershor ka lëshuar një shkresë shpjeguese për të gjitha komunat ku kushtëzimin e qytetarëve për ofrimin e shërbimeve nga ana e komunave për kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike komunale, nuk ka bazë ligjore dhe si të tilla nuk mund të aplikohen. Bazuar në nenin 128 të Ligjit Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare si dhe ligjin për ndërmarrjet publike Nr.03/L-087, i cili ka përcaktuar se shoqëria tregtare është përgjegjëse për të gjitha detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj dhe askush nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionar në ketë shoqëri.
[35] MAPL, bazuar në mandatin ligjor me datën 22.05.2012 i ka dërguar shkresën Komunës së Kaçanikut ku kërkon nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi që të rishqyrtoj këtë vendim pasi vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut i datës 30.04.2012, është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, i cili ka përcaktuar se Agjencioni Kosovar i Privatizimit është kompetent për të menaxhuar dhe administruar me pronën shoqërore në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

ka miratuar Planin e veprimit për integrimin e minoriteteve si dhe një varg vendimesh me rëndësi, si kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015, Rregulloren për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e administratës komunale etj.

**Të gjeturat**
Gjatë këtij viti MAPL-ja ka vlerësuar një vendim përmbajtja e të cilit është i kundërligjshëm. Bëhet fjalë për vendimin që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzimit të përkohshëm të sipërfaqes prej 3 ari palës Hatixhe Ramadani me destinim për ndërtimin e objektit të përkohshëm për banim. Mirëpo pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e këtij akti, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 25.11.2012, ka rishqyrtuar vendimin konform shkresës së MAPL-së, dhe ka anuluar këtë vendim.

Kuvendi i komunës së Fushë Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 25 tetor 2012, ka shfuqizuar edhe vendimin Nr. 47, të datës 07.04.2010, me të cilin qytetarët kanë qenë të kushtëzuar të bëjnë pagimin e faturave për mbeturina ndaj kompanisë regjionale "Pastrimi"për marrjen e dokumentit të taksës rrugore komunale për regjistrim të automjeteve.
Për rishqyrtimin këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës i ka kontribuar edhe vizita sipas "Planit të monitorimit" të cilën e kemi pasur me zyrtarët komunal konkretisht me Kryesuesin e Kuvendit, dhe Drejtorin e Administratës të cilët janë shprehur të gatshëm për bashkëpunim.

Kuvendi i komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 30.11.2012 ka marrë vendim për marrje në shfrytëzim të përkohshëm me qira objektin në të cilin që nga viti 1999 ka qenë e vendosur administrata komunale, ndërsa mëpastaj është privatizuar nga AKP.

**Komuna e Malishevës**
Gjatë vitit 2012 Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Sa i përket numrit të akteve të miratuara, kuvendi gjatë vitit 2012, ka miratuar 28 vendime dhe 5 rregullore.
Në Komunën e Malishevës, monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë përmes sistemit të teleprezencës, me përjashtim të tre-mujorit të dytë të vitit 2012 ku ky sistem nuk ka qenë funksional për shkak të pengesave teknike të paraqitura.

Sa i përket mbledhjeve të mbajtura, është evidentuar një rast i lëshimit të mbledhjes së Kuvendit nga ana e anëtarëve të opozitës, për arsye të refuzimit të kërkesës së tyre për shtyrjen e një pike të rendit të ditës që ishte paraparë për mbledhjen e 30 marsit.
Po ashtu, në mbledhjen e mbajtur në muajin qershor, këshilltarët komunal nga radhët e opozitës nuk kanë marrë pjesë në votim në shenjë paknaqësie të propozimeve për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për personalitetet e caktuara, me rastin e 16 qershorit - Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, të dhëna në bazë të propozimit të Këshillit Organizativ.

Sa i përket Komiteteve Obligative, ka qenë funksional Komiteti për Politikë dhe Financa i cili ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 8 mbledhje.

Gjate vitit 2012, në Komunën e Malishevës janë themeluar edhe këto Komitete tjera si : Komiteti i Diasporës, Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të luftës së UÇK-së, dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

Në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur në muajin prill, ka dhënë betimin anëtari i ri i Kuvendit nga radhët e LDK-se duke e zëvendësuar anëtarin tjetër të të njëjtit subjekt për shkak që nuk kishte marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit që nga shtatori i vitit 2009 deri në dhjetor të vitit 201. Kryesuesi i Kuvendit i është drejtuar Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ-së) në Malishevë që në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të fillojnë procedurat e zëvendësimit të këtij anëtari me anëtarin e ri.
Sa i përket raportimit të Kryetarit të Komunës para Kuvendit, në këtë drejtim kryetari ka raportuar dy herë para Kuvendit.

Lidhur me aktet e miratuara, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve, rregulloren për organizimin e brendshëm të administratës komunale si dhe plotësim ndryshimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme në territorin e Komunës së Malishevës.

**Të gjeturat**
1) Në këtë Komunë, nga aktet e miratuara është evidentuar një shkelje ligjore në marrjen e Vendimit nr.01/557 datë 21.05.2012, për kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë, me rastin e regjistrimit të automjeteve për përfituesit e shërbimeve nga ”Ekoregjioni” dhe “Hidroregjioni’ njësia në Malishevë. Prandaj, MAPL pas shqyrtimit të vendimit në fjalë, ka konstatuar se vendimi është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr3/2004 mbi urdhëresat ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, sipas të cilit komunat mund të kushtëzojnë qytetarët për pagimin e tatimit në pronë me kryerjen e këtyre shërbimeve komunale: të gjitha shërbimet e Zyrave Kadastrale të Komunës, lejet e ndërtimit, inspektimi i ndërtesave, leja për përdorimin e pronës së komunës, licencë/leja për përdorimin e pijeve alkoolike, leja për përdorimin e ndërtesave për aktivitete profesionale, leja për pronësinë e veturës brenda kufijve të Komunës dhe leja për garazh komerciale, por jo edhe për nevoja të përmbushjes së obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike komunale.

Prandaj, kufizimi i shërbimeve nga Komuna për qytetarët, bizneset dhe operatorët ekonomik që funksionojnë brenda territorit të saj me kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë, me rastin e regjistrimit të automjeteve për përfituesit e shërbimeve nga”Ekoregjioni” dhe “Hidroregjioni’ njësia në Malishevë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, e gjithashtu nuk ka bazë juridike dhe ligjore për ndërmarrjen e veprimeve të tilla.
Edhe pas shkresës që ka dërguar MAPL, për të gjitha komunat në lidhje me kushtëzimin që u bëhet qytetarëve, Kuvendi i Komunës së Malishevës ende nuk e ka shfuqizuar këtë vendim.

2) Kuvendi i Komunës së Malishevës gjatë kësaj periudhe ka miratuar vendimet për ndarjen e pronave për ndërtimin e xhamive në fshatin Panorc dhe Guriq e për të cilat vendime MAPL i ka dërguar shkresën komunës së Malishevës, ku i kërkon që brenda afateve ligjore të harmonizoj këto vendime më legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, konkretisht ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Kuvendi i Komunës ka miratuar edhe rregulloren për

organizimin e brendshëm të administratës komunale si dhe plotësim ndryshimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme në territorin e Komunës së Malishevës.

**Komuna e Mamushës**

Kuvendi i Komunës së Mamushës, gjatë vitit 2012, ka mbajtur 11 mbledhje. Në fillim ka pasur vështirësi në funksionalizimin e sistemit të teleprezencës, por tani funksionon normalisht. Në Komunën e Mamushës problem paraqet përkthimi gjatë seancave të kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë periudhës janar- dhjetor 2012, ka miratuar 15 vendime dhe 3 rregullore.

Kuvendi ka miratuar raportin e punës së Kryetarit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2012, si dhe kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015, e cila kornizë ka kaluar dëgjimet publike me qytetarë, gjithashtu ka miratuar ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013. Vlen të theksohet se Kuvendi i kësaj komune gjatë vitit 2012, ka miratuar emblemën e Komunës së Mamushës pastaj, raportin e punës së kryetarit për gjashtë mujorin e parë,, rregulloren për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Mamushës, rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013, si dhe rregulloren për organizimin e brendshëm të komunës, kuvendi ka bërë edhe plotësim ndryshimin e rregullores së punës së Kuvendit.

Komuna e Mamushës ka lidhur marrëveshje për binjakëzim me Komunën e Elazig dhe Komunën Boztepe të Republikës së Turqisë.

**Të gjeturat**

- Gjatë kësaj periudhe në Komunën e Mamushës ka pasur vështirësi në përkthimin e mbledhjeve të kuvendit.
- Komuna e Mamushës edhe pse ka arritur të formoj KKSB-në, deri më tani ende nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

**KOMUNAT:VITI, OBILIQ, HANI I ELEZIT, LIPJAN, PODUJEVË, KLINË DHE DRAGASH**

Në komunat: Obiliq, Viti, Hani i Elezit, Lipjani, Podujevës, Klinë dhe Dragash, kuvendet e komunave kanë mbajtur numrin e paraparë të mbledhjeve me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, respektivisht nenit 43.2 për mbajtjen e së paku 10 mbledhje në vit. Kuvendet e këtyre Komunave kanë qenë funksionale dhe kanë zhvilluar me rregull veprimtarinë e tyre. Në këto komuna nuk ka pasur ndonjë ankesë nga anëtarët e kuvendeve lidhur me dërgimin e materialeve dhe ftesave për mbledhje.

***Mbledhjet e kuvendeve të komunave*** – Gjatë vitit 2012, të dhënat për mbledhjet e kuvendeve qëndrojnë si në vijim: nga 12 mbledhje kanë mbajtur Obiliqi, Dragashi, Lipjani, Hani i Elezit, 11 mbledhje ka mbajtur Klina, 10 mbledhje Vitia, ndërkaq 9 mbledhje ka mbajtur Podujeva.
Sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, Komuna e Klinës, Obiliqit dhe Dragashit kanë mbajtur nga 2 mbledhje, Lipjani dhe Hani i Elezit kanë mbajtur nga 1 mbledhje, Komuna e Podujevës ka mbajtur 3 mbledhje, kurse Komuna e Vitisë nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.




| | Viti | Obiliq | Hani i Elezit | Podujevë | Lipjan | Dragash | Klinë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 10 | 12 | 11 | 9 | 12 | 12 | 11 |
| Mb.e jashtëzakonshme | 0 | 2 | 1 | 3 | 1 | 2 | 2 |

**Fig.15.** *Numri i mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të mbajtura në vitin 2012 në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Podujevë, Lipjan, Dragash dhe Klinë.*

Pasqyra e mbajtjes së mbledhjeve tregon se këto komuna qëndrojnë në përputhje me normat ligjore që kërkohen për mbajtjen e numrit të caktuar të mbledhjeve. Krahasuar me vitin 2011 kemi përafërsisht numër të njëjtë të mbledhjeve.
Në këto komuna rendi i ditës është përcaktuar nga Kryesuesit e Kuvendeve në bashkëpunim me Kryetarët e Komunave, megjithëse në raste të caktuara kanë lidhur mosmarrëveshje lidhur me rendin e ditës. E rëndësishme është që nuk ka ndodhur që mbledhjet të mos zhvillohen për shkak të kundërshtimeve në rendin e ditës. Agjenda e mbledhjeve të kuvendit në vazhdimësi është shtjelluar edhe në komitetet e obligueshme.

Mbledhjet e Kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, është mundësuar transmetimi direkt dhe indirekt i mbledhjeve. Transmetimet janë bërë përmes televizioneve lokale dhe ueb-faqes së komunës me anë të shfrytëzimit të aplikacioneve të sistemit të teleprezencës. Sa i përket informimit të qytetarëve lidhur më mbajtjen e mbledhjeve, kjo është bërë poashtu përmes ueb–faqeve zyrtare të komunave, ku janë azhurnuar në vazhdimësi me informacione të shumta.

Gjatë kësaj periudhe rrjedhë normale të funksionimit kanë pasur edhe komitetet e obligueshme. Sa u përket numrit të takimeve të këtyre komiteteve, në vijim kemi paraqitur të dhënat në formë grafike:




| | Viti | Obiliq | Hani i Elezit | Podujevë | Lipjan | Dragash | Klinë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| KPF | 10 | 12 | 11 | 13 | 12 | 12 | 11 |
| KK | 4 | 2 | 3 | 10 | 9 | 9 | 11 |

**Fig.16.** *Numri i mbledhjeve të KPF dhe KK të mbajtura në vitin 2012 në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Podujevë, Lipjan, Dragash dhe Klinë*

Krahas, këtyre mekanizmave, është për t'u përmendur numri i akteve juridike nënligjore të miratuara në kuvendet e këtyre komuanve. Komunat ishin mjaft aktive në këtë drejtim, ku numri i akteve të miratuara në kuvendet e komuanve del të jetë: Vitia ka miratuar 4 rregullore dhe 29 vendime; Hani i Elezit ka miratuar 4 rregullore dhe 48 vendime, Obiliqi ka miratuar rregullore 5 dhe 53 vendime, Lipjani 1 rregullore dhe 22 vendime, Podujeva 3 rregullore dhe 16 vendime, Dragashi 3 rregullore edhe 13 vendime, si dhe Klina ka miratuar 1 rregullore dhe 37 vendime.




**Fig.17.** *Numri i Vendimeve dhe Rregulloreve gjatë vitit 2012 në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Podujevë, Lipjan, Dragash dhe Klinë*

Me qëllim të krijimit të kushteve dhe të sjelljes së qytetarëve sa më afër procesit të vendimmarrjes, komunat gjatë vitit 2012 kanë mbajtur takime publike me qytetarë. Në të gjitha këto komuna janë organizuar nga 2 tubime publik me qytetarë.

Lidhur me procesin e shqyrtimit administrativ të akteve komunale, me qëllim të koordinimit ndërministror dhe për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, janë themeluar komisionet përkatëse varësisht nga fushat që prekin aktet e miratuara. Duke marrë parasysh se MAPL-ja është autoritet mbikëqyrës i komunave, këto të fundit janë të obliguara që konform nenit 80 të LVL-së të përcjellin aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë. Përgjithësisht, nivelit i respektimit te dispozitave ligjore te LVL-së lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë në komunat të cilat janë të përfshira në këtë pjesë të raportit është i kënaqshëm. Dërgimi i akteve për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL nga këto komuna ka qenë i rregullt, me përjashtim të Komunës së Dragashit, e cila aktet nënligjore i ka sjellur ad hoc.

***Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi*** – Komunat të cilat i kanë themeluar KKSB-të në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL janë: Komuna e Vitisë, Hanit të Elezit, Podujevës, Lipjanit. Kurse komuna e Dragashit, Klinës dhe Obiliqit nuk e kanë miratuar përbërjen e re të KKSB-së sipas U.A. të lartpërmendur.
Lidhur me numrin e takimeve të mbajtura, KKSB në këto komuna ka mbajtur numrin e mbledhjeve si në vijim: Në komunën e Vitisë dhe Hanit të Elezit ka mbajtur 12 mbledhje, Obiliq 2 mbledhje, Viti 7 mbledhje, Dragash 3 mbledhje, Lipjanit dhe Podujevë nga 5 mbledhje. Mbledhjet e KKSB-së janë kryesuar nga Kryetarët e Komunave.




**Fig.18.** *Numri i mbledhjeve të KKSB-ve të mbajtura në vitin 2012 në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit, Podujevë, Lipjan, Dragash dhe Klinë*

## Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendit

### Komuna e Vitisë

Kuvendi i Komunës së Vitisë në këtë periudhë raportuese ka funksionuar normalisht. Çështjet e trajtuara gjatë punimeve të Kuvendit kanë zgjuar interesim për anëtarët e kuvendit, duke reflektuar në këtë mënyrë pozitivitet dhe pjesëmarrje më të madhe në temat e diskutuara.
Kuvendi i Komunës së Vitisë është mbledhur 10 herë brenda vitit, ndërkaq lidhur me vijueshmërinë e takimeve, kemi shënuar një rast kur subjekti politik nga radhët e opozitës në shenjë paknaqësie kanë lëshuar mbledhjen e kuvendit, pasi që sipas tyre nuk është respektuar renditja në ulëset e kuvendit sipas përfaqësimit të subjekteve politike.

Në këtë komunë ka pasur edhe mospajtime nga anëtarët e kuvendit të cilët nuk janë pajtuar me punën e ekzekutivit, e sidomos ndaj kryetarit të komunës për shkak të mospjesëmarrjes së tij në mbledhjet e kuvendit të komunës.
Sa i përket formës së zhvillimit të takimeve, mbledhjet e kuvendit kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, është mundësuar transmetimi direkt dhe indirekt i mbledhjeve. Edhe sistemi i teleprezencës për monitorimin e mbledhjeve ka qenë funksional.

Në lidhje me komitetet obligative, më tepër funksionale ka qenë Komiteti për Politikë dhe Financa me10 mbledhje të mbajtura, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 4 mbledhje. Rëndësia e këtyre komiteteve është e madhe, për faktin se gati në të gjitha rastet paraprakisht bëhet koordinimi i qëndrimeve të cilat shkurtojnë kohën e panevojshme në zhvillimet e kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar 29 vendimedhe 4 rregullore.
Ndër aktet më të rëndësishme kanë qenë: Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë; Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime

dhe Lagje Urbane; Vendimi për planin rregullues urban për zonat “Qendrore, Jugore dhe lumit Morava” të qytetit të Vitisë, si dhe një numër aktesh të tjera.

**Të gjeturat**

Krahas kësaj, megjithëse janë miratuar akte më rëndësi për Komunën e Vitisë, gjatë kësaj periudhe janë paraqitur disa raste kur Kuvendi i Komunës së Vitisë nuk i ka ndjekur procedurat që kërkohen me ligjet në fuqi. Kjo situatë i ka dhënë hapësirë veprimi Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal duke kthyer në rishqyrtim disa nga aktet e miratuara në kuvend.

Në bazë të vlerësimit të MAPL-së kemi pasur tri akte përmbajtja e të cilave ka qenë e kundërligjshme. Mirëpo, pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e tyre, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka ndërmarrë hapat e duhur drejt zbatimit të legjislacionit në fuqi, duke vepruar në përputhshmëri me rekomandimet e organit mbikëqyrës. Bëhet fjalë për Vendimin i cili ka të bëjë me kushtëzimin e shërbimeve me pagesën e faturave të mbeturinave dhe ujit për qytetarët e Komunës së Vitisë, i cili mëpastaj është shfuqizuar.

Një akt tjetër është Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, OVL të UÇK-së, Autoparkingjeve në Komunën e Vitisë, poashtu i shfuqizuar në një mbledhje të radhës, kurse një rast tjetër kemi Vendimin për bartjen e paluajtëshmerive të K0munës së Vitisë në shfrytëzim të personit fizik. Ky vendim është vlerësuar i kundërligjshëm të cilin komuna më pastaj e ka shfuqizuar.

**Komuna e Obiliqit**

Kuvendi i komunës së Obiliqit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakondëshme. Kuvendi ka funksionuar normalisht duke pasur mbarëvajtje të rregullt të mbledhjeve. Në lidhje me pjesëmarrjen e subjekteve politike në kuvend, është paraqitur një rast i bojkotimit të mbledhjes nga opozita, për shkak të paknaqësisë lidhur me pikat e rendit tëditës. Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket komiteteve obligative, në Komunën e Obiliqit për këtë periudhë ka funksionuar Komiteti për Politikë dhe Financa duke mbajtur 12 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 2 mbledhje, që do të thotë se nuk ka qenë funksional.

Në kuvendin e kësaj komune gjatë kësaj periudhe janë miratuar 58 akte komunale, prej tyre 53 vendime dhe 5 rregullore.
Ndër aktet me të rëndësishme të miratuara në këtë periudhë mund të përmenden: Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Administratës së Komunës; Rregullorja për lehtësirat e bizneseve vendore dhe investuesit e jashtëm

**Të gjeturat**

Në mesin e akteve të miratuara, MAPL-ja ka konstatuar një vendim të kundërligjshëm. Bëhet fjalë për Vendimin i cili ka të bëjë me transparencën e Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe bordit të drejtorëve. Ky vendim është kthyer në rishqyrtim me rekomandim të MAPL-së dhe është harmonizuar.

**Komuna e Hanit të Elezit**
Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka funksionuar me rregull dhe ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
Sa i përket komiteteve obligative, në Komunën e Hanit të Elezit për këtë periudhë ka qenë funksional Komiteti për Politik dhe Financa, duke mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 3 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar 58 akte, prej tyre 53 vendime dhe 5 rregullore.
Ndër aktet më të rëndësishme të miratuara janë: Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Administrative: Rregullorjapër organizimin e kompetencave dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale; Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

**Të gjeturat**
Megjithëse janë miratuar akte më rëndësi, sërish mbetet sfidë respektimi i plotë i kornizës ligjore në fuqi. Në këtë komunë kemi një pasqyrë jo shumë të dëshirueshme sa i përket përmbushjes së obligimeve ligjore. Gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar dy vendime me përmbajtje joligjore**.** Është fjala për Vendimin për dhënien e pëlqimit për hulumtim te xeheroreve te hekurit dhe nikelit. Këtë vendim e ka vlerësuar të kundërligjshëm komisioni përkatës ndërministror.

Vendim tjetër është Vendimi për dhënien e pëlqimit për hulumtim të gurit gëlqeror. Me këtë rast, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit i jep pëlqimin firmës „Sharcem„ për hulumtimin e gurit gëlqeror. Edhe ky vendim është vlerësuar i kundërligjshëm.
Megjithëse këto dy vendime janë vlerësuar të kundërligjshm si dhe përkundër kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e këtyre akteve, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit nuk i ka kthyer për rishqyrtim.

**Komuna e Podujevës**
Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë kësaj periudhe i ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 3 mbledhje të jashtëzakondëshme.
Sa u përket mbledhjeve të kuvendit, të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Podujevës, kanë qenë të hapura për publikun. Sa i përket komiteteve obligative, në Komunën e Podujevës për këtë periudhë ka qenë funksional Komiteti për Politik dhe Financa, duke mbajtur 13 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje.

Kur jemi tek sistemi i teleprezencës, Komuna e Podujevës e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit funksionon normalisht dhe pa ndonjë vështirësi, dhe monitorohet përmes këtij sistemi të Teleprezencës.
Në miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka miratuar 34 akte komunale, prej tyre 30 vendime dhe 4 rregullore.

Ndër aktet më të rëndësishme të miratuara janë: Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, Plani Rregullues Urban Qendra në Podujevë, Vendimi për themelimin komiteteve konsultative:

Vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës dhe Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2013-2015.

**Të gjeturat**
Në Komunën e Podujevës- për të paraqitur drejtë nivelin e arritjeve gjatë kryerjes së obligimeve ligjore në Komunën e Podujevës kemi një situatë më të vështir për tu kuptuar sepse kemi vërejtur një mos gatishmëri për të bashkëpunuar në zbatushmërin e legjislacionit dhe karshi obligimeve që dalin nga dispozitat ligjore. Në këtë kontekst në Komunën e Podujevës po ashtu kemi pasur vendime të kundërligjshme. Bëhet fjalë për vendimet, përmbajtja e të cilave është njëri Vendim për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për pastrimin e mbeturinave. Edhe pas vizitave të cilat i kemi pasur në komuna edhe pas vlerësimit dhe rekomandimit të MAPL-së se vendimi në fjalë është me përmbajtje jo ligjore, komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret në rishqyrtimin e tij.

Vendim tjetër me rëndësi është edhe vendim për riemërimin e paluajtshmërive në pronësi të komunës. Edhe për këtë vendim Komuna e Podujevës nuk ka marrë asnjë veprim konkret.
Për këto vendime të kundërligjshme Komuna e Podujevës ka marrë kërkesën për rishqyrtimin e tyre nga MAPL-ja, mirëpo edhe pas rekomandimit të MAPL-së, Komuna e Podujevës nuk i ka kthyer në rishqyrtim.

**Komuna e Lipjanit**
Gjatë vitit 2012, Komuna e Lipjanit ka qenë mjaftë aktive në zhvillimin e takimeve të Kuvendit të Komunës. Gjatë këtij viti Kuvendi ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Kuvendi ka funksionuar normalisht ku është respektuar në përpikëri rregullorja e punës së kuvendit.
Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
Komiteti për Politik dhe Financa në këtë periudhë ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 9 mbledhje.

Kuvendi i komunës së Lipjanit ka miratuar 23 akte komunale 22 vendime, ndërsa ka miratuar 1 rregullore. Ndër aktet komunale më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë: Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, Vendimi për ndërrimin e ngastrave kadastrale në mes të Komunës dhe P.SH. Miniera e Magnezitit Golesh- AKP-së, Vendimi mbi kornizën afatmesme buxhetore për vitet 2013 – 2015, Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, Vendim për ridestinimin dhe transferin e mjeteve nga buxheti i Komunës për vitin 2012.

**Komuna e Dragashit**
Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakondëshme. Kuvendi ka funksionuar normalisht dhe është respektuar rregullorja e punës së Kuvendit. Mbledhjet kanë qenë transparente, mirëpo ftesat e mbledhjeve dhe materialet e mbledhjeve nuk janë dërguar me kohë në MAPL.

Sa i përket komiteteve obligative, në komunën e Dragashit për këtë periudhë ka qenë më funksional Komiteti për Politik dhe Financa, duke mbajtur 12 mbledhje, ndërkaq Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 6 mbledhje.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar 16 akte komunale, prej të cilave 13 vendime dhe 3 rregullore.
Prej akteve me të rëndësishme janë: Rregullorja mbi tatimin në pronën e paluajtshme; Rregullorja mbi lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave komunale; Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm për vendosjen e tubacioneve të ujërave.

**Të gjeturat**

1) Kuvendi i Komunës së Dragashit ka marrë vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale "Hile Flores" Zgatari Komerc dhe Pleti, vendim i cili është vlerësuar si i kundërligjshëm nga MAPL

2) Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar vendim për dhënien e pëlqimit për menaxhimin e xhahishtave në territorin e Komunës së Dragashit nga shoqata "Mali i Sharrit"

MAPL ka dërguar shkresa dhe ka rekomanduar Komunën e Dragashit për t'i kthyer në rishqyrtim këto akte të konsideruara të kundërligjshme, por ende nuk ka veprim konkret për rishqyrtimin tyre.

**Komuna e Klinës**

Kuvendi i komunës së Klinës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakondëshme. Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
Në këtë komunë ka qenë funksional Komiteti për Politik dhe Financa duke mbajtur 12 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 6 mbledhje.

Kuvendi i komunës së Klinës ka miratuar 38 akte komunale, prej tyre 27 vendime dhe 1 rregullore.
Megjithëse janë miratuar akte më rëndësi për Komunën e Klinës nuk ka pasur ndonjë shkelje të evidentuar nga MAPL-ja të konstatuar.

## KOMUNAT: MITROVICË, VUSHTRRI, SKENDERAJ, GLLOGOC DHE SUHAREKË

### Mbledhjet e mbajtura

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, konkretisht neni 43.2, Kuvendi i Komunës, është i obliguar të mbajë së paku dhjetë mbledhje në vit.
Kuvendet e Komunave: Mitrovicë,Vushtrri, Skenderaj, Gllogoc dhe Suharekë kanë funksionuar normalisht. Në këto komuna, materialet për pikat e rendit të ditës së mbledhjeve iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Funksionimi i punës së Kuvendeve të këtyre komunave, ka rrjedhur normalisht duke respektuar planet e punës. Në përgjithësi, kuvendet e komunave në një masë të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Për këtë periudhë raportuese, në Komuna vërehet një organizim dukshëm më i mirë në planifikimin e aktiviteteve, orarin e takimeve, në miratimin e planeve vjetore të punës dhe të çështjeve të tjera me rëndësi. Kryesisht, debatet që janë zhvilluar gjatë punimeve të kuvendit kanë qenë konstruktive, ku në to nuk ka munguar liria e shprehjes, e mendimit të lirë, mirëkuptimit, shfrytëzimit të kohës në mënyrë racionale, si dhe duke mos tejkaluar limitet kohore ashtu siç parashihet me rregulloret e punës së kuvendeve. Sa i përket aspektit kuantitativ të vlerësimit të punës së kuvendeve.

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2012, Kuvendet e Komunave kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Kuvendi i Komunës së Mitrovicës 11 të rregullta dhe dy të jashtëzakonshme. Komuna e Skenderajt ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta, Komuna e Vushtrrisë ka 11 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, ndërsa Kuvendi i Komunës së Gllogocit ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme, kurse komuna e Suharekës ka mbajtur 10 të rregullta dhe një të jashtëzakonshme/




| | Mitrovicë | Skënderaj | Vushtrri | Suharekë | Gllogoc |
|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 11 | 11 | 11 | 10 | 10 |
| Mbledhjet e jashtëzakonshme | 2 | 0 | 3 | 2 | 1 |

**Fig.19.** *Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Gllogoc dhe Suharekë*

Sa i përket informimit të qytetarëve lidhur me mbajtjen e mbledhjeve, kjo bëhet përmes ueb – faqeve zyrtare të komunave, medieve lokale dhe lajmërimet nëpër hapësirat e komunës për mbledhje të kuvendit. Njëherit mbledhjet janë të hapura për të gjithë ata qytetarë që dëshirojnë të marrin pjesë.

Të gjitha Komunat e kanë të instaluar sistemin e teleprezencës. Rrjedha e mbledhjeve ka vazhduar normalisht pa ndonjë problem të theksuar. Po ashtu, edhe pjesëmarrja e publikut ka filluar të jetë më e madhe në mbledhjet e Kuvendeve të Komunave. Instalimi i teleprezencës ka dëshmuar faktin që është një mënyrë më funksionale dhe me efikase në monitorimin e seancave të kuvendeve komunale.




| | Mitrovicë | Skënderaj | Vushtrri | Suharekë | Gllogoc |
|---|---|---|---|---|---|
| KPF | 14 | 11 | 13 | 11 | 11 |
| KK | 3 | 10 | 11 | 10 | 7 |

**Fig.20.** *Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Suharekë dhe Gllogoc*

Komitetet e Obligueshme kanë mbajtur numrin e mbledhjeve të pasqyruara si vijon: Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Mitrovicës, ka mbajtur 11 të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Komuna e Skenderajt, 11 mbledhje të KPF-së. Komuna e Vushtrrisë ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Komuna e Gllogocit ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Komuna e Skenderajt dhe Suharekës ka mbajtur nga 11 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme. Komuna e Suharekës ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme.

Ndërsa, Komitetet për Komunitete si përgjegjëse për shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimeve të autoriteteve komunale me ligjin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, për t'u siguruar të drejtat e komuniteteve respektohen plotësisht, kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: KK në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur 3 mbledhje, në Komunën e Vushtrrisë 11 mbledhje, në Komunën e Gllogocit ka mbajtur 7 mbledhje, Komunën e Skenderajt e Suharekës, Komiteti për Komunitete ka mbajtur numrin e njëjtë të mbledhjeve nga 10 mbledhje.

Edhe këto komuna kanë qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale. Numri i këtyre akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave është, si në vijim: Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar 79 vendime dhe 5 rregullore, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka miratuar 78 vendime dhe 4 rregullore, Kuvendi i Komunës së Gllogocit ka miratuar 42 vendime

dhe 4 rregullore, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka miratuar 32 vendime dhe 5 rregullore, kurse Komuna e Suharekës ka nxjerrë 32 dhe 4 rregullore.




| | Mitrovicë | Skënderaj | Vushtrri | Suharekë | Gllogoc |
|---|---|---|---|---|---|
| Vendime | 79 | 32 | 78 | 32 | 42 |
| Rregullore | 5 | 5 | 4 | 4 | 4 |

**Fig.21.** *Numri i akteve komunale të miratuara në Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Gllogoc dhe Suharekë*

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

KKSB, në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur më së shumti mbledhje me gjithsejtë 16 mbledhje të mbajtura, pasuar nga Komuna e Vushtrrisë me 9 mbledhje të mbajtura, Komuna e Gllogocit me 6 mbledhje të mbajtura, Komuna e Suharekës 6 mbledhje, ndërsa Komuna e Skenderajt ka mbajtur vetëm 3 mbledhje.




| | Mitrovicë | Skënderaj | Vushtrri | Suharekë | Gllogoc |
|---|---|---|---|---|---|
| KKSB | 16 | 3 | 9 | 6 | 6 |

**Fig.22.** *Numri i takimeve të KKSB-ve në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Gllogoc dhe Suharekë*

Sa i përket nivelit të respektimit të dispozitave ligjore të LVL-së lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë, nëse aktet janë dërguar me kohë për shqyrtim në MAPL, mund të themi se këto komuna në masë të madhe i kanë respektuar dispozitat e LVL-së, duke i dërguar me kohë aktet komunale në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë.

## Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

### Komuna e Mitrovicës

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës i ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe dy të jashtëzakonshme, ku mund të vlerësohet se Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka funksionuar normalisht.Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës nuk janë dërguar me kohë. Sa i përket Komiteteve Obligative, KPF-ja ka mbajtur 13 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur vetëm 3 mbledhje.

Lidhur me miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar 79 vendime dhe 5 rregullore.
Në çështjen e pjesëmarrjes së Kryetarit të Komunës në mbledhjet e Kuvendit, kryetari ka qenë prezent në çdo mbledhje dhe gjithashtu ka mbajtur dy tubime me qytetarë.
Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Mitrovicës e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit është duke funksionuar normalisht dhe pa ndonjë problem të theksuar.

### Komuna e Vushtrrisë

Në vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, po ashtu duhet përmendur se Kuvendi ka funksionuar normalisht.
Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat për mbledhje dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës nuk janë dërguar me kohë. Sa i përket Komiteteve Obligative, KPF ka mbajtur 13 mbledhje, kurse KK ka mbajtur 9 mbledhje.

Në çështjen e miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka miratuar 78 vendime dhe 4 rregullore.
Kryetari i Komunës merr pjesë në mbledhjet e kuvendit çdo herë kur ka mbledhje. Ai ka mbajtur dy tubime me qytetarët, më 30.06.2012 dhe 21.12.2012 dhe 11 tubime tjera neper Bashkësi Lokale. Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Vushtrrisë e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit është duke funksionuar normalisht dhe pa ndonjë problem të theksuar.

### Komuna e Skenderajt

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Kuvendi ka funksionuar normalisht. Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat e mbledhjeve dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës nuk janë dërguar me kohë. Sa i përket Komiteteve Obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 10 mbledhje. Lidhur me miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka miratuar 32 vendime dhe 5 rregullore.

Kryetari i Komunës merr pjesë shumëherë në mbledhjet e kuvendit. Ai ka mbajtur dy tubime me qytetarët, më 20.06.2012 dhe 27.12.2012
Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Skenderajt e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit është duke funksionuar normalisht dhe pa ndonjë problem të theksuar.

**Komuna e Gllogocit**
Kuvendi i Komunës së Gllogocit gjatë vitit 2012 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Kuvendi ka funksionuar normalisht. Mbledhjet kanë qenë transparente, ndërkohë që ftesat për mbledhje dhe materialet përcjellëse të rendit të ditës janë dërguar me kohë. Sa i përket Komiteteve Obligative, KPF ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 mbledhje. Lidhur me miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Gllogocit ka miratuar 42 vendime dhe 4 rregullore.
Po ashtu, mund të themi se Kryetari i Komunës merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Kuvendit. Kryetari i Komunës ka mbajtur dy takime me qytetarët
Sa i përket sistemit të teleprezencës, Komuna e Gllogocit e ka funksionalizuar këtë sistem dhe procesi i monitorimit është duke funksionuar normalisht dhe pa ndonjë problem të theksuar.

**Komuna e Suharekës**
Në vitin 2012, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Komitetet obligative janë funksionale, ku KPF ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK 6 mbledhje.
Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë përmes sistemit të teleprezencës, i cili ka funksionuar mjaftë mirë. Kryetari i Komunës merr pjesë në mbledhjet e kuvendit çdo herë kur ka mbledhje. Ai ka mbajtur dy tubime me qytetarët komunës.
Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, KFOR-it, USAID-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Në komunën e Suharekës gjatë këtij viti, janë evidentuar 2 shkelje ligjore tek marrja e Vendimit mbi plotësimin e vendimit për këshillin e ekspertëve për hartimin e planit zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planit rregullues urbane, si dhe Vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për ndarje e çmimeve për nder të "13 qershorit" ditës së çlirimit të Suharekës, në përbërje prej 7 anëtarëve, pasi që në këtë Komision nuk është përshirë asnjë anëtar nga radhët e gjinisë femërore.

Këto vendime janë në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.2004/2.
Për këto vendime ,MAPL ka dërguar shkresë në Komunë me të cilin ka kërkuar që të bëhet shqyrtimi i vendimeve në fjalë, me qëllim të përfshirjes së gjinisë femërore në këtë Këshill, por megjithatë gjatë kësaj periudhe Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

Në këtë periudhë të raportimit Kryetari i Komunës së Suharekës ka raportuar 4 herë para anëtarëve të Kuvendit.

Prej gjithsej 32 vendimeve dhe 4 rregullore të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë vitit 2012, si më të rëndësishme mund të konsiderohen:
1) Vendimi mbi miratimin e planit rregullues në lagjen "Pojata" në Suharekë;
2) Vendimi mbi miratimin e planit rregullues në lagjen "Shirok" në Suharekë;

3) Vendim për miratimin e raportit të menaxhimit financiar  të buxhetit të Komunës së Suharekës**;**
7) Vendim për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite të pronës së paluajtshme të Komunës;
8) Vendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2013;
9) Rregullorja për punën e grupit të grave anëtare të Kuvendit të Komunës në Suharekë**.**

**KOMUNAT: GRAÇANICË, KLLOKOT, PARTESH, RANILLUG DHE SHTRËPCË**

Gjatë periudhës janar – dhjetor  2012, Kuvendet Komunave, Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtërpcë kanë përmbushur obligimin ligjor sa i përket numrit të mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe më kohë kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat si dhe afatet e njotimit.
Kuvendet e këtyre  komunave gjithsejte kanë mbajtur 63 mbledhje, prej të cilave 49 të rregullta dhe 14 të jashtëzakonshme. Në vijim kemi paraqitur figurën me numrin e mbledhjeve të mbajtura:




| | Graçanicë | Kllokot | Partesh | Ranillug | Shtërpcë |
|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhjet e rregulla | 8 | 11 | 10 | 10 | 10 |
| Mbledhjet e jashtëzakonshme | 5 | 2 | 5 | 1 | 1 |

**Fig.23.** *Numri i mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të mbajtura në vitin 2012, në Komunat: Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtrëpce*

Siç vërejmë nga figura e mësipërme, Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Shtërpca, 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Ranillugu 10 të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Partesh 10 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme si dhe Komuna e  Graçanicë 8 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme.

Kurse sa i përket komitetit për komunitete, në vijim kemi paraqitur figurën me të dhënat për numrin  e mbledhjeve:




| | Graçanicë | Kllokot | Partesh | Ranillug | Shtërpcë |
|---|---|---|---|---|---|
| KPF | 13 | 11 | 11 | 10 | 9 |
| KK | 11 | 11 | 4 | 6 | 8 |

**Fig.24.** *Numri i mbledhjeve të KPF dhe KK të mbajtura në vitin 2012, në Komunat: Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtrëpce*

Lidhur me miratimin e akteve juridike nënligjore, Kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar gjithsejtë 279 akte komunale, përkatësisht 245 vendime dhe 34 rregullore.




| | Graçanicë | Kllokot | Partesh | Ranillug | Shtërpcë |
|---|---|---|---|---|---|
| Vendime | 105 | 26 | 35 | 45 | 34 |
| Rregullore | 5 | 8 | 10 | 4 | 7 |

**Fig.25.** *Numri i Vendimeve dhe Rregulloreve gjatë vitit 2012, në Komunat: Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtrëpce*

Për më saktë, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka numrin më të madh të akteve të miratuara me gjithsejtë 145 vendime dhe 5 rregullore, më pas vjen Kuvendi i Komunës së Parteshit me 35 vendime dhe 10 rregullore të miratuara, Kllokoti me 26 vendime dhe 8 rregullore, Shtërpcë 34 vendime dhe 7 rregullore, si dhe Kuvendi i Komunës së Ranillugut me 45 vendime dhe 4 rregullore të miratuara.

Komunat: Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtërpce gjatë këtij viti kanë mbajtur një sërë takimesh publike me qytetarë. Komuna e Graçanicës ka mbajtur 4 takime publike me qytetarë, Komuna e Kllokotit dhe Parteshit kanë mbajtur nga 3 takime publike me qytetarë, Komuna e Ranillugut ka mbajtur 2 takime publike me qytetarë, kurse Komuna e Shtërpcës ka mbajtur një takim më qytetarë. Çështjet të cilat janë diskutuar në këto takime kanë prekur fushat si: rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lokalitetet urbane, asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i kanalizimeve, përgatitja e propozim buxhetit të Komunave, përdorimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare etj.

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe fusha e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Është i njohur fakti se në komuna janë funksionale trupat këshillëdhënëse për siguri, të njohur si Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Sipas të dhënave, KKSB, në këto komuna kanë mbajtur numër të caktuar të mbledhjeve gjithesejt 31 mbledhje në te gjitha komunat konkretisht në Komunen e Graçanicës 4 mbledhje, Shtërpcë 8, Kllokot 10 mbledhje, Partesh7, dhe Ranillug 1 mbledhje.




| | Graçanicë | Kllokot | Partesh | Ranillug | Shtërpcë |
|---|---|---|---|---|---|
| KKSB | 4 | 10 | 7 | 1 | 8 |

**Fig.26.** *Numri i mbledhjeve të KKSB-ve të mbajtura në vitin 2012, në Komunat: Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug dhe Shtrëpce*

## Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve

### Komuna e Graçanicës

Kuvendi i Komunës së Graçanicës në periudhën janar-dhjetor 2012 ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashzakonshëm. Në këtë periudhe KPF dhe KK kanë funksionuar normalisht dhe kanë mbajtur numër të caktuar të takimeve, konkretisht, Komiteti për politikë dhe financa ka mbajtur 13 takime, ndërsa Komiteti për komunitete ka mbajtur 10.

Në kuadër mbledhjeve të kuvendit janë shqyrtuar çështje dhe janë marrë vendime te rëndësishme si për komunën ashtu edhe për qytetarët. Të gjitha mbledhjet kanë qenë transparente për publikun ku përveç qytetarëve në takime kane marrë pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE- etj.

Puna e kuvendit është përcjellur përmes sistemit të teleprezencë, i cili në fillim ka pasur vështirësi, por me vonë janë tejkaluar dhe tani funksionon normalisht.

Sa i përket komunikimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komuna e Graçanicës ka treguar efikasitet dhe bashkëpunim me ministrinë dhe janë kryer obligimet sipas ligjit. Ajo çfarë është me rëndësi, me propozim të kuvendit është miratuar propozimi “Ditët e dyerve të hapura” ku qytetarët çdo të mërkurë të tretë të muajit mund të bisedojnë me anëtarët e kuvendit, ku bashkërisht do kontribuonin për zgjidhjen e problemebe të përbashkëta.

Rendi i ditës për punën e kuvendit është përpiluar në bazë të planit vjetor të Kuvendit të Komunës, në bazë të kërkesave të drejtorëve komunale (të cilët paraqesin përveç çështjeve te tyre kanë adresuar kërkesat e qytetarëve) dhe në fund Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, kanë përpiluar rendin e ditës sipas këtyre propozimeve. Duhet theksuar se roli i kryetarit të komunës ka qenë i rëndësishëm sepse edhe gjithherë ka qenë present në punimet e kuvendit .

Gjatë zhvillimit të punimeve të kuvendit, është evidentuar një rast i konfliktit të interesit nga ana e kryesuesit të kuvendit. Behet fjalë për një kërkese ku vihet në pyetje interesi i tij. Në këtë rast kryesuesi nuk ka votuar për këtë pikë duke shmangur konfliktin e interesit.

Në kuadër të planit të vizitave në komuna, zyrtarët e MAPL e kanë vizituar Graçanicës, ku janë takuar me kryesuesin e kuvendit dhe drejtorin e administratës në të cilin takim është diskutuar për monitorimit organeve të komunës, monitorimin e realizimit të qasjes ne dokumente zyrtare dhe inventarizimi e akteve komunale qe janë ne fuçi.

Kuvendi ka miratuar edhe një numër të konsiderueshëm të vendimeve dhe rregulloreve në interes të qytetarëve të komunës siç janë: Vendimi për Planin vjetor të punës se KK Graçanicë, Vendimi për Formimin e këshillit për planifikim hapësinor, Rregullorja për planin lokal ne fushën e invaliditetit (LPAI ) në Komunën e Graçanicës për periudhën 2013/2017.

### Të gjeturat

Sa përket ligjshmërisë së akteve në Komunën e Graçanicës, kemi një pasqyrë jo shumë të dëshirueshme sa i përket kuadrit ligjor dhe përmbushjes së obligimeve ligjore të Komunës.

Në këtë komunë janë evidentuar katër akte komunale përmbajtja e të cilave është vlerësuar e kundërligjshme**.** Bëhet fjalë për vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Vendimin për ndryshimin e Rregullores komunale për ngarkesa dhe gjoba komunale, Vendimin për dhënien në shfrytëzim të objektit të Komunës "Qendra Rinore" në Preoc Teatrit Amator Geto Nr. 146, si dhe Vendimin për dhënien në shfrytëzim të objektit të komunës „QRP Graçanicë „ Radio Graçanicës Nr. 145.
MAPL ka dërguar shkresa dhe ka rekomanduar Komunën e Graçanicës për ti kthyer në rishqyrtim këto akte të konsideruara të kundërligjshme por ende nuk ka veprim konkret në rishqyrtimin tyre.

**Komuna e Kllokotit**

Kuvendi i Komunës së Kllokotit në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 ka mbajtur 11 takime të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Kuvendi ka funksionuar normalisht, ku është respektuar rregullorja e punës. Mbledhjet e kuvendit janë zhvilluar në të dy gjuhët, e poashtu materialet dhe ftesat janë dërguar me kohë.
Edhe komitetet obligative kanë funksionuar normalisht, ku Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 11 takime.
Mbledhjet e kuvendit zakonisht janë përcjell nëpërmjet sistemit të teleprezencës i cili ka funksionuar normalisht dhe nuk ka pasur pengesa.

Kuvendi i komunës ka miratuar edhe një vrag aktesh me rendësi për qytetarët e komunës, në mesin e të cilave është Vendimi për planin urbanistik zhvillimor për zonën kadastrale Kllokot 2012-2017, Vendimi për Planin vjetor të punës se Kuvendit komunal Kokot, për vitin 2012, Vendimi për ndërimin e pronësisë së parcelave nr. 526-0(PUT) dhe parcelës nr. 528-0 (Rexhep Rama) në zonën kadastrale në Kllokot, Vendimi për ndarjen e mjeteve nga të ardhurat vetanake në projekte kapitale, Vendimi për shfrytëzim të fondit për zhvillim prej 250.000 dollarë nga USAID-a DEMI-Program për projektin kapital "Ndriçimi rrugor faza e II". Kuvendi ka miratuar edhe Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, lagje urbane në territorin e komunës së Kllokotit.

**Të gjeturat**

Në Komunën e Kllokotit, në bazë të vlerësimit të MAPL-së janë evidentuar akte përmbajtja e të cilave ka qenë e kundërligjshme. Përkundër kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin këtyre vendimeve, Kuvendi i Komunës së Kllokotit nuk ka ndërmarrë hapat e duhur drejt zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Bëhet fjalë për vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës, banjës Nëna Naile (Qendrës për mjekësi familjare dhe rehabilitim). MAPL-ja ka dërguar shkresën që ky vendim duhet të rishqyrtohet, por Kuvendi i Komunës së Kllokotit nuk ka ndërmarrë hapa konkret për zbatimin e rekomandimeve të MAPL-së.

**Komuna e Parteshit**

Kuvendi i Komunës Parteshit, në periudhën janar – dhjetor 2012 ka mbajtur 10 takime të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme,

Komuna i ka dërguar me kohë materialet dhe ftesat për mbledhje, të përkthyera në gjuhët zyrtare, me çka janë respektuar nenet 43.4 i 43.5 LVL-së. Rendi i ditës, pjesëmarrja e anëtarëve të kuvendit si dhe kuorumi për mbledhje çdo herë ka qenë në bazë të dispozitave të LVL-së.

Takimet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare OSCE-a,USAID-DEMI. Sistemi i teleprezencës ka qenë funksional dhe takimet janë përcjellë përmes këtij sistemi.

Kryetari i komunës nuk ka qenë i rregullt në takimet se Kuvendit të Komunës, ai si rregull ka autorizuar nënkryetarin në këto takime.

Zyrtaret e MAPL-së në bazë të planit të monitorimit të komuanve, kanë monitoruar drejtpërdrejt Komunen e Parteshit, ku janë zhvilluar takime me Kryesuesin e Kuvendit dhe zyrtaret komunal, me të cilët është biseduar në lidhje më:

Monitorimin e ligjshmërisë së aktiviteteve të organeve komunale.

Monitorimin e respektimit të drejtave te njeriut ne nivel komunal.

Monitorimin e realizimit te ligjit për qasje ne dokumente publike.

Inventarizimin e dokumenteve zyrtare që janë në fuqi etj.

Aktet të cilat i ka miratuar kuvendi gjatë kësaj periudhe janë:

1.Vendim për miratimin e rregullores për kushtet minimal-higjenik-teknike dhe kushtet sanitare te zyrave,pajisjeve mbrojtëse dhe mbrojtjes se mjedisit;

2.Vendim për formimin e këshillit të planit hapësinor të komunës;

3.Vendim për ndarjen e parcelës për kishën.

Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar edhe disa rregullore si:

1.Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra,vendbanime dhe zona te qytetit ne territorin e Komunës se Parteshit;

2.Rregulloren për mbrojtje të mjedisit;

3.Rregulloren për punën e kuvendit si dhe Rregulloren për subvencionet.

**Komuna e Ranillugut**

Kuvendi i Komunës së Ranillugut, në periudhën janar- dhjetor të vitit 2012 mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje. Ndërkaq, Komitetet obligative, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 3 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Ranillugut i ka dërguar me kohë ftesën dhe materialin e Kuvendit, mirëpo materialet nuk kanë qenë të përkthyera në gjuhën shqipe. Pra, në këtë drejtim nuk është respektuar neni 43.4 i LVL-së megjithatë informacioni lidhur me mbledhjen është në përputhje të plotë me nenin 43.4 dhe 43.5 LVL-së.

Të gjitha pikat e rendit të ditës, materialet e nevojshme për mbledhje, prania e anëtarëve të kuvendit, kuorumi kanë qenë në përputhshmëri të plotë me ligjin. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun.

Grupet parlamentare kanë qenë mjaft aktive gjatë punimeve të kuvendit. Lidhur me dërgimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Rranilugut i ka dërguar me kohë aktet duke respektuar detyrimet ligjore.

Kryetari i Komunës ka raportuar 1 herë në tremujorin e parë para Kuvendit.
Në muajin shkurt 2012, nënkryetari i komunës së Ranilugut ka dhënë dorëheqjen e tij nga të gjitha përgjegjësitë, ndërkaq Kryetari i Komunës ka emëruar nënkryetarin e ri.

Ndër aktet më të rëndësishmet komunale të miratuara nga kuvendi janë:
1.Vendim për miratimin e Planit të punës se KK Ranilug për vitin 2013;
2.Vendim për miratimin e Planit Aksional te këshillit rinor te Komunës së Ranillugë;
3.Vendim për Planin aksionar për përmirësimin e shërbimeve në komunën Ranillugë. Ky vendim definon përmirësimin e shërbimeve sipas planit aksional ne disa lëmi
4.Vendim për formimin e komisionit për hartimin e planit te këshillave lokale në Komunën e Ranillugut;
5.Vendim për vendosje te prioritet për ndërtimin e dy stadiumeve te tenisit;
6.Vendim për formimin e komisionit për korrje shirje;
7.Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra,mjediset urbane te komunës.

**Të gjeturat**

Komuna e Ranillugut deri në muajin prill ka mbajtur mbledhjet e Kuvendit pa ndonjë vështirësi, megjithatë me 27.04.2012 anëtarët e kuvendit kanë kërkuar nga kryesuesi i Kuvendit që në rendin e ditës të shtojë një pikë shtesë lidhur me votëbesimin e kryesuesit. Kryesuesi nuk ka marrë parasysh këtë kërkesë me arsyetimin se nuk ishte në përputhje me procedurat ligjore, pasi sipas Statutit Komunal një propozim i tillë duhet të dorëzohet 24 orë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit. 11 nga anëtarët e kuvendit e kanë lëshuar mbledhjen e Kuvendit, kështu që nuk ka pasur kuorum për punë të mëtutjeshme. Ndërkohë të njëjtit anëtarë të kuvendit të komunës, kanë dorëzuar në Kuvendin e Komunës së Ranillugut një kërkesë për mbajtjen e një mbledhje të jashtëzakonshme. Me këtë rast kryesuesi i Kuvendit z.Gjokic këtë kërkesë e ka përcjellë në MAPL e cila ka dhënë sqarimet e nevojshme.

Pas dhënies së sqarimeve ligjore nga MAPL, me datë 22.02.2012 është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme dhe në rendin e ditës ka qenë votëbesimi për kryesuesin si dhe zgjedhja e re e kryesuesit të Kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Ranilluat ka nxjerrë vendim për dhënien e tokës komunale për shfrytëzim të përhershëm. Vendimi është vlerësuar i kundërligjshëm nga MAPL-ja, dhe përkundër kërkesës për rishqyrtim të këtij vendimi, ende nuk ka veprim konkret për rishqyrtimin nga komuna.

**Komuna e Shtërpcës**

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, në periudhën janar-dhjetor të vitit 2012 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, në shumicën e rasteve nuk merr pjesë kerytari i komunës.

Sa i përket sistemit të teleprezencës, në Komunën e Shtërpcës ka pasur vështirësi në qasje, andaj një pjesë e madhe e mbledhjeve nuk janë monitoruar. Megjithëse, lajmërimet për mbledhje të kuvendit janë dërguar me kohë sipas dispozitave ligjore të LVL-së. Në përgjithësi, komunikimi me Komunën e Shtërpcës nuk ka qenë në nivelin e duhur.

Ndër aktet më të rëndësishmet që ka miratuar kuvendi janë: Vendimi mbi themelimin e spitalit në Shtërpce; Vendimi për themelimin e komisionit për përgatitjen e statutit të spitalit nga ana e kuvendit; Vendim i për miratimin e kërkesës së Ministrisë se mjedisit dhe planifikimit hapësinor për leje ndërtimi për 6 objekte individuale 6 familje në lagjen Smaljaj në fshatin Brod; Vendimi për miratimin e Planit Aksional për përmirësimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në territorin e Komunës Shtërpcë.
Kuvendi ka miratuar edhe Rregulloren për taksa,tarifa dhe dënimet komunale, Rregulloren për rregullimin e orarit të punës te objekteve komerciale në Komunën e Shtërpcës dhe Rregulloren për shkollat fillore,dhe te mesme te Komunës Shtërpcës

## EFIKASITETI DHE AZHURITETI I ORGANEVE TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Sqarim: Të dhënat në vijim, janë bazuar në regjistrat elektronik të të dhënave të siguruara nga programi CMS/CSC**

Mungojnë të dhënat për komuna: Graçanicë, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Kllokot, për arsye se këto komuna ende nuk e kanë vënë në funksion këtë program.

***Efikasiteti i organeve në Komunën e Gjakovës***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Gjakovës për gjatë vitit 2012 është 5249 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë gjithsej 4875 kërkesa, marrë në përqindje 92.87%.

**Zyra e kryetarit të komunës –** 367 kërkesa të pranuara, të shqyrtuara janë 326 të shqyrtuara
**Kuvendi i Komunës –** ka pranuar 109 kërkesa, ka shqyrtuar 104.
**Drejtoria e Administratës dhe Personelit** – ka pasur gjithsej 1363 kërkesa, janë shqyrtuar 1348
**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale –** ka pranuar 518 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 481.
**Drejtoria e Arsimit -** ka pasur 784 kërkesa, të shqyrtuara janë 749.
**Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –** ka pasur 118 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 115 kërkesa.
**Drejtoria për Financa** – ka pasur 186 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar vetëm 107 kërkesë.
**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik –** ka pasur 227 kërkesa, të shqyrtuara janë 213 kërkesa.
**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit –** ka pasur 572 kërkesa, janë shqyrtuar 446
**Drejtoria për agrokulturë –** ka pasur 73 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 65 kërkesa.
**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë –** ka pasur 68 kërkesa, të githa janë shqyrtuar
**Drejtoria për Shërbime Publike –** ka pasur 166 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim –** ka pasur 236 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
**Drejtoria për Punë Inspektuese** – ka pasur 865 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 814 kërkesa.
**Zyra komunale për komunitete**: ka pasur 37 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 31 kërkesa,

***Efikasiteti i organeve në Komunën e Deçanit***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Deçanit për gjashtëmujorin e parë 2012 është 5920 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 4703, kërkesa ose 79.44 %.

**Zyra e Kryetarit –** ka pranuar 1153 kërkesa, ka shqyrtuar 1091.
**Kuvendi i Komunës – ka pranuar 119 kërkesa, ka shqyrtuar 112.**
**Drejtoria për Administratë dhe Personel –** ka pasur gjithsej 635 kërkesa, të shqyrtuara janë 242 kërkesa.
**Drejtoria për Buxhet dhe Financa –** ka pasur gjithsej 131 kërkesa, janë shqyrtuar gjithsej 85 kërkesa shqyrtuar.
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –** ka pasur gjithsej 64 kërkesa, nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë.
**Drejtoria e Arsimit –** ka pasur gjithsej 955 kërkesa, janë shqyrtuar 880 kërkesa, ndërsa 75 ende nuk janë shqyrtuar

**Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit –** ka pasur gjithsej 273 kërkesa, prej tyre 179 janë shqyrtuar.
**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural –** ka pasur gjithsej 439 kërkesa, të shqyrtuara janë 39, ndërsa te pashqyrtuara janë 409
**Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike –** Ka pasur 222 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 159 kërkesa.
**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim –** ka pasur 15 kërkesa, të shqyrtuara janë 12 kërkesa.
**Drejtoria për Inspekcion –** ka pasur 79 kërkesa, prej tyre 77 janë shqyrtuar.
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport –** ka pasur 106 kërkesa, janë shqyrtuara 93 kërkesa.
**Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër –** ka pasur 1529 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 1371.

***Efikasiteti i organeve në Komunën e Rahovecit***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Rahovecit për vitin 2012 është 49275 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë 48434 kërkesa ose 98.29 %.

**Zyra e kryetarit –** ka pranuar 641 kërkesa, ka shqyrtuar 312.
**Kuvendi i Komunës –** ka pranuar 81 kërkesa, ka shqyrtuar 66.
**Drejtoria e Administratës dhe Personelit-** ka pasur gjithsej 45175 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuara të gjitha.
**Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit** - ka pasur gjithsej 192 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 123 kërkesa.
**Drejtoria për Financa, Buxhet** - ka pasur gjithsej 462 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 434 kërkesa.
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** - ka pasur gjithsej 51 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 36kërkesa.
**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – ka pasur gjithsej 226 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 182 kërkesa.
**Drejtoria për Punë Inspektuese** - ka pasur gjithsej 994 kërkesa, të shqyrtuara janë gjithsej 740 kërkesa.
**Drejtoria e Arsimit** – ka pasur gjithsej 416 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 414 kërkesa.
**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** - ka pasur gjithsej 396 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 381 kërkesa.
**Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër** - ka pasur gjithsej 17 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 11 kërkesa.
**Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë** - ka pasur gjithsej 513 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim** - ka pasur gjithsej 111 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 47 kërkesa.

*Efikasiteti i organeve në  Komunën e Junikut*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Junikut për vitin 2012 është 9102 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë  9073 ose marrë në përqindje 99.68%.

**Zyra e kryetarit –** ka pasur 533 kërkesa, 524 janë shqyrtuar
**Kuvendi i Komunës –** 59 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
**Drejtoria e Administratës –** ka pasur gjithsej 6015 kërkesa, të gjitha janë të  shqyrtuara.
**Drejtoria për Buxhet dhe Financa -** ka pasur gjithsej 91 kërkesa, të gjitha janë te shqyrtuara.
**Drejtoria për  Arsim, Kulturë Rini dhe Sport**  - ka pasur gjithsej 196 kërkesa, të shqyrtuara janë gjithsej 194 kërkesa.
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** – ka pasur 48 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 46.
**Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis -**  ka pasur 1475 kërkesa, të shqyrtuara  janë 1463 kërkesa.
**Drejtoria për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim – ka pasur** 127 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 127  kërkesa.
**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim –** ka pasur 554 kërkesa, të gjitha janë te shqyrtuara.

*Efikasiteti i organeve në  Komunën e Istogut*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Istogut në periudhën janar-dhjetor  të vitit 2012 është 3101, të shqyrtuara janë 2963 ose 95.54%.

**Zyra e kryetarit – ka pranuar 262 kërkesa, të shqyrtuara janë 207.**
**Kuvendi i Komunës – 10 kërkesa të pranuara, të shqyrtuara 5**
**Drejtoria e Administratës dhe Personelit –** janë pranuar gjithsej 444 kërkesa, prej të cilave 445 janë shqyrtuar, ndërsa 2  janë të pashqyrtuara..
**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet –** janë pranuar gjithsej 143 kërkesa,  prej tyre janë shqyrtuar 130, ndërsa janë në proces të shqyrtimit 13.
**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit –** janë pranuar gjithsej 1429 kërkesa, prej të cilave 1406 janë  shqyrtuar, ndërsa 23  janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport –** janë pranuar gjithsej 58 kërkesa, prej tyre 51 janë shqyrtuar,   janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Siguri–** janë pranuar gjithsej 232 kërkesa, prej tyre 229, janë shqyrtuar dhe 3 janë të pashqyrtuara..
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** – janë pranuar gjithsej 72 kërkesa, prej tyre 69 janë shqyrtuar, 3 janë të pashqyrtuara .
**Drejtoria e Inspektoratit** – janë pranuar gjithsej 65 kërkesa, të shqyrtuar 58, të pashqyrtuara 7.
**Drejtoria për Bujqësi,dhe Zhvillim Rural–** janë pranuar gjithsej 370, kërkesa, prej tyre 363 janë shqyrtuar, 7 janë të pashqyrtuara ende.

*Efikasiteti i organeve në Komunën e Vitisë*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të Komunës se Vitisë është 2,114, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 2,035 kërkesa ose marr në përqindje 96.26 %.

**Kuvendi i Komunës-** ka pranuar 4 kërkesa të pashqyrtuara janë të gjitha.
**Zyra e Kryetarit-** ka pranuar 71 kërkesa, të shqyrtuara janë 36, ndërsa të pashqyrtuara janë 35 kërkesa.
**Drejtoria për administratë –** janë pranuar gjithsejtë 1,269 kërkesa , të shqyrtuara janë 1,243 të pashqyrtuara janë 26 kërkesa..
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale-** janë pranuar gjithsejtë 70 kërkesë të shqyrtuara janë të gjitha.
**Drejtoria për Arsim dhe Shkencë -** janë të pranuara gjithsejtë 29 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha.
**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe zhvillim-** janë të pranuara gjithsejtë 252 kërkesa, të shqyrtuara janë 251, kurse 1 kërkesë është e pashqyrtuar.
**Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi-** janë të pranuara gjithsejtë 25 të shqyrtuara janë 22, ndërsa të pashqyrtuara janë 3 kërkesa.
**Drejtoria për Inspekcion-** janë të pranuara gjithsejtë 139 kërkesa, dhe të gjitha janë të shqyrtuara.
**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri-** janë të pranuara gjithsejtë 92 kërkesa të shqyrtuara janë 89 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 3kërkesa.
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-** janë të pranuara gjithsejtë 56 kërkesa, të shqyrtuara janë 51 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 5 kërkesa.
**Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural-** janë të pranuara gjithsejtë 57 kërkesa të gjitha janë të shqyrtuara.
**Drejtoria,Planifikim dhe Urbanizëm-** janë të pranuara gjithsejtë 50 kërkesa të shqyrtuara 48 të shqyrtuara ndërsa 2 të pashqyrtuara.
**Zyra Komunale për Komunitete-** ska asnjë kërkesë.

*Efikasiteti i organeve në Komunën e Obiliqit*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të Komunës se Obiliqit është 2,785, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 2405 kërkesa ose marr në përqindje 86,35 %.

**Kryesuesi i Kuvendit –** janë pranuar gjithësejt 69 kërkesa, të shqyrtuara janë 39 ndërsa të pashqyrtuara janë 30 kërkesa.
**Kryetari i Komunës –** janë pranuar gjithësejt 169 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha .
**Drejtoria për Administratë së përgjithshme -** janë pranuar gjithsej 561 kërkesa, të shqyrtuara janë 540 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 21 kërkesa.
**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim-** janë pranuar gjithsej 66 kërkesa, të shqyrtuara janë 35 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 31 kërkesa.
**Drejtoria për Planifikim Urbanizëm dhe Kadastër -** janë pranuar 913 kërkesa, të shqyrtuara janë 889, ndërsa të pashqyrtuara janë 24 kërkesa.
**Drejtoria për Mbrojtje së Mjedisit -** janë pranuar 5 kërkesa dhe janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria për Arsim -** janë pranuar 160 kërkesa, të shqyrtuara janë 114 ndërsa 46 janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale -** ka pranuara gjithsej 63 kërkesa, të shqyrtuara 6 kërkesa ndërsa, ndërsa të pashqyrtuara 57 kërkesa.

**Drejtoria për Shërbime dhe Emergjencë –** ka pasur gjithësejt 100 kërkesa të shqyrtuara janë 74 ndërsa të pashqyrtuara janë 26 kërkesa.
**Drejtoria e Inspekcionit-** i ka të pranuara gjithësejt 51 kërkesa të gjitha janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria për Rini Kulturë dhe Sport-** i ka pranuar gjithësejt 42 kërkesa, të shqyrtuara janë 25 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 17 kërkesa.
**Drejtoria e Prokurimit-** i ka pasur 5 kërkesa të gjitha janë të pashqyrtuara.
**Zyra Lokale për Komunitete-** ka pranuar 120 kërkesa, të shqyrtuara janë 34, ndërsa të pa shqyrtuara janë 86 kërkesa.
**Zyra e Personelit –** ka pranuar gjithësejt 18 kërkesa, të shqyrtuara janë 14 të pashqyrtuara janë 4 kërkesa.
**Sektori për Tatim në Pronë-** janë pranuar 417 kërkesa të shqyrtuara janë 411 kërkesa të pashqyrtuara janë 6 kërkesa.

*Efikasiteti i organeve në Komunën e Hanit të Elezit*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të Komunës se Hanit të Elezit është 8,578, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 8536 kërkesa ose marr në përqindje 99,53 %.

**Kuvendi i Komunës -** ka pranuar gjithsejtë 103 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha.
**Kryetari i Komunës -** ka pranuar gjithsejtë 406 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha.
**Drejtoria për administratë së përgjithshme** – janë të pranuara gjithsejtë 5,854 kërkesa, të shqyrtuara janë 5,851 ndërsa të pashqyrtuara janë 3 kërkesa.
**Drejtoria për buxhet dhe Financa –** janë të pranuara gjithsejtë 295 kërkesa, të shqyrtuara 292 ndërsa 3 kërkesa janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit-** janë të pranuara 1,277 kërkesa, të shqyrtuara 1,272 ndërsa 5 janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporti-** ka të pranuara gjithsejtë 224 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.
**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale-** ka të pranuara gjithsejtë 97 kërkesa, të shqyrtuara janë 90 ndërsa të pashqyrtuara janë 7 kërkesa.
**Drejtoria Për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural-** ka të pranuara gjithsejtë 168 kërkesa të shqyrtuara janë 166 ndërsa të pashqyrtuara janë 2 kërkesa.
**Drejtoria për shërbime Publike dhe Emergjencë-** ka të pranuara 89 kërkesa të shqyrtuara janë 82 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 7 kërkesa.
**Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillim Ekonomi-** ka pranuar 11 kërkesa të gjitha janë të shqyrtuara.
**Zyra e Prokurimit –** i ka pranuar 54 kërkesa, të shqyrtuara janë 39 ndërsa të pashqyrtuara janë 15 kërkesa.

*Efikasiteti i organeve në Komunën e Podujevës*

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të Komunës së Podujevës është gjithsej 2,357, prej të cilave janë shqyrtuar 1771 ose marrë në përqindje 75,13% të kërkesave.

**Kuvendi i Komunës –** ka pranuar 6 kërkesa të gjitha janë të pashqyrtuara.
Zyra e Kryetarit – janë pranuar 12 kërkesa, të shqyrtuara janë 2 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 10 kërkesa.
**Drejtoria për Administratës -** janë pranuar gjithsej 9 kërkesa, të shqyrtuara janë 3 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 6 kërkesa.
**Drejtoria e Buxhetit dhe Financave-** i ka pranuar 65 kërkesa të shqyrtuara të shqyrtuara janë të gjitha.

**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit** - 153 kërkesa janë pranuar, të shqyrtuar 104 ndërsa të pashqyrtuar mbeten 49 kërkesa.
**Drejtoria për Arsim** - janë pranuar 361 kërkesa të shqyrtuara janë 12 kërkesa të pashqyrtuara janë 349 kërkesa.
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –** 349 kërkesa janë pranuar, të shqyrtuara janë 317 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 32 kërkesa.
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-** 10 kërkesa janë pranuar, 1 kërkesë është shqyrtuar ndërsa 9 janë të pashqyrtuara.
**Drejtoria e Inspeksionit** - ka pranuar 57 kërkesa, të shqyrtuar 54, ndërsa të pashqyrtuara janë 3 kërkesa.
**Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë –** 121 kërkesa janë pranuar, të shqyrtuar 88 , të pashqyrtuar 33 kërkesa.
**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-** janë pranuar 713 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha.
**Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje dhe Shpëtim** - 31 kërkesa janë pranuar, dhe të gjitha janë të pashqyrtuara.
**Udhëheqësi i Personelit-** janë pranuar gjithësejt 375 kërkesa të shqyrtuara janë 331 të pashqyrtuara janë 44 kërkesa.
**Departamenti i Prokurimit** - ka pranuar 82 kërkesa, të shqyrtuara janë 81 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 1 kërkesa.
**Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik-** i ka pranuar 13 kërkesa të gjitha janë të pashqyrtuara.

***Efikasiteti i organeve në Komunën e Klinës***

